RAPORT AUDITIMI

MBI PËRPUTHSHMËRINË DHE RREGULLSHMËRINË

NË

SPITALIN UNIVERSITAR "SHEFQET NDROQI"

TETOR 2021

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	2
1.	Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-10
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	10-11
II.	**HYRJA**	12
1.	Objekti i auditimit	12
2.	Qëllimi i auditimit	12
3.	Identifikimi i çështjes	12
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	12
5.	Përgjegjësitë e audituesve	13
6.	Kriteret e vlerësimit	13
7.	Standardet e auditimit	14
8.	Metodat e auditimit	14
9.	Dokumentimi i auditimit	14
III.	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	15
1.	**Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim**	15
2.	**Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit**	15-16
2.1	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Strukturave Drejtuese besueshmërinë ligjore të vendimeve të marra dhe realizimin e tyre.	16-17
2.2	Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.	17-26
2.3	Mbi planifikimin e Buxhetit, si edhe shpenzimet administrative.	26-32
2.4	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si edhe menaxhimin e aktiveve të spitalit.	32-42
2.5	Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet për investime, për blerje mallrash e shërbimesh, si dhe zbatimi i kontratave (saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit, vlerësimi i kritereve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe zbatimi i punimeve i punimeve deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimi i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve.	42-87
2.6	Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj).	87-94
2.7	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore.	94-96
2.8	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, informimi, komunikimi dhe monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për	96-102

	cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm.	
2.9	Organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditit të brendshëm, kapacitetet audituese që mbulojnë këtë aktivitet. Planifikimi, realizimi i programit vjetor të auditimit dhe analiza sipas llojeve dhe gjetjeve. Rezultatet dhe efiçenca e strukturave të ngritura për realizimin e auditit të brendshëm. Ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga drejtimi.	102-104
2.10	Mbi auditimin e fondeve të akorduara dhe të shpenzuara, për përballimin e situatës së pandemisë Covid-19.	104-105
IV.	**GJETJET DHE REKOMANDIMET**	106-127
V.	**ANEKSE**	128-130

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

SUSHN është institucion buxhetor në vartësi të Ministrisë së Shëndetësisë. Fondet e përfituara për ushtrimin e veprimtarisë janë fondet buxhetore të çelura nga fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor për paga, sigurime, shpenzime operative dhe nga Ministria e Shëndetësisë për investime sipas programeve dhe fondeve te miratuara me ligjet vjetore të buxhetit të shtetit.
Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA, si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas programeve, artikujve, produkteve, si dhe projektet me financim të brendshëm. Referuar auditimit te buxhetit si dhe nevojave dhe konsumit të fondeve për periudhën objekt auditimi, ka rezultuar se nga ana e Spitalit janë kërkuar fonde brenda tavaneve të miratuara me VKM për programet e shërbimit terciar (spitalet) në një kohë që këto nevoja për fonde janë më të mëdha se tavanet e miratuara.
SUSHN funksionon sipas ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003 ñPër shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisëò dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 823 datë 11.06.2008 ñPër kthimin e Spitalit Universitar të Mushkërive "Shefqet Ndroqi" në Spital Universitar "Shefqet Ndroqi", ku në pikën 4 citohet se *"Mënyra e organizimit, struktura dhe rregulloret e funksionimit përcaktohen nga Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës".*
Nga auditimi i kryer pranë ñSpitali Universitar Shefqet Ndroqiò Tiranë, për periudhën 01.01.2018-31.012021, lidhur me përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike-financiare, rezultoi se, Institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë të cilat lidhen cilësisht e kryesisht me mbajtjen e sistemit të kontabilitetit, hartimit dhe plotësimit të gjurmës së auditimit, regjistri i aktiveve që ka në pronësi apo posedim, nuk është plotësuar me kërkesat që duhet të përmbajë ky regjistër.Në procedurat e blerjeve me vlera të vogla u konstatuan mangësi në hartimin e termave të referencës, duke e bërë të paargumentuar hartimin e fondit limit dhe për pasojë ofertimin e marrë nga operatorë të tregut. Gjithashtu për planifikimin e nevojave vjetore për barna dhe materiale mjekësore nga Shërbimet mjekësore në SUSHN, gjatë hartimit të projektbuxhetit dhe planit buxhetor (pas miratimit), nuk bëhet analizë mbi gjendjen e ilaçeve, sasinë e konsumit të tyre vjetore, në mënyrë që të justifikojnë dhe argumentojnë listën për nevojat e këtyre barnave. Problematika janë konstatuar në zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave ka rezultuar se në listë pagesat nuk reflektohet në kohë reale përmbushja e vjetërsisë duke krijuar diferenca në nivelet e pagave të punonjësve. Nga auditimi u konstatuan mangësi në disa raste në llogaritjen e vlerës së kontratave dhe hartimin e kritereve të kualifikimit. Në procedurat e kryera, vërehet pjesëmarrja e vetëm 1 operatori ekonomik ose në disa raste u konstatua se operatorë të ndryshëm pjesëmarrës në tender nuk paraqisnin ofertën ekonomike. Në procedurat e audituara rezulton se nga komisionet e vlerësimit të ofertave nuk është shpallur fitues asnjë operator ekonomik me vlerë më të lartë, si edhe në procedurat e kryera për medikamente për llogaritjen e vlerës së kontratës grupet e ngritura për këtë qëllim, janë bazuar në çmimet e medikamenteve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë. Njësia e prokurimit në 90% të prokurimeve ka kërkuar asistencën dhe marrje mendimi e miratimi nga Agjencia e Prokurimit Publik, etj.

1.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nga auditimi u konstatuan mangësi dhe ndër gjetjet kryesore citojmë:

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REF. ME RAPORTIN PËRFUND	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	Kontrata ñF.V makineri pajisje për sistemin e kondicionimit në ambientet e SU ñShefqet Ndroqiò, është nënshkruar me nr. 461/37 prot., datë 03.08.2018, me Kontraktorin ñEd Kon.ò SHPK, me vlerë 175,416,638.4 lekë me TVSH. Nga auditimi i dokumentacionit të pagesave dhe librezës së masave rezulton se ka mangësi si më poshtë: -Sipas zërit A-3.1.ANM-64 ñF.V llamarinë e galvanizuar për prodhimin e kanaleve të ajrit me trashësi nga 0.6 mm deri 1.2 mm, e kompletuar me gjithë fllanxha dhe të gjitha rakorderitë e nevojshme për prodhimin dhe montimin e kanaleve të ajritò, është certifikuar sasia 40841 kg. Në specifikimet teknike pika 2.10, përcaktohet: Të gjitha kanalet e ajrit përjashtuar rastet kur specifikohet ndryshe, duhet të ndërtohen me flete metalike te galvanizuar. Te gjithë fletët metalike të galvanizuara duhet të jenë të veshura me zink 275 g/m². Kapëset dhe mbajtëset duhet të jenë të mbrojtura të galvanizuara. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se jo në të gjitha rastet janë respektuar përcaktimet e mësipërme, pasi për dimensione të ndryshme janë përllogaritur llamarinë me trashësi më të madhe. Gjithashtu pesha e marrë si referencë ka diferenca me peshën e përcaktuar në manuale, veprim i cili bie në kundërshtim me specifikimet teknike. Diferenca e peshës e llogaritur më tepër është 15151 kg. Rezulton se është certifikuar më shumë ***vlera 7,577,400 lekë*** [(15151kg - 2522kg) x 600 lekë/kg], veprim i cili bie në kundërshtim me specifikimet teknike. Llogaritja e peshës së tubave nuk është referuar në këtë standard, duke certifikuar më shumë 4882 kg tubacione ***me vlerë 2,196,900 lekë***. Veprimet e mësipërme bien në		E Lartë	-SUSHN në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për verifikimin trashësisë së llamarinave dhe të tubacioneve të vendosura në objekt, verifikim i cili nuk është realizuar nga KLSH për arsye të protokolleve Covid 19, pasi SSHUN në periudhën e auditimit fuksiononte si spital Covid. Bazuar në rezultatet e verifikimit, duke marrë në konsideratë se në dokumentacionin e dosjes teknike specifikimet teknike rezultojnë të pa zbatuara, të bëhet zbritja e vlerës ***9,954,300 lekë***, llogaritur si peshë llamarinash dhe tubacionesh të argumentuara, rezultat e cili duhet të reflektohet në situacionet progresive dhe situacionin përfundimtar.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REF. ME RAPORTIN PËRFUND	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	kundërshtim me Specifikimet teknike të kontratës pika 2.10, Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar, neni 7.			
2.	Nga auditimi rezulton se SUSHN për të gjithë periudhën e pandemisë ka shërbyer si spital COVID dhe si i tillë ka funksionuar i gjithi Jo i ndarë si institucionet e tjera spitalore. Nga shqyrtimi i dhënies së shpërblimeve COVID për punonjësit rezultoi se në këtë spital kanë përfituar shpërblim të gjithë punonjësit si rezultat dhe i pashmangshmërisë sëkontaktit me të infektuarit me Covid. Për periudhën që ky institucion u kthye në COVID punonjësit kanë përfituar si shpërblim për punën në kushte të tilla vlerën prej ***19,980,409 lekë***, e cila përbën efekt negativ financiar. Veprimet janë kundërshtim me VKM nr. 207 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, datë 10.03.2020 ñPër dhënieshpërblimi për personelin mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerëòdatë si dhe shkresën nr. 1429/1, datë 12.03.2020 ñDhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerëò.		E Lartë	-Nga Drejtoria e Spitalit Universitar ñShefqet Ndroqiò në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masa që shpërblimi për COVID-19 tõi jepet vetëm punonjësve të cilët kanë kontakt të drejtpërdrejtë me pacientë të kontaminuar dhe që kontribuojnë në diagnostikimin e të sëmurëve. Strukturat drejtuese dhe departamenti i financës të marrin masa dhe të ndërpritet dhënia e shpërblimit për çdo punonjës që nuk kontribuon drejtpërdrejt në diagnostikimin e të sëmurëve me COVID-19.
3.	Procedurat e ankimimit për tenderin me objekt ñFurnizim vendosje pajisje për hapjen e sallës së kardio kirurgjisëò janë tejzgjatur duke kaluar afatet, sepse nga KPP procedura pa kthyer përgjigje me vendim, ka zgjatur prej datës 17.07.2020 - 21.12.2020, ose 5 muaj me vonesë, e cila ka sjellë vështirësi në lidhjen dhe zbatimin e kontratës, pasi në fund të vitit mbyllen fondet buxhetore të akorduara për vitin 2020. Komisioni i vlerësimit të		E Lartë	AutoritetiKontraktor (SUSHN), për procedurat e prokurimit kryesisht me objekt ñpajisje mjekësoreò që do të kryej në të ardhmen, të marrë masa për përcaktimin e saktë të specifikimeve teknike nga specialistë të fushës në bashkëpunim me mjekë specialistë që do tí përdorin, me qëllim arritjen e prokurimit brenda afateve, me efektivitet

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REF. ME RAPORTIN PËRFUND	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	ofertave ka vlerësuar në vend të parë operatorin ekonomik Bashkimi i përkohshëm i shoqërive ñBi. Alb. dhe Mo.ò me ofertë ekonomike 58,597,000 lekë, pa TVSH, duke vlerësuar devijime të vogla mangësitë në dokumentet e kualifikimit, anëtarët e kvo, edhe në ballafaqimin e kryer nga grupi auditimit konfirmuan se pajisjet e sjella dhe vlera e bashkimit të operatorëve ñBi. Alb. dhe Mo.ò përmbushnin parametrat dhe ishin pajisje cilësore të kompanisë ñGe. Elek.ò. Specifikimet teknike të hartuara nga AK, kanë pësuar disa ndryshime si pasojë e ankesave të operatorëve ekonomikë. Referuar dokumenteve në dispozicion dhe ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, vendimet e marra nga KPP, kanë vlerësuar pjesërisht ankesat e paraqitura nga Operatori ekonomik ñBiom. dhe Mo.ò për specifikimet teknike të ofruara, dhe vendimi i KPP ka gjeneruar fituesin me vlerë më të lartë prej *13,103,000 lekë*. Komisioni i Prokurimit Publik, ka vendosur të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ñBiom. dhe Mo.ò, pasi nuk sjell fakte të reja si edhe kjo çështje e pretenduar merr cilësinë e një çështjeje të shqyrtuar tashmë nga KPP, situatë kjo analoge me çështjet që janë gjykuar njëherë nga gjykata, për të cilat zbatohet parimi i gjësë së gjykuar njëherë nga gjykata, iso lege, pretendimet nuk mund të merren në shqyrtim. Operatori ekonomik nuk legjitimohet për paraqitjen e ankesës në KPP, e rrjedhimisht pretendimet nuk merren në shqyrtim nga KPP.			dhe ekonomicitet.
4.	Në procesin e monitorimit të kontratave të SUSHN me FSDKSH, për ñFinancimin e shërbimeve spitaloreò, u konstatua mos realizimi i detyrimeve të spitalit në lidhje me kontratën konçesionare Saniservice. Nr. 1440/40 prot., datë 24.12.2015, ñPër ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të		E LARTË	Strukturat drejtuese të marrin masa, për përcaktimin e ndërhyrjeve kirurgjikale shtesë, që nuk janë të përfshira në aneksin 4, të kontratës koncesionare për sterelizimin dhe tõi kërkojë MSHMS për klasifikimin e kompleksitetit të seteve që përdoren në to,

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REF. ME RAPORTIN PËRFUND	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	personalizuar të instrumentave kirurgjikale sterile, furnizimin me materiale mjekësore sterile një përdorimëshe në sallat kirurgjikaleò, të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Shoqërisë Konçesionare Sa.Se. Sh.p.k. Gjatë auditimit të dokumentacionit të mbajtur nga spitali për periudhën 2019-2020, për setet kirurgjikale të sterilizuara nga koncesionari, të përdorura në 78 operacione, u konstatua se, dokumentacioni i kërkuar nga FSDKSH, është plotësuar jo në përputhje me aneksin nr. 4, të kontratës lidhur ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me koncesionarin Sani Service. Në modulet administrative të shërbimit të plotësuara nga mjekët që kryejnë operacionet, lidhur me zgjedhjen e kompleksitetit të setit kirurgjikal, përdoren diagnozat mjekësore të terminologjisë profesionale dhe jo klasifikimet e përcaktuara në aneksin 4. Vlera e sterilizimit të seteve kirurgjikale, varion nga kompleksiteti i ulët i seteve në vlerën 13,900 lekë, në vlerën 22,300 lekë për kompleksitetin e mesëm dhe në vlerën 37,700 lekë, në kompleksitetin e lartë.Për periudhën 2019-2020 janë kryer 78 operacione kirurgjikale, nga të cilat 54 me kompleksitet të lartë dhe 24 me kompleksitet të ulët, me vlerë financiare *2,369,400 lekë*, në të cilët modulet për gjurmueshmërinë klinike dhe administrative të shërbimit, lidhur me përzgjedhjen e kompleksitetit të setit, nuk i referoheshin aneksit 4, të kontratës me koncesionarin.Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 9, të kontratës Konçesionare mospërcaktimi i saktë i seteve që do të përdoren,rrit riskun e subjektivizmit në përzgjedhjen e kompleksitetit të tyre, gjë e cila shoqërohet me kosto financiare shtesë.			shoqëruar me amendimet përkatëse në kontratën me koncesionarin.
5.	Nga auditimi i zbatimit të kontratës, me objekt ñShʸrbim me roje private për SUSHNò, u konstatua se: Nga			SUSHN, të dërgoj informacion në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, mbi konstatimet e

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REF. ME RAPORTIN PËRFUND	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	verifikimi i listy pagesave punonjësit e ofrimit ty shërbimit ty rojeve ny SUSHN paguhen me 36,000 leky/muaj pagy bazy pa pyrfshiry shtesat e përcaktuara pyr kyty pozicion pune ku sipas ofertës dhe kontratës duhet ty paguheshin me 48,793.95 leky, pagy/muaj.Operatori ekonomik ñLe. Sec.ò ka përfituar padrejty sisht 202,586.8 lekë, përfitim i pa drejtë nga paga e rojeve. Nga verifikimi i kryerjes së shërbimit dhe pagesës sipas ofertës dhe kontratës së nënshkruar u konstatua se: asnjë nga punonjësit e shërbimit të cilët kanë kryer shërbim me turne të 2 apo të 3 nuk është paguar sipas kushteve të kontratës, por është paguar si punonjës shërbimi me 1 turn duke përvetsuar padrejtësisht diferencën e shtesës mbi pagë të punonjësve që punojnë turne të dyta e të treta. Gjithashtu, nga ky përvetësim i pagës është shmangur dhe pagesa e detyrimit për sigurime shoqërore e shëndetësore në masën 16.7%.Në total ky përvetësim pagë + sigurime shoqërore e shëndetësore, është 236,417 x 9muaj (kontratë) = *2,127,753 lekë.*			KLSH si edhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për procedurën e prokurimit me objekt ñShyrbim me roje private për SUSHNò, fituar nga operatori ekonomik ñLeksi securityò(kontratë, specifikime teknike,etj) me qëllim verifikimin dhe vlerësimin e detyrimeve tatimore konform legjislacionit në fuqi dhe shmangien e parregullsive në llogaritjen, mbajtjen dhe derdhjen në buxhet të detyrimeve për punonjësit e shoqërisë.
6.	Për planifikimin e nevojave vjetore për barna dhe materiale mjekësore nga Shërbimet mjekësore në SUSHN, gjatë hartimit të projektbuxhetit dhe planit buxhetor (pas miratimit), nuk bëhet analizë mbi gjendjen e ilaçeve, sasinë e konsumit të tyre vjetore, në mënyrë që të justifikojnë dhe argumentojnë listën për nevojat e këtyre barnave. Rritja e sasive të barnave të porositura nuk është e shoqëruar me relacione shpjeguese dhe argumentuese për justifikimin e sasive shtesë. Mos kryerja e analizave dhe mos argumentimi i tyre sjellin rritjen e barnave stok, si dhe rritjen e riskut për tu kaluar afati i skadencës. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.7, ñPër procedurat standarde të përgatitjes së PBAò datë 28.02.2018, pika 6. Metodologjia e përcaktimit të politikave ekzistuese		E LARTË	Strukturat drejtuese në vazhdimësi të marrin masa për ndjekjen e procedurave të hartimit të PBA, duke siguruar që planifikimet të kryhen mbështetur në analiza të dinamikës të vlerësimit të kostove të nevojshme për ruajtjen e sasisë dhe cilësisë të shërbimeve të ofruara, vlerësimin e të dhënave historike të shpenzimeve, kostove për njësi, parametrave e çmimeve vendosur nga MSHMS dhe efiçencës dhe argumentimin e tyre.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REF. ME RAPORTIN PËRFUND	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	dhe politikave të reja, dhe me ligjin nr. 10 296, datë 8.7.2010, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, Neni 4, pika 19 dhe neni 16, "Gjurma e auditimit".			
7.	Nga auditimi i zbatimit të kontratave për shërbimin ñGatim dhe shpërndarje ushqimiò për periudhën objekt auditimi, konstatohet se dokumentacioni është nënshkruar nga k/infermieri i çdo pavijoni dhe përmbledhësja nga përgjegjësi i kartotekës ku konfirmohet forca ushqimore e çdo pavijoni. Dokumenti(formulari) ku pasqyrohet forca ushqimore ka të përcaktuar në ekstremitete se duhet nënshkruar nga k/infermieri dhe shefi i pavijonit, por janë në numër të pakët rastet ku dokumenti është nënshkruar nga shefat e pavijoneve, rezulton të jetë nënshkruar vetëm nga k/infermieri, veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñMbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò Kreu III/2 ñDokumentimi i lëvizjes së aktiveveò pika 35/b, 36 dhe 54. Punonjësët e kartotekës dhe sektori statistikës, të cilat hartojnë përmbledhëset mujore mbi bazën e këtij dokumentacioni kanë pranuar dokumentin ñForca ushqimoreò të plotësuar dhe nënshkruar vetëm nga k/infermieri.		E LARTË	Sektori i Statistikës në bashkëpunim me strukturat e caktuara në pavijonet e spitalit për monitorimin e kontratës së shërbimit ñgatimi dhe shpërndarja e ushqimit të sëmurëveò, të plotësojnë dhe pranojnë dokumentacionin mbi të cilin do të kryhet pagesa ndaj operatorit ekonomik ñSori-alò, duke pasqyruar saktë numrin e të shtruarve në çdo pavijon, lëvizjet ditore,etj, të nënshkruar nga personat përgjegjës për ti dhënë forcën e dokumentit vërtetues pagese.

1.3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Nga auditimi i kryer mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së ñSpitali Universitar Shefqet Ndroqiò, Tiranë, (SUSHN) sa i takon zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, kushteve, termave dhe politikave mbi të cilat ky institucion realizon misionin e tij, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), janë konstatuar disa mangësi dhe parregullsi. Gjatë auditimit në terren janë marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë[1]

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë[1], i mbështetur në ligjin nr. 154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin SUSHN, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar të përputhshmërisë.

[1]Mbështetur në ligjin nr.154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e KLSH-sëò

Baza për opinionin e kualifikuar (ISSAI 4000)[2]

KLSH, kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 ñStandardi i Auditimit të Përputhshmërisëò. KLSH është e pavarur kundrejt subjektittë audituar, mbështetur në ISSAI-n 10 - Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. KLSH ka përmbushur përgjegjësitë etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtuedhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

Nga evidencat e marra mbi veprimtarinë e SUSHN rezultoi se:

Institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë të cilat lidhen cilësisht e kryesisht me mbajtjen e sistemit të kontabilitetit, hartimit dhe plotësimit të gjurmës së auditimit, regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat që duhet të përmbajë ky regjistër, për pagesat e detyrimeve kontraktore për barna, pajisje mjekësore, shërbime të ndryshme, për periudhën 2018-2020, u konstatuan 20 procedura të likuiduara me vonesë nga 1 deri më 4 muaj. Në procedurat e blerjeve me vlera të vogla u konstatuan mangësi në hartimin e termave të referencës, duke e bërë të paargumentuar hartimin e fondit limit dhe për pasojë ofertimin e marrë nga operatorë të tregut. Gjithashtu për planifikimin e nevojave vjetore për barna dhe materiale mjekësore nga Shërbimet mjekësore në SUSHN, gjatë hartimit të projektbuxhetit dhe planit buxhetor (pas miratimit), nuk bëhet analizë mbi gjendjen e ilaçeve, sasinë e konsumit të tyre vjetore, në mënyrë që të justifikojnë dhe argumentojnë listën për nevojat e këtyre barnave. Rritja e sasive të barnave të porositura nuk është e shoqëruar me relacione shpjeguese dhe argumentuese për justifikimin e sasive shtesë. Mos kryerja e analizave dhe mos argumentimi i tyre sjellin rritjen e barnave stok, si dhe rritjen e riskut për tu kaluar afati i skadencës. Problematika janë konstatuar në zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave ka rezultuar se në listë pagesat nuk reflektohet në kohë reale përmbushja e vjetërsisë duke krijuar diferenca në nivelet e pagave të punonjësve, ekzistenca e dy standardeve në mënyrën e trajtimit të punonjësve me gradë shkencore. Gjithashtu në zbatimin e kontratës F.V makineri pajisje për sistemin e kondicionimit në ambientet e spitalit, u konstatuan mangësi në zërat llamarina, tuba si në pjesën sasiore ashtu dhe në atë cilësore sipas parametrave të kërkuara *me vlerë 9,954,000 lekë, dëm ekonomik për institucionin*. Në procesin e dhënies së shpërblimeve Covid për punonjësit nuk ishte bërë diferencimi i tyre nga punonjësit që kontribuonin direkt me pacientët, por kishte gjithëpërfshirje, mangësi në procedurat e shërbimeve për ngrohje, prokurime, oksigjen dhe instrumente mjekësore duke pasur si *efekt financiar negativ vlerën 50,159,149 lekë. Vlera në total e parregullsive arrin në 60,113,188 lekë.*

KLSH arrin në konkluzionin se, problematikat e konstatuara kanë ekspozuar institucionin drejt risqeve për përmbushjen e detyrimeve, në zbatim të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë së tij.

[2]ISSAI 4000-Udhërëfyesi i Auditimit të Përputhshmërisë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e KLSHò, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 133/1, datë 27.01.2021, i ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 01.02.2021 deri në datë 14.05.2021, në subjektin Spitali Universitar Shefqet Ndroqi, për periudhën nga data 01.01.2018 deri në datë 31.01.2021, u krye auditimi ñMbi Përputhshmërinë dhe Rregullshmërinë e veprimtarisë ekonomike-financiareò nga Grupi i Auditimit me përbërje:

-M.B., përgjegjës Grupi
-A.T., auditues
-S. H., auditues
-B.Sh., auditues

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti i auditimit: Në objektivat e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator. Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit nëse Spitali Universitar Shefqet Ndroqi (SUSHN), në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit: Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuara i shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, është dhënia e opinionit apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar.

Gjithashtu theksojmë se ne kemi pasur kufizime në njohjen e preparateve dhe medikamenteve të duhura të planifikuara për përdorim spitalor referuar nevojave reale të spitalit sipas reparteve dhe protokolleve që përdoren në fushën e veprimit të kontrollit dhe shërbimit shëndetësor që mbulon ky Spital, duke i marrë në konsideratë llojet e tyre të blera dhe të përdorura gjatë periudhës së auditimit si edhe vështirësi të diktuara nga situata e pandemisë Covid-19.Auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë *(sipas ISSAI 400, p 18).*

Me auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim.

3. Identifikimi i çështjes: Raporti mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të SUSHN për periudhën 01.01.2018 - 31.01.2021, ka identifikuar sipas kritereve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- Ligjshmërinë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese dhe vendimeve të marra;
- Hartimin, shqyrtimin dhe miratimin si dhe realizimin e buxhetit;
- Zbatimin e strukturës organizative dhe administrimin e marrëdhënieve të punës;
- Rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve;
- Mbajtjen e evidencës kontabile dhe analiza e debitorëve e kreditorëve;
- Zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave;
- Organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit;

- Organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm.
- Menaxhimin e fondeve të akorduara dhe shpenzuara për përballimin e situatës Covid-19.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.

Një ndër përgjegjësitë kryesore të strukturave drejtuese është ngritja e sistemeve të kontrollit dhe marrjes së masave të sinjalizimit për veprime korruptive të punonjësve. Hartimi i rregullave të brendshme referuar funksionit të veprimtarisë së spitalit, strukturës në dispozicion, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e çdo punonjësi në zbatim të akteve ligjore në fuqi, mbi të gjitha duke shmangur dhe mbikëqyrur konfliktin e interesit. Përgjegjësi e strukturave drejtuese të institucionit është përdorimi me efektivitet dhe ligjor të fondeve, duke eliminuar shpenzimet jo efektive dhe jo në funksion të veprimtarisë të Spitalit, sigurisht dhe marrja e masave për njohjen e akteve ligjore që veprojnë dhe në fuqi për të gjithë punonjësit e strukturës funksionale duke programuar trajnimin e vazhdueshëm dhe mbikëqyrur integritetin e tyre.

5. Përgjegjësitë e audituesve: Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion të saktë objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë ekonomiko financiare, në bazë të auditimit tonë. Ne mbajmë përgjegjësi që në praktikën e auditimit si dhe në hartimin e Raportine auditimit janë zbatuar procedurat në përputhje me rregulloret e miratuara dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Referuar këtyre Standardeve audituesi gjithashtu duhet të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar. Siguria e kërkuar i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute, dhe auditimi në pajtueshmëri me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi ka vlerësuar nivelin e kontrollit të brendshëm që nuk është në nivelin e duhur në Spital, në mënyrë që të programojë procedura auditimi që janë të përshtatshme për kushtet e këtij institucioni publik, por jo vetëm për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të SUSHN.

6. Kriteret e vlerësimit: Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë dhe dytësor, në dispozita të tjera si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit: Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò; Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, i ndryshuar; Ligji nr. 9663, datë 18.12.2006 ñPër Koncesionetò, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011 ñPër kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar; Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar; Ligji nr. 7843, datë 13.7.1994 ñPër regjistrimin e pasurive të paluajtshmeò, i ndryshuar; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar, Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 ñPër arkivatò; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 ñKodi i Punës i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar; Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, i ndryshuar; Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar; VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i

ndryshuar; VKM nr. 870, datë 14.12.2011 ñPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë venditò; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlò; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar, udhëzimi APP nr. 3, datë 27.01.2015 ñPër procedurën e prokurimit me vlerë të vogëlò, Statuti dhe Rregullorja e brendshme e SUSHN, etj, si edhe Akte të tjera ligjore apo nënligjore që kanë rezultuar të nevojshëm gjatë auditimit në lidhje me përballimin e pandemisë Covid-19.

7. Standardet e auditimit: Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit.

Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Ligjin nr. 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò;
-Kodi etik i KLSH dhe Rregullorja e Brendshme.
- ISSAI 100- Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400- Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 4000- Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisëò;
-ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
-Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI ñPër implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisëò; si dhe në praktikat më të mira të fushës.

8. Metodat e auditimit: Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e SUSHN, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuara me akt-konstatimet dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Projekt-Raporti.

9. Dokumentimi i auditimit: Dokumentimi i auditimit është kryer bazuar në kërkesat e manualit të auditimit të përputhshmërisë, në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISAI), për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Spitali Universitar ñShefqet Ndroqiò, funksionon sipas ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003 ñPër shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisëò dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 823, datë 11.06.2008, ñPër kthimin e Spitalit Universitar të Mushkërive ñShefqet Ndroqiò, në Spital Universitar ñShefqet Ndroqiò Tiranë, është person juridik publik buxhetor i nivelit terciar, me kapacitet 300 shtretër, i cili shërben si qendër mjekimi, mësimi dhe kërkimi shkencor.

Sipas rregullores së brendshme, shërbimi mjekësor në Spitali Universitar ñShefqet Ndroqiò ushtrohet në përputhje me:

Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë

Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 *"Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë"i ndryshuar*

Ligji Nr. 8485 për ñ*Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*ò

Ligji Nr. 9106, datë 17.07.2003 ñ*Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë*ò

Ligjit Nr. 7870, datë 13.10.1994 ñ*Për Sigurimet Shëndetësore*ò, *i ndryshuar*

Ligjit Nr. 8615, datë 01.06.2000 ñ*Për Urdhrin e Mjekut*ò, si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që lidhen me veprimtarinë e saj. SUSHN është institucion buxhetor në vartësi të Ministrisë së Shëndetësisë. Fondet e përfituara për ushtrimin e veprimtarisë, janë fondet buxhetore të çelura nga fondi i sigurimit te detyrueshëm të kujdesit shëndetësor për paga sigurime, shpenzime operative dhe nga Ministria e Shëndetësisë për investime sipas programeve dhe fondeve te miratuara me ligjet vjetore të buxhetit të shtetit.

Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2018-2021, si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas programeve, artikujve, produkteve, si dhe projektet me financim të brendshëm. Referuar auditimit të buxhetit si dhe nevojave dhe konsumit të fondeve për vitet 2018 - 2021, ka rezultuar se nga drejtoria e spitalit janë kërkuar fonde brenda tavaneve të miratuara me VKM për programet e shërbimit terciar (spitalet) në një kohë që realisht këto nevoja për fonde janë më të mëdha se tavanet e miratuara, diktuar edhe nga situata e krijuar nga pandemia Covid-19. Për periudhën 2018-2021, institucioni funksionon në bazë të rregullores së miratuar nga Drejtori me nr. 516/1 prot., datë 16.08.2016.Rëndësia e këtij auditimi për KLSH është e përcaktuar nga pikëpamja shoqërore pasi ka të bëjë me çështje shumë sensitive të shëndetit të popullsisë dhe përballimin e sitauatës Covid -19, si dhe duke qenë se institucionet e shëndetësisë kanë probleme në drejtim të fondeve të akorduara të cilat nuk janë të mjaftueshme deri në plotësimin e nevojave të spitalit dhe kushteve optimale të trajtimit të të sëmurëve, auditimi me efektivitet dhe ekonomicitet i fondeve del shumë i rëndësishëm.Grupi i auditimit ka planifikuar auditimin e fondeve në masë të konsiderueshme duke audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës për auditimin e shtrirë në të 3 vitet dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Auditimi i investimeve me fondet buxhetore si për vitin 2018, 2019 dhe 2020 është realizuar 100 %.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në

arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.
Në përfundim të procesit të auditimit për secilin drejtim të Auditimit, rezultoi për sa më poshtë vijon:

2.1. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Strukturave Drejtuese bezueshmërinë ligjore të vendimeve të marra dhe realizimin e tyre.

Spitali Universitar ñShefqet Ndroqiò, është Institucion Shëndetësor Publik Kombëtar mjekimi, mësimdhënieje dhe kërkimi shkencor. Drejtimi administrativ i Spitalit Universitar është në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa drejtimi institucional është në varësi të dyfishtë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si organe që bashkërendojnë veprimtarinë e spitaleve universitare.
Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 823, datë 11.06.2008, ñPër kthimin e Spitalit Universitar të Mushkërive ñShefqet Ndroqiò, në Spital Universitar ñShefqet Ndroqiò Tiranë, Spitali Universitar ñShefqet Ndroqiò është person juridik publik buxhetor i nivelit terciar, me kapacitet 300 shtretër, i cili shërben si qendër mjekimi, mësimi dhe kërkimi shkencor, për rajonin e Tiranës.Sipas rregullores së brendshme, shërbimi mjekësor në Spitalin Universitar ñShefqet Ndroqiò ushtrohet në përputhje me:
Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë
Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 *"Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë"i ndryshuar*
Ligji Nr. 8485 për ñ*Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*ò
Ligji Nr. 9106, datë 17.07.2003 ñ*Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë*ò
Ligjit Nr. 7870, datë 13.10.1994 ñ*Për Sigurimet Shëndetësore*ò, *i ndryshuar*
Ligjit Nr. 8615, datë 01.06.2000 ñ*Për Urdhrin e Mjekut*ò, si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që lidhen me veprimtarinë e tij.
Institucioni funksionon në bazë të rregullores së miratuar nga Drejtori me nr. 516/1 prot., datë 16.08.2016.
Gjithashtu, rregullorja për funksionimin e Spitalit Universitar ñShefqet Ndroqiò Tiranë me nr. 516/1 prot., datë 16.08.2016 është miratuar vetëm nga Drejtori z. P. K., por nuk është e miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 823 datë 11.06.2008 ñPër kthimin e Spitalit të Mushkërive "Shefqet Ndroqi" në Spital Universitar "Shefqet Ndroqi".
Organizimi i spitalit universitar drejtohet nga Drejtori dhe sipas përcaktimit të kryer në rregulloren e brendshme, organi i vetëm ndihmës i spitalit është ***Komisioni Mjekësor Spitalor.***
Edhe pse spitali ka vetëm një organ ndihmës, në rregulloren e brendshme datë 16.08.2016, pika 2.3 Rregullore e funksionimit të Drejtorisë së Spitalit Universitar citon: *"Drejtoria është organi i vetëm ekzekutiv në Spitalin Universitar. Ajo, nën mbikëqyrjen e Këshillit Administrativ drejton dhe organizon veprimtarinë mjekësore, administrative, financiare dhe teknike të Spitalit Universitar".* Spitali Universitar ñShefqet Ndroqiò në rregulloren e re nuk ka Këshill Administrimi prandaj dhe Drejtoria, si organ i vetëm ekzekutiv duhet të rregullojë mënyrën e citimit të funksionimit të saj.Duke u klasifikuar si spital terciar në bazë të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003 ñPër shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisëò, Neni 37 Spitalet terciare Pika 2 citon: ñ*Spitalet terciare funksionojnë me status të veçantë, sipas përcaktimeve të bëra me vendim të Këshillit të Ministrave".*

Baza ligjore referencë për funksionimin e spitaleve terciare është VKM nr. 823 datë 11.06.2008 ñPër kthimin e Spitalit Universitar të Mushkërive "Shefqet Ndroqi" në Spital Universitar "Shefqet Ndroqi", pika 4 e cila citon se *"Mënyra e organizimit struktura dhe rregulloret e funksionimit përcaktohen nga ministri i Shëndetësisë dhe ministri i Arsimit dhe Shkencës"* e përditësuar me VKM nr. 658 datë 10.11.2017 për ñPër miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të spitalit universitar ñShefqet Ndroqiò, Tiranë, ku pika 2 citon *"Mënyra e funksionimit të Spitalit Universitar "Shefqet Ndroqi", Tiranë, si strukturë shëndetësore universitare, përcaktohet në statutin e tij, i cili miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë*ò
Duke u bazuar në rregulloren për funksionimin e Spitalit Universitar ñShefqet Ndroqiò me nr. 516/1 prot., datë 16.08.2016 dhe në referencë të urdhrit të brendshëm me nr. 1185 prot., datë 30.09.2016 është urdhëruar ngritja e këtij komisioni i cili përbëhet nga znj. S. B. , z. A. M. , z. H.H., znj. A. C. , znj. E. D. , z. Y. V. , Znj. L. A. , z. F. M. , znj. L. B. , z. F. C. , z. S. Gj. dhe znj. E. B. .
Me Urdhrine brendshëm nr. 190, datë 24.06.2019 është ngritur ñKomisionit Mjekësor Spitalorò i cili përbëhet nga 31 anëtarë kryesisht mjek, të cilët merren me programimin e buxhetit si nga ana e medikamenteve që do prokurohen dhe nga ana financiare e ligjore.
-Me Urdhrine brendshëm nr. 1/93, datë 07.07.2020 është ngriturñKomisioni Mjekësor Spitalorò i cili përbehet nga 31 anëtarë kryesisht mjekë, të cilët merren me programimin e buxhetit si nga ana e medikamenteve që do të prokurohen ashtu edhe nga ana financiare e ligjore. Komisioni Mjekësor Spitalor me shkresën nr. 96/2 datë 15.11.2020 si pasojë e ngarkesës së madhe dhe tejmbushjes së kapacitetit spitalor ka marrë vendimin për kthimin e ambienteve të konsultave në ambiente shtrimi, meqenëse këtoambiente kanë edhe linjat e oksigjenit gati, stafin mjekësor të gatshëm për përballimin e ngarkesës si pasojë e periudhës së pandemisë Covid-19.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 22/46 prot. datë 27.09.2021ñMbi Projektraportin e Auditimitò, nga z. P. K., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

-Është paraqitur Vendimi për krijimin të Këshillit të Administrimit, i cili u morr në konsideratë nga grupi i auditimit dhe nuk trajtohet në Raportin e Auditimit.

2.2. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Spitali Universitar ñShefqet Ndroqiò (SUSHN), është Institucion Shëndetësor Publik Kombëtar mjekimi, mësimdhënieje dhe kërkimi shkencor. Drejtimi administrativ i Spitalit Universitar është në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa drejtimi institucional është në varësi të dyfishtë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ministrisë së Arsimit e të Shkencës, si organe që bashkërendojnë veprimtarinë e spitaleve universitare.Rregullorja e brendshme e SUSHN, është miratuar nga Titullari i Institucionit ku jepet përshkrimi i detyrave dhe kompetencave për çdo pozicion pune të përcaktuar në strukturë.Struktura në fuqi e Spitalit për periudhën objekt auditimi është miratuar nga Ministria e Shëndetësisë me shkresën nr. 1208 prot., datë 03.03.2017 protokolluar në spital me nr. 1208/1 prot., datë 08.03.2017 dhe ka 436 persona të punësuar.
-Kjo strukturë për periudhën objekt auditimit ka pësuar 13 ndryshime shtesa, pakësime apo ndryshime brenda strukturës sipas rastit.

-Me shkresën nr. 675 prot. datë 26.01.2018 Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka dërguar miratimin e kërkesës nr. 76/3 prot. datë 08.08.2017 për shtimin e numrit të punonjësve me 1 Laborante. Numri ipunonjësve ndryshon nga 436 bëhet 437.
-Me shkresën nr. 1318/1 prot. datë 22.02.2018 Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka dërguar miratimin e kërkesës nr. 76/9 prot. datë 16.02.2018 për ndryshimin në emërtim të stafit pa ndryshuar numrin.
-Me shkresën nr. 1996/1 prot. Datë 26.03.2018 Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka dërguar miratimin e kërkesës nr. 76/17 prot. datë 26.03.2018 për ndryshimin në emërtim të stafit pa ndryshuar numrin.
-Me shkresën nr. 2150/1 prot. Datë 16.04.2018 Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka dërguar miratimin e kërkesës nr. 76/18 prot. datë 23.03.2018 për ndryshimin në emërtim të stafit pa ndryshuar numrin.
-Me shkresën nr. 2682/1 prot. Datë 26.04.2018 Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka dërguar miratimin e kërkesës nr. 76/23 prot. datë 26.04.2018 për ndryshimin në emërtim të stafit pa ndryshuar numrin.
-Me shkresën nr. 3408/1 prot. Datë 01.06.2018 Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka dërguar miratimin e kërkesës nr. 76/45 prot. datë 21.05.2018 për ndryshimin në emërtim të stafit pa ndryshuar numrin.
-Me shkresën nr. 5403/1 prot. Datë 08.10.2018 Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka dërguar miratimin e kërkesës nr. 195/4 prot. datë 8.10.2018 për ndryshimin në emërtim të stafit pa ndryshuar numrin.
-Me shkresën nr. 5886/1 prot. Datë 25.10.2018 Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka dërguar miratimin e kërkesës nr. 76/101 prot. datë 25.10.2018 për ndryshimin në emërtim të stafit pa ndryshuar numrin.
-Me shkresën nr. 5634/1 prot. Datë 13.12.2019 Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka dërguar miratimin e kërkesës nr. 1/173 prot. datë 13.12.2019 për ndryshimin në emërtim të stafit pa ndryshuar numrin.
-Me shkresën nr. 919/1 prot. Datë 24.02.2020 Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka dërguar miratimin e kërkesës nr. 2/21 prot. datë 13.12.2019 ndryshimin në emërtim të stafit pa ndryshuar numrin.
-Me shkresën nr. 540/2 prot. Datë 24.07.2020 Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka dërguar urdhërin nr. 51/2 datë 24.07.2020 ku struktura e SUSHN është shtuarme 20 punonjës (Infermier) për përballimin e situatës të krijuar nga COVID -19.Numri i punonjësve ndryshon nga 437 bëhet 457.
-Me shkresën nr. 1095/4 prot. Datë 05.08.2020 Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka dërguar shkresën me listen emërore të infermierëve të cilët u përgjigjën kërkesës për plotësimin e numrit vacant prej 20 punonjësish për SUSHN.
-Me shkresën nr. 4931/1 prot. Datë 20.11.2020 Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka dërguar miratimin e kërkesës nr. 2/174 prot. datë 02.11.2020 për ndryshimin në emërtim të stafit pa ndryshuar numrin.
Spitali ka në organigramën e vet Drejtorinë me 8 sektorë dhe 1 Njësi Auditimi (sektori i burimeve njerëzore, sektori juridik dhe i prokurimeve, sektori i financës etj) dhe shërbimet mjekësore me 10 sektorë shërbimi (urgjenca, konsulta, pneumologjia etj) dhe 1 Salle operacioni, 1 sektor kujdesi infermieror, 2 Laboratorë (klinik-biokimik dhe bakterologjik), 5 Kabinete (i kardiologjisë, endoskopisë etj), Programi Kombëtar i TB dhe Kontrollit të Infeksioneve si dhe Shërbimin e Urgjencës para-spitalore.

Baza Ligjore për pagat në periudhën Janar 2018- Mars 2019, e përdorur gjatë auditimit është:

VKM nr. 188 datë 15.03.2017 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, ñPër miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosuraò, të ndryshuarò, Pika 12/5 për shtesat e pagës së mjekëve në shërbimin e urgjencës, reanimacionit, hemodinamikës, aksidentet celebrale, mjekë natePika 12/6 për shtesat e pagës së infermierëve në shërbimin e urgjencës, në shërbimin e urgjencës, reanimacionit, hemodinamikës, aksidentet celebraleLidhja nr. 1 (Kreu 1.1) e cila shërben për llogaritjen e pagës së punonjësve me arsim të lartë dhe kryesisht përcaktimi i pagës së grupit, paga e pozicionit, shtesës për kushtet e punës dhe nivelit të vjetërsisë duke u bazuar gjithashtu në librezat e punës dhe dosjet individuale të këtyre punonjësve, Lidhja nr. 2 (Kreu 2.1) cila shërben për llogaritjen e pagës së infermierëve dhe kryesisht përcaktimi i pagës së pozicionit, shtesës për kushtet e punës dhe nivelit të vjetërsisë duke u bazuar gjithashtu në librezat e punës dhe dosjet individuale të këtyre punonjësve, Lidhja nr. 3 për përcaktimin e pagës së grupit sipas nivelit arsimor, Lidhja nr. 4 Struktura dhe nivelet e pagave për mjekët me tituj dhe grada shkencore VKM nr. 555, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave ñPër miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e forcave të armatosuraò.

Baza Ligjore për pagat në periudhën Prill 2019- Dhjetor 2020,e përdorur gjatë auditimit është:
VKM nr. 243 datë 19.04.2019 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, ñPër miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosuraò, të ndryshuarò, Vendim nr. 207, datë 10.3.2020 ñPër dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerëò për situatën e krijuar nga Covid 19.VKM nr. 188 datë 15.03.2017 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, ñPër miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosuraò, të ndryshuarò, Pika 12/5 për shtesat e pagës së mjekëve në shërbimin e urgjencës, reanimacionit, hemodinamikës, aksidentet celebrale, mjekë neonate.
Pika 12/6 për shtesat e pagës së infermierëve në shërbimin e urgjencës, në shërbimin e urgjencës, reanimacionit, hemodinamikës, aksidentet celebrale.
Lidhja nr. 1 (Kreu 1.1) e cila shërben për llogaritjen e pagës së punonjësve me arsim të lartë dhe kryesisht përcaktimi i pagës së grupit, paga e pozicionit, shtesës për kushtet e punës dhe nivelit të vjetërsisë duke u bazuar gjithashtu në librezat e punës dhe dosjet individuale të këtyre punonjësve, Lidhja nr. 2 (Kreu 2.1) cila shërben për llogaritjen e pagës së infermierëve dhe

kryesisht përcaktimi i pagës së pozicionit, shtesës për kushtet e punës dhe nivelit të vjetërsisë duke u bazuar gjithashtu në librezat e punës dhe dosjet individuale të këtyre punonjësve, Lidhja nr. 3 për përcaktimin e pagës së grupit sipas nivelit arsimor,Lidhja nr. 4 Struktura dhe nivelet e pagave për mjekët me tituj dhe grada shkencore VKM nr. 555, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave ñPër miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e forcave të armatosuraò, Janë përzgjedhur 6 muaj në total, përkatësisht nga 2 muaj/çdo vit auditimi për verifikimin e strukturës totale plan fakt dhe është respektuar struktura e miratuar si më poshtë:

Numri i personave sipas listë pagesës dhe bankës ku tërheqin pagën	**Mars 2018**	**Shtator 2018**	**Shkurt 2019**	**Gusht 2019**	**Prill 2020**	**Dhjetor 2020**
B.	13	15	13	13	12	13
CR.	383	380	385	385	394	408
RA.BA.	0	0	2	5	4	5
IN. S. PA.	5	5	4	4	4	4
Procr.Ba.	0	0	0	0	0	1
SOC. GE. (O. Ba.)	0	1	0	0	0	0
ALP. BA.	0	1	1	1	1	1
Totali i personave të punësuar	401	402	405	408	415	432
Nr i personave të miratuar në strukturë	437	437	437	437	437	457

Burimi:SUSHN

Gjithashtu, janë përzgjedhur 3 sektorë: Shërbimi i Urgjencës, Shërbimi i Mjekësisë Interne dhe Shërbimi i Urgjencës Para-spitalore dhe konstatohet se struktura e përgjithshme respektohet si në total si brenda çdo nënndarje të saj por ka gjithashtu ndryshime ose lëvizje shumë të vogla.Nuk ka tejkalim të strukturës brenda sektorëve.Nga auditimi i listëpagesave për periudhën objekt auditimi, vihet re se nuk ka mënyrë uniforme të ndalesës së aplikuar për urdhrin e mjekut dhe tëinfermierit. Në vitin 2018, në listëpagesën e muajit shtator 2018 mbahet kjo ndalesë për mjekë dhe infermierë për 3 muaj bashkë. Në vitin 2019 urdhri i mjekut ndalet në dhjetor 2019 në vlerën totale prej 1200 lekë kurse urdhri i infermierit në vlerën totale prej 300 lekë. Ndërkohë në vitin 2020, në listëpagesat e muajit dhjetor 2020 ndalesa e kuotës për urdhrin e mjekut dhe të infermierit ndalet e gjitha në fund të vitit për në kuotën 1200 lekë dhe 300 lekë specifikisht. Kuotizacionet të cilat janë prej 100 lekë në muaj rregullohen me Statutin e Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë (më tej Urdhri ose UMSH) i cili është i bazuar në Ligjin Nr. 123/2014, datë 25.09.2014 ñPër Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisëò, Ligjin Nr. 10106, datë 30.03.2009 ñPër Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisëò dhe Ligjin 10171, datë 22.10.2009 ñPër profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisëò si dhe Ligjin nr. 9718, datë 19.4.2007 Për Urdhrin e Infermierit në Republikën e Shqipërisë**,** në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Ligjin nr. 10462, datë 13.9.2011 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9718, datë 19.4.2007 ñPër Urdhrin e Infermierit në Republikën e Shqipërisëòligjnr. 124/2014 Për disa Shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9718, datë 19.4.2007, ñPër Urdhrin e Infermierit në Republikën E Shqipërisëò, i ndryshuar.Mënyra e ndalesës së kuotizacionit nuk është uniforme për mjekët dhe infermierët duke ndikuar në ndryshimin e nivelit të pagës së tyre neto gjatë muajve. Duhet të rishikohet mundësia e

ndalesës uniforme të kuotës dhe gjithmonë brenda vitit për të mos kundërshtuar statutin e urdhrit të mjekëve dhe të infermierëve në Republikën e Shqipërisë.

Janë audituar listë pagesat me zgjedhje për vitet 2019 dhe 2020.

Nga grupi i auditimit, janë ri-llogaritur pagat e grupit për verifikimin e saktësisë së pasqyrimit të vjetërsisë së 18 punonjësve të përzegjur nga i njëjti grup për muajt maj 2018, maj 2019, maj 2020*(Aneksi nr.1)*. Janë auditur një listë e njejtë punonjësish të cilët përmbushin vjetërsinë në punë në muajin maj për të verifikuar saktësine e paraqitjes së vjetërsisë në punë dhe po i njejti grup është audituar edhe për një muaj më vonë, përkatësisht muajt qershor 2018, qershor 2019 dhe qershor 2020 dhe janë evidentuar mangësi dhe parregullsi të cilat trajtohen më poshtë:

Titulli i gjetjes:	Mangësi në aplikimin e shtesës/vjetërsi
Situata:	Nga grupi i auditimit janë ri-llogaritur pagat e grupit dhe aplikimet e vlerës së vjetërsisë për kategorinë e punonjësve të cilët e përmbushin vitin e punës në muajin maj të çdo viti periudhë auditimi. Nga rillogaritja kanë rezultuar diferenca pozitive të cilat nënkuptojnë që për disa punonjës nuk reflektohet në kohë reale përmbushja e vjetërsisë sipas regjistrit të burimeve njerëzore.
Kriteri:	Veprimet janë në kundërshtim me VKM nr. 188 datë 15.03.2017 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, ñPër miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosuraò, të ndryshuarò, Lidhja nr. 3 për përcaktimin e pagës së grupit sipas nivelit arsimor (për periudhën maj 2018) si dhe VKM nr. 243 datë 19.04.2019 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, ñPër miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosuraò, të ndryshuarò, Lidhja nr. 3 për përcaktimin e pagës së grupit sipas nivelit arsimor (për periudhën maj 2019, maj 2020)
Ndikimi:	Në pagë
Shkaku	Neglizhencë
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Departamenti i burimeve njerëzoretë marrë masa për përditësimin dhe transmetimin e informacionit në kohë reale të vjetërsisë së punës për çdo punonjës në muajin përkatës. Të kryhet përditësimi i vazhdueshëm i dosjeve të punonjësve dhe reflektimi i arsimit përkatës në bazë të të cilave hartohen edhe komponentët e pagës.

Titulli i gjetjes:	Mangësi në llogaritjen e tatimit

Situata: Nga auditimi i punonjësve me kontratë dhe pedagogëve kryesisht struktura dhe nivelet e pagave për mjekët me tituj dhe grada shkencore është konstatuar se për listën e pedagogëve, nga paga bruto ndalet vetëm tatimi në burim duke u konsideruar marrëdhënia e punësimit si shërbim në referencë të Ligjin Nr. 94/2018 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, ñPër tatimin mbi të ardhuratò, të ndryshuar. Këtyre pedagogëve iu ndalet nga paga vetëm niveli prej 15% tatimi në burim. Për listën e punonjësve me kontratë, edhe pse janë mjekë me tituj shkencor konsiderohen si të punësuar të përhershëm dhe mbi pagën e tyre bruto llogariten dhe ndalen të gjitha kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat personale sipas kufijve të përcaktuar në Ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993 ñPër sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisëò, të ndryshuar si dhe Ligjin Nr. 94/2018 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, ñPër tatimin mbi të ardhuratò, të ndryshuar. Pedagogëve me kontratë pune iu ndalet nga paga 9.5% për sigurimet shoqërore, 1.2 % për sigurimet shëndetësore dhe 13% TAP për nivelin e pagës mbi 30,000 lekë.

Ka dy standarde në mënyrën e trajtimit të punonjësve me gradë shkencore

Kriteri: Ligji nr. 9136, datë 11.9.2003 i ndryshuar, Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë,

Neni 8 Llogaritja e kontributeve për punëmarrësin

1. Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të punëdhënësit për punëmarrësin dhe kontributet e vetë punëmarrësit llogariten sipas nivelit të përcaktuar mbi pagën bruto të punëmarrësit **dhe shtesat e tjera me karakter të përhershëm** që lindin nga marrëdhëniet e punës, brenda një page bruto minimale dhe nivelit maksimal të pagës, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore, që përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

2. Kontributet e detyrueshme të sigurimit shëndetësor të punëdhënësit për punëmarrësin dhe kontributet e vetë punëmarrësit llogariten sipas nivelit të përcaktuar mbi pagën bruto të punëmarrësit **dhe shtesat e tjera me karakter të përhershëm** që lindin nga marrëdhëniet e punës, e cila nuk mund të jetë më e vogël nga paga minimale e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Çdo lloj shtese e një karakteri të përhershëm i bashkohet pagës dhe mbi të ndalen kontributet e sigurimit shoqëror, shëndetësor dhe tatimi mbi të ardhurat personale. Nëse pedagogët do ishin të punësuar me shkëputje gjatë vitit, atëherë paga e tyre do të konsiderohej shërbim dhe do të nbahej vetëm tatimi në burim.

Ndikimi: Në kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësor

Shkaku Kontrata e shërbimit

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Nga strukturat drejtuese te merren masa për trajtim të barabartë dhe uniform të të punësuarve në referencë të bazës ligjore si dhe në respektim të Kodit të

Punës së Republikës së Shqipërisë, për llogaritjen e nivelit të pagave dhe për ndalimin e dy standardeve për punonjësit e tyre.

Janë audituar shpërblimet për Covid gjatë periudhës mars 2020 - shkurt 2021.

Për këtë qëllim, me VKM nr. 207, datë 10.03.2020 ñPër dhënie shpërblimi për personelin mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerëò, është përcaktuar masa e shpërblimit, kategoritë përfituese dhe fondi për përballimin e këtij shpërblimi.
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në zbatim të VKM nr. 207, datë 10.03.2020, ka nxjerrë shkresën nr. 1429/1, datë 12.03.2020 ñDhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerëò dhe Urdhrin e Ministrit nr. 224, datë 01.04.2020 ñPër dhënien e shpërblimit dhe miratimin e listës emërore të përfituesve, përfshirë ditët e angazhimit në diagnostikimin dhe trajtimin e personave të prekur nga Covid-19ò, ku janë përcaktuar veprimet që duhen ndjekur dhe dokumentacioni që duhet plotësuar për këtë qëllim. Edhe pse nuk përfshihen apo nuk marrin pjesë në diagnostifikim, distancimi social për këtë staf me stafin mjekësor ka qenë i pamundur, duke e bërë dhe të pa shmangshme kontaktin me to. Për këtë kategori punonjësish është marrë edhe konfirmimi nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Tabela nr. 3

Shpërblimet Administrata				
Muaji	**Viti**	**Shpërblimi bruto**	**Tatimi**	**Shpërblimi Neto**
			15%	
Mars	2020	0	0	0
Prill	2020	2,594,091	389,114	2,204,977
Maj	2020	1,559,999	234,000	1,325,999
Qershor	2020	183,182	27,477	155,705
Korrik	15.05.2020-31.07.2020	1,704,773	255,716	1,449,057
Gusht	2020	2,236,591	335,489	1,901,102
Shtator	2020	2,490,735	373,610	2,117,125
Tetor	2020	2,682,674	402,401	2,280,273
Nentor	2020	2,472,955	370,943	2,102,012
Dhjetor	2020	2,481,818	372,273	2,109,545
Janar	2021	2,467,046	370,057	2,096,989
Shkurt	2021	2,632,500	394,875	2,237,625
TOTALI		**23,506,364**	**3,525,955**	**19,980,409**

Burimi: SUSHN

Janë audituar aplikimet e pagës në kohën e ndryshimit të ligjit, VKM nr. 243 datë 19.04.2019 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, ñPër miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosuraò, të

ndryshuarò, i cili ka hyrë në fuqi në datën 1 prill 2019. Të gjithë ndryshimet e niveleve të pagave të pozicionit janë reflektuar në muajin maj duke krijuar diferenca në pagat neto dhe bruto për punonjës mjek dhe infermiere. Gjithashtu pagat e krijuara si diference nga ligji janë llogaritur ne mes muaji dhe janë reflektuar në liste-pagese të veçantë.

Emërtimi	**Shtesa për pozicion**		
Lidhja nr 1 (Kreu 1.1)	**VKM nr. 188**	**VKM nr. 243**	**Diferenca**
Shef Shërbimi	71,000	74,000	3,000
Shef Reparti	62,700	64,500	1,800
Shef kabineti/sektori	56,650	58,900	2,250
Mjek	53,000	57,000	4,000
Stomatolog	53,000	57,000	4,000
Epidemiolog	53,000	57,000	4,000
Biolog	53,000	57,000	4,000
Kimist	53,000	57,000	4,000
Lidhja nr 2 (Kreu 2.1)			
K/Infermier	37,400	40,000	2,600
Shef sektori inf	37,400	40,000	2,600
K/Laborant	37,400	40,000	2,600
Infermier	35,200	38,000	2,800
Laborant	31,000	33,500	2,500
Inf pavijoni	30,000	32,100	2,100

Nga auditimi rezulton se është mbajtur regjistri i pagave në referencë të Kodit të Punës, Neni 95 i cili citon: Punëdhënësit janë të detyruar të mbajnë regjistrat e pagave dhe të derdhjes së kontributeve të aktualizuara çdo muaj për të gjithë punëmarrësit, të cilët punojnë për ta dhe ta paraqesin këtë regjistër sa herë do të kërkohet nga inspektorët e punës dhe inspektorët e autorizuar të administratës tatimore. Punëdhënësit duhet të mbajnë një regjistër, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj, ku të shënohet për çdo punëmarrës data e fillimit të punës, kohëzgjatja e pushimit që i takon, datat në të cilat janë marrë pushimet dhe pagën e dhënë për pushimet vjetore të paguara. Të ardhurat dytësore të cilat janë përdorur për paga:
Plani 2018 çelur në thesar - 4,401,000lekë (paga +sigurime), fakti 2,280,000 lekë
Plani 2019 çelur në thesar - 7,418,000 lekë (paga +sigurime), fakti 3,483,000 lekë
Plani 2020 çelur në thesar - 5,716,000 lekë (paga +sigurime), fakti 4,976,000 lekë
I gjithë fondi i pagave i përdorur për këta persona është brenda kufirit të miratuar
Spitali Universitar ñShefqet Ndroqiò ka lidhur kontratë me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor me nr. 128 prot në datë 12.02.2018. Gjithashtu është lidhur kontrata kolektive e punës e nivelit të parë midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Punonjësve të Shëndetësisë të Shqipërisë për periudhën 2018-2021 protokolluar në Spitalin Universitar me nr. 1308/1 prot., datë 26.02.2018.
Gjithashtu nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të 15 punonjësve për procedurat e emërimit në Spitali Universitar ñShefqet Ndroqi nuk janë konstatuar mangësi në procedurën e përzgjedhjes së aplikantëve, kandidatët fitues plotësojnë të gjitha kushtet e shpallura në njoftim, janë të

dokumentuara vlerësimi me pikë i intervistës dhe kritereve të vlerësimit nga komisioni ad-hoc, në disa raste urdhri i emërimit nuk ka pagën të specifikuar duke mos respektuar të gjitha kriteret e Urdhrit Nr.511 datë 13.12.2011 të Ministrisë së Shëndetësisë, ñPër kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor publikò. Nga auditimi i këtyre dosjeve nuk ka mospërputhje midis nivelit arsimor dhe vendit të punës.
Gjatë periudhës objekt auditimi, punësimet dhe largimet janë pasqyruar në tabelë:

	VITI 2018		VITI 2019		2020	
Pozicioni	**Punësime**	**Largime**	**Punësime**	**Largime**	**Punësime**	**Largime**
Administratë	3	2	4	1	1	2
Sektori teknik	0	1	1	1	4	3
Hoteleria	0	1	0	1	1	2
Mjekë	7	6	7	7	3	4
Infermierë	24	19	20	20	28	9
Laborantë	3	1	0	0	3	3
Sanitarë	0	0	3	3	1	2

Për periudhën 2018-2020, nga auditimi i proceseve gjyqësore u konstatua se për periudhën objekt auditimi pranë SUSHN është regjistruar vetëm 1 Proces gjyqësor me paditës A. A. , ish punonjës i SUSHN në pozicionin Shofer Ambulance për periudhën deri në prill të vitit 2016, me Objekt padie detyrimin e palës së paditur për të përmbushur detyrimet që lindin nga zgjidhja e kontratës së punës pa afat të përcaktuar midis palës së paditur, punëdhënësit ñS.U.SH.Nò, dhe paditësit punëmarrësit, A. A. .
Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin Nr. 6506 Vend., datë 07.10.2019, ka vendosur dëmshpërblim me 17.5 paga në total me një vlerë prej 17.5 x 36,178 lek/muaj =**633,115 lekë**. Ky vendim është ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe është në proces.

Titulli i gjetjes:	Shpërblim i padrejtë punonjësve
Situata:	Nga auditimi rezulton se janë dhënë shpërblime COVID për punonjës të administratës dhe për punonjës të cilët nuk marrin pjesë në diagnostikimin e të sëmurëve Covid ku përfshihen profesione si ekonomiste, juristë, arshivistë, kostoist, magazinier, kaldajist, elektricist, lulishtar, punëtor lavanterie, zhbllokues, specialist ushqimi etj. Shpërblimi neto në vlerën prej **19,980,409 lekë** përbën efekt negativ financiar.
Kriteri:	Veprimet janë kundërshtim me VKM nr. 207 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, datë 10.03.2020 ñPër dhënie shpërblimi për personelin mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerëòdatë si dhe shkresën nr. 1429/1, datë 12.03.2020 ñDhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerëò
Ndikimi:	Efekt negativ në fondet buxhetore
Shkaku	Kthimi i të gjithë Spitalit në COVID-19
Rëndësia:	I lartë

Rekomandimi:	-Nga Drejtoria e Spitalit Universitar ñShefqet Ndroqiò në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masa që shpërblimi për COVID-19 tõ jepet vetëm punonjësve të cilët kanë kontakt të drejtpërdrejtë me pacientë të kontaminuar dhe që kontribuojnë në diagnostikimin e të sëmurëve. -Strukturat drejtuese dhe departamenti i financës të marrin masa dhe të ndërpritet dhënia e shpërblimit për çdo punonjës që nuk kontribuon drejtpërdrejt në diagnostikimin e të sëmurëve me COVID-19.

2.3. Mbi planifikimin e Buxhetit, si edhe shpenzimet administrative.

Lidhur me zbatimin e kritereve në planifikimin e buxhetit sipas ligjeve dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
-Statuti i SUSHN
-Rregullorja e brendshme e SUSHN
-Akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e institucionit
-Dokumentacioni i PBA-ve të miratuara nga SUSHN gjatë periudhës objekt auditimi
-Buxheti i miratuar dhe ndryshimet e kryera gjatë vitit
-Realizimi i shpenzimeve me planifikimet

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Financimi i SUSHN kryhet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm i Kujdesit Shëndetësor për shpenzimet për paga, sigurime, mallra e shërbime dhe për shpenzimet për investime nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
Statuti i SUSHN, kreu i dytë, pika 2.8, c, përcakton detyrat e Këshillit Drejtues, për miratimin e projekt buxhetit vjetor, i cili aprovohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
-Duke qenë se në SUSHN, nuk është i ngritur Këshilli Administrativ, i cili është organi më i lartë i administrimit, hartimi i projekt buxhetit është përgatitur nga drejtori i institucionit duke tõu përcjellë Ministrisë për aprovim.
Grupet e punës të caktuara nga drejtori i SUSHN, kanë hartuar propozimet në sasi e vlerë të zërave të PBA.
-Nga auditimi i dokumenteve të planifikimit të buxhetit për periudhat 2018-2020, u konstatua se hartimi i nevojave të SUSHN për barna dhe materiale mjekësore, është kryer me procedura jo të analizuara dhe jo të argumentuara për vlerat e përcaktuara.
Me urdhrin e brendshëm nr. 248/1 Prot., datë 12.06.2017, drejtori i SUSHN, ka urdhëruar ngritjen e grupeve të punës për hartimin e propozimeve në sasi e vlerë të zërave të Projekt-Buxhetit për vitin 2018.
Me shkresën nr. 248/20 Prot., është dërguar për miratim në Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, PBA për vitet 2018-2020. Më datë 15.02.2018, me shkresën nr. 201/3 Prot., është marrë aprovimi nga Ministria.

Emërtimi Buxhetit	Buxheti fillim viti	Kërkesa 2018	Shtesa 2018	Pakësime 2018	Buxheti 31.12.18	Realizimi 2018	%

600 paga (buxhet)	282,400		25,496		307,896	304,374	98.80%
601sig.shoq shëndetësore	46,950		3,100		50,050	49,076	98%
606 (përdorim f.veçåntë)			903			793	88%
602 (buxhet)	300,000	60,000	38,000		338,000	337,988	99.99%
231 (buxhet)			142,465	81,670	60,795	60,795	100%
Shuma buxhet	**629,350**	**60,000**	**209,964**	**81,670**	**398,795**	**753,026**	
600 paga (te ardhurat)	696				4,401	2,280	52%
602 (te ardhurat)	37				37		0
231 (te ardhurat)	1,940				13,053	7,252	56%
Shuma e të ardhurave	**2,673**	**60,000**	**209,964**	**81,670**	**17,491**	**9,532**	
Shuma gjithsej	**632,023**	**60,000**	**209,964**	**81,670**	**416,286**	**762,558**	

Emërtimi i projektit	**Plani 2018**	**Fakti 2018**	**% realizimit**
Furnizim vendosje makineri pajisje për sistemin e kondicionimit ne ambientet e SU ñ Shefqet Ndroqiò	60,030	60,030	100%
Supervizim i Furnizim vendosje makineri pajisje për sistemin e kondicionimit ne ambientet e SU ñ Shefqet Ndroqiò	765	765	100%
Investime buxhet	**60,795**	**60,795**	**100%**
Investime gjithsej	***60,795***	***60,795***	**100%**

Buxheti i planifikuar për vitin 2018 ka qenë 720,671,000 lekë.
Në pjesën më të madhe buxheti i realizuar është në 98 % të pjesës së parashikuar, me përjashtim të pagesave të pagave nga të ardhurat dytësore në masën 52%.
Për vitin 2019, FSDKSH, me shkresën nr. 227/2 Prot., datë 15.02.2019, ka njoftuar SUSHN, për çeljen buxhetit vjetor, të detajuar për muaj. Ky buxhet është miratuar me VKM nr.46, datë 30.01.2019, ñPër financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2019ò. Vlera totale e buxhetit të miratuar është 653,000,000 lekë. Gjithashtu me shkresën nr. 1151 Prot., datë 28.02.2019, FDSKSH, ka akorduar fondin shtesë për paketat shëndetësore në vlerën 61,600,000 lekë.

Emërtimi Buxhetit	**Realizimi 2018**	**Buxhet fillim viti**	**shtesa 2019**	**buxheti 31.12.19**	**Realizimi 2019**	**%**
600 paga (buxhet)	304,374	295,000	20,845	315,845	314,418	99.5%
601 sig. shoq shëndetësore	49,076	48,000	3,800	51,800	50,789	98%
606 fondi i veçantë	793		554	554	554	100%
602 (buxhet)	337,988	310,000	80,000	390,000	389,769	99.9%
231 (buxhet)	60,795		130,696	130,696	118,089	90%
Shuma buxhet	**753,026**	**653,000**	**235,895**	**888,895**	**873,619**	
600 paga (te ardhura)	2,280	2,120	5,299	7,419	3,483	45%

602 (të ardhura)		37		37	37	0
231(të ardhura)	7,252	5,801	15,897	21,698	20,948	96%
Shuma të ardhura	**9,532**	**7,958**	**21,196**	**29,154**	**24,468**	
Shuma gjithsej	***762,558***	***660,958***	***257,091***	***918,049***	***898,087***	

Burimi: SUSHN

Për periudhën 2019, zëri 231 është realizuar në masën 90% për arsye se OE nuk kanë paraqitur situacionet dhe faturat përkatëse për tu likuiduar.
Në zërin 600 ñpagaò nga të ardhurat e veta, janë realizuar në masën 45 % për arsye të gjykimit të drejtimit.
Nga MSHMS me shkresën nr. 417/2 Prot., datë; 04.02.2019, ka bërë me dije për çeljen e buxhetit për vitet 2019-2021 për shpenzime kapitale, me vlera si vijon:

Emërtimi i projektit	**Plani 2019**	**Fakti 2019**	**%**
Furnizim vendosje makineri pajisje për sistemin e kondicionimit	115,386	106,515	92%
Supervizim i Furnizim vendosje makineri pajisje për sistemin e kondicionimit	1,656	1,455	89%
truksion i ambienteve te laboratorit te Mikrobiologjisë ne SU ñ Shefqet Ndroqi ñ	6,400	6,400	100%
Supervizimi Rikonstruksion i ambienteve te laboratorit te Mikrobiologjisë	138	134	97%
Supervizimi i Rikonstruksion i ambienteve te Reanimacionit te Kardiokirurgjisë.	133	57	43%
Rikonstruksion i ambienteve te Reanimacionit te Kardiokirurgjisë	6,548	3,528	54%
Blerje Dollapë	434		0
Investime buxhet	**130,695**	**118,089**	

Burimi: SUSHN

Nga auditimi i formateve të plotësuar të projektbuxhetit rezultoi se janë plotësuar nevojat konform formateve të miratuar dhe brenda afateve të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave.
Nga SUSHN janë mbajtur në mënyrë të përmuajshme situacionet të konfirmuara nga thesari për shpenzimet dhe për të ardhurat.
Për vitin 2020, Spitali Universitar Shefqet Ndroqi, Tiranë, me Urdhrin e Ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr.413, datë 13.07.2020, ka kaluar në Spital Covid.
1. Kërkesë nr. 87/20, datë 13.07.2020, drejtuar Ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për shtesë fondesh për mbulimin e nevojave me materiale mjekimi dhe konsumi.
Fondi i kërkuar 18,926,400 lekë.
2. Kërkesë nr. 117/2, datë 28.07. 2020, drejtuar Ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për shtesë fondesh për mbulimin e nevojave me oksigjen.
Fondi i kërkuar 114,306,875 lekë.
3. Kërkesë nr. 34/71, datë 29.07. 2020, drejtuar Ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për shtesë fondesh për mbulimin e nevojave me mjete për mbrojtjen personale për përballimin e situatës COVID-19, për nevoja spitalore emergjente për një periudhë 90 ditore.
Fondi i kërkuar 73,745,000 lekë, ose 88,494,000 lekë me tvsh.
4. Kërkesë nr. 34/76, datë 06.08. 2020, drejtuar Ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për shtesë fondesh për mbulimin e nevojave për barna ekstra deri në 31.12.2020.
Fondi i kërkuar 112,259,485 lekë. (periudha gusht-dhjetor)

5. Kërkesë nr. 34/92, datë 07.08. 2020, drejtuar Ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për shtesë fondesh për mbulimin e nevojave me mjete për mbrojtjen personale për përballimin e situatës COVID-19, për nevoja spitalore emergjente për një periudhë 90 ditore.
Fondi i kërkuar 73,570,000 lekë,
6. Kërkesë nr. 157, datë 25.11. 2020, drejtuar Ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për shtesë fondesh për mbulimin e nevojave për barna për terapinë anti COVID-19.

Të dhëna për zërat e buxhetit të akorduar dhe realizimin për periudhën 2020.

Emërtimi Buxhetit	Realizimi 2019	Buxhet fillim viti	kërkesa 2020	shtesa 2020	pakësim e 2020	Buxheti 31.12.20	Realizimi 2020	%
600 paga (buxhet)	314,418	309,000	202,945	296,534	0	605,534	605,514	99.99
601 sig. shoq.shënd.	50,789	53,700			590	53,110	52,804	99.42
606(përdorim f.vecantë)	554	0		597		597	554	92.79
602 (buxhet)	389,769	310,000	802,965	518,000	0	828,000	827,999	99.99
231 (buxhet)	118,089			99,163	87,000	12,163	3,089	99.99
Shuma buxhet	***873,619***	**672,700**	**1,005,910**	**914,294**	**87,590**	**1,499,404**	**1,489,960**	
600paga(të ardhura)	3,483	3,936		1,780		5,716	4,976	87.05
601sig.Shoq, shend.				0				
602 (te ardhura)		37		0		37	27	72.97
231(te ardhura)	20,948	749		4,669		5,418	5,417	99.98
Shuma të ardhura	**24,431**	**4,722**		**6,449**		**11,171**	**10,420**	
Shuma gjithsej	***898,050***	***677,422***	***1,005,910***	***920,743***	***87,590***	***1,510,575***	***1,500,380***	

Burimi: SUSHN

Titulli i Gjetjes Mos argumentim dhe mbajtje e gjurmës së auditimit për planifikimin e nevojave për barna

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se, për planifikimin e nevojave vjetore për barna dhe materiale mjekësore nga Shërbimet mjekësore në SUSHN, gjatë hartimit të projektbuxhetit dhe planit buxhetor (pas miratimit), nuk bëhet analizë mbi gjendjen e ilaçeve, sasinë e konsumit të tyre vjetore, në mënyrë që të justifikojnë dhe argumentojnë listën për nevojat e këtyre barnave. Rritja e sasive të barnave të porositura nuk është e shoqëruar me relacione shpjeguese dhe argumentuese për justifikimin e sasive shtesë.

Kriteri: Udhëzimi nr. 7, ñPër procedurat standarde të përgatitjes së PBAò datë 28.02.2018, pika 6. Metodologjia e përcaktimit të politikave ekzistuese dhe politikave të reja ku citohet: *Mallrat dhe shërbimet (602).Gjatë përgatitjes së kostos për vitin bazë për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, NJQQ duhet të udhëhiqen nga parimet e mëposhtme: Analizimi i informacionit rreth shpenzimeve për aktivitetet aktuale dhe punën për mirëmbajtjen të dy deri në tre vitet e fundit; -Analizimi i dinamikës për të vlerësuar kostot e nevojshme për të ruajtur sasinë dhe cilësinë gjatë vitit të ardhshëm buxhetor.- Të dhënat historike mund të ndryshojnë nga njëri viti në tjetrin për*

shkak të përfundimit të projekteve, fillimit të disa shërbimeve të reja, ndryshimeve dhe iniciativave të tjera. Kjo, për shembull, i referohet përshtatjes së shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes për investimet e përfunduara në ciklet e ardhshme të buxhetit; - Gjatë përgatitjes së parashikimeve për këto zëra, kërkohet informacion për koston për njësi, parametra të çmimit të vendosur nga ministria përgjegjëse për financat, si dhe parametra të përfitimeve nga efiçenca.
Si dhe me ligjin nr. 10 296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Neni 4, pika 19 dhe neni 16, ku citohet: "Gjurma e auditimit" përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve. Neni 16 Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit, 1. Ministri i Financave është përgjegjës për miratimin e gjurmëve standarde të auditimit, që lidhen me procedurat e unifikuara për të gjitha njësitë e sektorit publik. 2. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. 3. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Ndikimi/Efekti: Mos kryerja e analizave dhe mos argumentimi i tyre sjellin rritjen e barnave stok, si dhe rritjen e riskut për tu kaluar afati i skadencës.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Strukturat drejtuese në vazhdimësi të marrin masa për ndjekjen e procedurave të hartimit të PBA, duke siguruar që planifikimet të kryhen mbështetur në analiza të dinamikës të vlerësimit të kostove të nevojshme për ruajtjen e sasisë dhe cilësisë të shërbimeve të ofruara, vlerësimin e të dhënave historike të shpenzimeve, kostove për njësi, parametrave e çmimeve vendosur nga MSHMS dhe efiçencës dhe argumentimin e tyre.

Titulli i Gjetjes Mos paraqitja e raporteve të monitorimit në MSHMS

Situata: Për periudhën 2018-2020, SUSHN nuk ka paraqitur raporte monitorimi në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në kundërshtim me ligjin për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe ligjin për MFK. Mos hartimi dhe mos paraqitja e raporteve të performancës dhe zbatimit të buxhetit, rrit riskun e mos realizimit të objektivave të vendosura nga Institucioni, dhe

mungesës së monitorimit nga Ministria përkatëse.

Kriteri: Veprime në kundërshtim të nenit 65 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, në të cilin citohet: "*NAi një njësie të qeverisjes qendrore, i paraqet, sa herë që kërkohet, por jo më pak se katër herë në vit, NPA-së, Raportet e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar për çdo program të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të PBA-së*", dhe Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012, ñPër procedurat standarde të zbatimit të Buxhetitò, i ndryshuar, kreu VI, raportet e monitorimit, pika 253, ku citohet: *Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze në lidhje me procesin e zbatimit të buxhetit, nivelin e performancës gjatë realizimit të objektivave dhe trajtimin e risqeve të lidhura me to, të evidentuara gjatë takimeve periodike midis menaxherëve dhe raporteve të monitorimit, parashtrohen nga nëpunësi autorizues në mbledhjet periodike të grupit për menaxhimin strategjik të kryesuar nga titullari i njësisë së qeverisjes së përgjithshme, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe miratimin e masave konkrete për përmirësimin e procesit dhe minimizimin e risqeve (duke përcaktuar dhe drejtuesin përgjegjës për menaxhimin e tyre).254. Rregullat për raportimin mbi performancën gjatë zbatimit të buxhetit specifikohen në mënyrë të detajuar, në udhëzimin e Ministrit të Financave "Për zbatimin e procedurave të monitorimit". Raportet e monitorimit duhet të përfshijnë informacion mbi arritjet në terma sasiore dhe të vlerave të produkteve të realizuara; të identifikojnë mosarritjet dhe të shpjegojnë shkaqet e tyre duke propozuar në të njëjtën kohë masa për përmirësimin e situatës.*

Ndikimi/Efekti: Mos plotësimi i procesit të monitorimit të performancës financiare të objektivave të politikës së programeve dhe produkteve të parashikuara në buxhetet vjetore bën të pamundur ndjekjen e arritjes së qëllimit dhe objektivave të synuar, evidentimin e realizimit të produkteve në përputhje me planin, analizën krahasimore të të dhënave, mos sigurimin e informacionit për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, mos garantimin e transparencës institucionale pasi të dhënat lidhur me performancën financiare nuk rezultojnë të publikuara në faqen zyrtare të SUSHN.

Shkaku: Mungesë vëmendje nga hallkat drejtuese.

Rëndësia: E mesme

Rekomandime: Drejtori i institucionit, në cilësinë e nëpunësit autorizues, të marrë masa për hartimin e raporteve të monitorimit për proceset e realizimit të objektivave dhe treguesve buxhetorë sipas formateve të Ministrisë së Financës, raportimin dhe publikimin e tyre në faqen web, për efekt të transparencës me publikun.

Në lidhje me barnat e skaduar në fund të periudhës 2018, me veprimin kontabël nr. A328, kërkesa e shefit i shërbimit të farmacive, B. G., për heqjen nga inventari i farmacisë, është përfunduar.
Vlera kontabël është 126,529 lekë, që përbëhet nga ñSalbutamolò, 839 flakon, me cmim 150 lek/copë, vlerë totale 125,850 lekë, të skaduar më 31.05.2016, ñGlibenclamideò, 220 tableta me çmim 2.42 lekë/copë, me vlerë totale 532.4 lekë, skaduar më 31.12.2015, ñAmidoaroneò, 17 tableta me çmim 8.84 lekë/copë, me vlerë totale 146.88 lekë, skaduar me 31.03.2018.
Për veprimet e mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi n/drejtori ekonomik S.Gj., në cilësinë e NZ të institucionit.

2.4. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si edhe menaxhimin e aktiveve të spitalit.

Për zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
Dokumentacioni i pasqyrave financiare.
Dokumentacioni i regjistrimit të llogarive kontabël.
Dokumentacioni mbi hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare.
Dokumentacioni i mbajtur mbi përllogaritjen, njohjen, pagesën dhe regjistrimin e detyrimeve fiskale.
Dokumentacioni i mbajtur mbi debitorët dhe kreditorët.
Dokumentacioni për menaxhimin e aktiveve.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:
- *Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.*

Mbajtja e kontabilitetit dhe mbyllja e llogarive vjetore, në SUSHN, për vitet 2018-2020, është bërë në përputhje me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018, ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.
Nga ana e institucionit janë mbajtur ditarët e bankës dhe te arkës, libri i madh i llogarive. Mbi bazën e llogarive kontabël gjendjen e tyre në fillim e fund viti, janë hartuar pasqyrat financiare së bashku me formatet përkatëse, konform dokumentacionit standard të miratuar nga Ministria e Financave .
Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi. Janë kontabilizuar veprimet me ñBankënò, ñHyrjet dhe daljet e magazinësò, veprimet lidhur me ñPagatò e veprimet lidhur me shpenzimet operative dhe për investimet.

Titulli i Gjetjes	Mos plotësimi i dokumenteve kontabël në përputhje me ligjin përkatës
Situata:	Nga departamenti i financës, regjistrimet e veprimeve kontabël, janë kryer me regjistra ose në programin Excel dhe jo me ñBartës informatikëò, të cilët janë programe informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë, gjë e cila ndikon në pasaktësi gjatë procesit të regjistrimit të dokumenteve financiarë, si dhe gabime gjatë kuadrimit të veprimeve kontabël.
Kriteri:	Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, neni 3, pika 14 që përcakton

mënyrën se si mbahet dokumenti kontabël dhe pikën 15 për ñBartësit kontabëlòNeni 3 Përkufizime. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:14. ñDokument kontabëlò është dokumenti bazë, dokumenti plotësues dhe regjistrat (librat) kontabël, që përgatiten në letër të shkruar ose në bartës informatikë:a) dokumentet bazë përmbajnë regjistrimet fillestare të çdo ngjarjeje dhe veprimi ekonomik;b) dokumentet plotësuese janë bartës të informacionit të marrë nga dokumentet bazë;c) regjistrat (librat) kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve ekonomike të kryera, të marra nga dokumentet bazë ose dokumentet plotësuese. 15. ñBartës informatikëò është çdo dokument kontabël i autorizuar nga organet përkatëse, i shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.

Neni 7. Dokumenti kontabël, 1. Regjistrimet kontabël justifikohen me dokumentet kontabël, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Dokumenti kontabël mbahet si provë dokumentare gjatë gjithë periudhës kohore të përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji. 2. Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ose e ngjarjes ekonomike.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e programit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, si dhe në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabile dhe të pasqyrave financiare.

Shkaku: Dështimi në procedurat e prokurimit për blerje programi financiar

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Strukturat drejtuese të SUSHN të marrin masa për përmirësimin e mbajtjes së skedave të kontabilitetit, për të rritur cilësinë e regjistrimit, përpunimit dhe hartimit të pasqyrave financiare.

Titulli i Gjetjes Llogaritje e pasaktë e shpenzimeve të amortizimit të aktiveve afatgjata

Situata: Gjatë auditimit të saktësisë së paraqitjes të zërave kontabël, në pasqyrat financiare dhe formatet përkatëse, u konstatuan problematika dhe pasaktësi në vlerën e pasqyruar si amortizim të akumuluar, pasi nuk është llogaritur amortizimi vjetor për çdo aktiv, si dhe nuk janë pasqyruar shtesat dhe pakësimet në fund të vitit ushtrimor.

Referuar auditimit të plotësimit të pasqyrës së amortizimeve dhe informacionit të detajuar për të, ka rezultuar se nga hartuesit e pasqyrave financiare amortizimi i aktiveve të trupëzuara për periudhat 2018-2020 është bërë, duke ndjekur normat e amortizimit si vijon:

Emërtimi	Norma e amortizimit të përdorur nga SUSHN në %	Norma e amortizimit e Udhëzimit nr.8 në %
Ndërtesa e konstruksione	5	5
Makineri e pajisje	15	5
Mjete transporti	20	20
Inventar ekonomik	15	20
Kompjuter, sisteme informacioni		25

Në amortizimin e llogaritur të SUSHN mungojnë kategoria e pajisjeve informatike, kompjuterike e elektronike e cila e ka llogaritjen ndryshe nga zërat e tjerë të aktiveve në masën 25 %.

Kriteri: Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 36, të Udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018, ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, ku citohet: ñ*Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon: - Për aktivet afatgjata, materiale si: ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur; - Kompjuterët, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softe e sisteme informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%; - Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi; dhe - Për aktivet afatgjata jomateriale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%. Baza e llogaritjes vjetore të amortizimit për aktivet afatgjata materiale (mbi të cilat aplikohet përqindja përkatëse e amortizimit vjetor mbi bazë grupimi) duhet të jetë e barabartë me: - Vlerën kontabël neto të kategorive përkatëse të aktiveve, të regjistruar në çelje të periudhës ushtrimore; - Shtesën e kostos së blerjes dhe kostos së përmirësimit dhe rinovimit të kategorive përkatëse të aktiveve gjatë periudhës ushtrimore; si dhe - Zbritjen e vlerës kontabël neto të aktiveve të shitura, të dala jashtë përdorimit apo të humbura për kategorinë përkatëse të aktiveve gjatë periudhës ushtrimore.* ñ

Ndikimi/Efekti: Mos llogaritja e saktë në vlerat e llogaritura të amortizimit të zërave të aktiveve afatgjata, në pasqyrat financiare te viteve 2018, 2019 dhe në 2020, sjellin mos paraqitje të saktë dhe të besueshme të rezultateve ushtrimore, kanë si efekt mos paraqitjen e nevojave për investime kapitale dhe shtrembërim të kostove spitalore.

Shkaku:	Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Strukturat drejtuese të marrin masa për llogaritjen e saktë të vlerës së aktiveve gjendje dhe amortizimit për secilin grup mjetesh, si dhe pajisjeve kompjuterike e informatike duke pasqyruar me vërtetësi vlerën e mbetur pas rivlerësimeve përkatëse, pjesë e rëndësishme për përcaktimin e kostove të paketave spitalore dhe efekteve që sjell në Buxhetin e Shtetit.
Titulli i Gjetjes	Mos pasja e dokumenteve të pronësisë për zërat kontabël troje dhe ndërtesa
Situata:	-Institucioni nuk vërteton me dokumente pronësinë e zërave që ka në llogarinë ñNdërtime dhe rikonstruksioneò, të cilat i ka në pronësi apo në administrim. Në shkresën e ZVRPP Tiranë, më datë 20.07.2018, në përgjigje të kërkesës së SUSHN, me nr. 69282 Prot., datë 16.07.2018, për informacion, rezulton se në pronësi të institucionit është vetëm pasuria truall 19,625 m2, në zonën kadastrale 8190, me numër pasurie 13/773. -Institucioni nuk ka marrë masat për pajisjen me certifikata pronësie, të ndërtesave dhe kalimin e pronësisë së truallit, duke mos zbatuar urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 158 datë 15.04.2016, me shkresën 365/11, date 10.10.2016 ñDërgim dokumentacioni ñPër inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore që do të mbeten në administrimin e Ministrisë së Shëndetësisë: Relacionin teknik dhe plan rilevimet, plan vendosjen dhe planimetrinë e ambienteve të SUSHN. Planet e rilevimit janë dokumente kryesorë që ZVRPP të mund të japin informacion mbi gjendjen e pronësisë mbi të cilat institucionet kanë në përdorim (në pronësi apo administrim) dhe kryejnë funksionet e tyre. Gjithashtu SUSHN nuk ka vazhduar procesin e regjistrimit të pronave në ZVRPP në zbatim të pikës 4 të metodologjisë së punës të vendosur bashkëlidhur Urdhrit 158, date 15.04.2016. -Në zërin toka, troje, terrene nuk ka asnjë regjistrim për vlerat sasiore dhe ekonomike.
Kriteri:	Pika 3.3, Rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare, paragrafi 62 dhe paragrafi 91, të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.

	Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr. 158 datë 15.04.2016, me shkresën 365/11, date 10.10.2016 ñDërgim dokumentacioni ñPër inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore që do të mbeten në administrimin e Ministrisë së Shëndetësisë.
Ndikimi/Efekti:	Risk për tjetërsim të trojeve dhe mos paraqitje me besueshmëri e pasqyrave financiare
Shkaku:	Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	Të merren masa nga strukturat drejtuese për kryerjen e veprimeve përkatëse për regjistrimin në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës ndërtesat dhe trojet që SUSHN zotëron dhe pasqyrimin e zërave kontabël përkatës në pasqyrat financiare.
Titulli i Gjetjes	Mos vlerësimi i gjendjes së pajisjeve mjekësore
Situata:	-Nga SUSHN nuk ishin kryer analiza teknike të mbështetura në manualet përkatëse të pajisjeve, ekspertizave të specialistëve të fushës, të detajuara për caktimin e jetëgjatësisë për pajisjet gjendje, dhe planifikimin për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.
Kriteri:	Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 28.11.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në institucionet publikeò, ku citohet : *18. Çdo njësi e sektorit publik duhet të plotësojë planin e vet me një njohje të mirë të bazës së aktiveve që duhen për të përmbushur objektivat e saj. Strategjitë e menaxhimit të aktiveve duhet të synojnë që të krijojnë, të ruajnë dhe sipas nevojave, të përmirësojnë strukturën e aktiveve, brenda një periudhe të caktuar, nëse parashikohen ndryshime.* *23. Masat që duhet të ndërmerren në raport me riskun për kufizimin e humbjeve financiare, mund të përfshijnë:* *d) Përcaktimin e sistemeve dhe të procedurave për zëvendësimin apo shtimin e aktiveve afatgjata. Planifikimi në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të tyre të jetës është një tjetër mënyrë për parandalimin e mosfunksionimin e papritur të ndonjë aktivi. Jetëgjatësia standarde që jepet në regjistrin e aktiveve afatgjata nëpërmjet normave të amortizimit është një tregues se kur një aktiv duhet të zëvendësohet. Është e rëndësishme që jetëgjatësia standarde të mos ndiqet verbazi, pasi aktivi mund të vazhdojë të jetë në gjendje pune dhe njëkohësisht i nevojshëm ose i dobishëm për plotësimin e objektivave të njësisë. Dobishmëria e çdo aktivi duhet vlerësuar nga komisioni i vlerësimit të aktiveve, i cili ngrihet dhe funksionon sipas kritereve të këtij udhëzimi.*

Ndikimi/Efekti:	Duke mos e përcaktuar me fleksibilitet jetëgjatësinë e aktiveve, duke vlerësuar dhe zhvillimin e teknologjisë, SUSHN rrezikon të mos kryej me sukses planifikimin në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.
Shkaku:	Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Të merren masa nga strukturat drejtuese për vlerësimin e jetëgjatësisë së aktiveve, duke përdorur fleksibilitet dhe relacione të mirë argumentuara nga specialistët përkatës, për klasa specifike të aktiveve dhe jo të përgjithshme, për planifikimin në kohë të zëvendësimit të aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.

Titulli i Gjetjes	Mos ndjekja e pagesave të detyrimeve kontraktore me sistem gjurmimi skadencash
Situata:	-Nga departamenti i financës, si dhe Nëpunësi Zbatues, në lidhje me ndjekjen e pagesave të detyrimeve kontraktore nuk është ndërtuar një sistem gjurmimi skadencash, për të kontrolluar në mënyrë sistematike pagesat e kryera që të respektonin parimin e FIFO-s, si dhe garantimi i gjurmës së auditimit.
Kriteri:	Neni 12, i Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, ku citohet: ñ3. *Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: dh) dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi; gj) garantimin që të gjithë kreditorët të paguhen në kohë dhe në rastet kur kreditorët nuk janë paguar apo në rast ankesash për mospagesë nga kreditorët, nëpunësi zbatues duhet t'ia shpjegojë rrethanat nëpunësit autorizues.”*

Ndikimi/Efekti:	Rritje të riskut të mos pagesave dhe humbja e gjurmës së auditimit.
Shkaku:	Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Strukturat drejtuese të marrin masa për hartimin e një sistemi të monitorimit të afateve të skadencave të detyrimeve të pagueshme, për të garantuar pagesën e të gjithë kreditorëve në kohë, si dhe gjurmën e auditimit.

-Detyrimet për furnitorë e llogari të lidhura me to (llogaritë 401-408), paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

në lekë

Përshkrimi	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Detyrimet e vitit furnitorë	97,469,480	90,991,909	199,182,314
Detyrimet e vitit investime	5,361,448		
Detyrimet total	**102,630,928**	**90,991,909**	199,182,314

Referuar informacionit të vendosur bashkëlidhur pasqyrave financiare ka rezultuar se SUSHN ka një numër të lartë të furnitorëve të kontraktuar për vitin 2018 të rezultuar të pa likuiduar nga 5 mujori i fundit, nga të cilët 20,192,859 lekë janë për shërbime, ngrohje, ushqime, dhe pjesa tjetër barna e materiale mjekimi konsumi.
Për vitin 2019, ka pasur tendencë uljeje, dhe detyrimet e furnitorëve i përkasin 4 mujorit të fundit të vitit, nga të cilët 61,615,006 lekë janë për barna e materiale mjekimi konsumi dhe pjesa tjetër për shërbime, oksigjen, mirëmbajtje, ngrohje.
Për vitin 2020, rritja ka ardhur si pasojë e emergjencës Covid, dhe detyrimet përveç disa përjashtimeve i përkasin furnitorëve të palikujduar të nëntorit dhe dhjetorit 2020. Nga vlera totale 126,658,897 lekë, janë për barna e materiale mjekimi konsumi dhe 72,709,553 lekë janë për shërbime, oksigjen, mirëmbajtje, ngrohje.

Titulli i Gjetjes Vlerësimi i artikujve për tu nxjerrë jashtë përdorimit jo në përputhje me udhëzimin përkatës

Situata: -Me urdhrin nr. 265/6 Prot., datë 28.09.2018, drejtori i SUSHN, ka ngritur komisionin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve për vitin 2018, i përbërë nga Skender Gjoni, përgjegjës finance, A.M., Zylfie Hoxha, Flutura Deliu, Artan Zeneli, Xhevahire Grori dhe Hajdar Koci. Më datë 21.12.2018, me nr. extra, ky komision ka mbajtur proces verbalin e vlerësimit të inventarit të materialeve për tu nxjerrë jashtë përdorimit, me vlerë 13,995,516 lekë.
-Në proces verbal nuk janë argumentuar arsyet e vlerësimit të artikujve nëse janë të nevojshëm ose jo për veprimtarinë e njësisë, vlerësimin e gjendjes fizike dhe mundësin e përdorimit të mëtejshëm në njësi të tjera si dhe nëse do të nxirret përfundimisht jashtë përdorimit ndërmjet shitjes si material, mbeturinë apo asgjësimit përfundimtar.
-Vlerësimi i aktiveve nuk është bërë sipas kritereve si plotësimi i kohë së shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit, afatit të skadencës, nëse ka, dhe nuk mund të riparohen, kur vlera e riparimit ose e përshtatjes për tõ kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm. kur ka kaluar afati i vlefshmërisë së tyre dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuara, kur kanë humbur cilësitë e tyre të caktuara në standardet shtetërore ose në kushtet teknike dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar a ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formë tjetër, megjithëse nuk ka kaluar afati i vlefshmërisë, etj.
-Relacioni i vlerësimit nuk përmbante procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.

Kriteri:	Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar, ku citohet: Procesi i vlerësimit te aktiveve te propozuara për dalje nga përdorimi ne njësi. 95. Është një proces që kryhet gjate ose pas procesit të inventarizimit. Mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale. Kriteret për vlerësimin e Aktiveve 103. Vlerësimi i Aktiveve bëhet sipas këtyre kritereve.
Ndikimi/Efekti:	Mos respektimi i procesit rrit riskun për ulje të aktiveve të institucionit, me vlerë 13,995,516 lekë.
Shkaku:	Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Strukturat drejtuese të marrin masa që procesi i vlerësimit të aktiveve për tu nxjerrë jashtë përdorimit të kryhet me përgjegjshmëri, duke kryer analizat dhe argumentimet e bazuara në kriteret përkatëse dhe me relacionet shoqëruese.

Titulli i Gjetjes	Mosplotësimi i regjistrit të aktiveve sipas kërkesave përkatëse
Situata:	SUSHN,nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat që duhet të përmbajë ky regjistër, nuk ka një përshkrim të plotë të aktivit, thuajse të gjitha përshkrimet janë të përcipta dhe me emërtime të thjeshta të pajisjeve, mungon data e daljes në përdorim duke e bërë të pamundur përllogaritjen e vlerës së mbetur. U konstatua se inventari i pajisjeve informatike është i përfshirë në inventarin e pajisjeve dhe aparaturave. Duhet theksuar se këto lloje të ndryshme aktivesh kanë norma të ndryshme amortizimi dhe duke qenë se ato janë të inventarizuara të gjitha së bashku e bënë të vështirë nxjerrjen e vlerës neto (të mbetur) të aktivit, duke sjellë dhe diferenca në llogaritjen e amortizimit.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 30, ku përcaktohet: ñ*Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbaje regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia* ò.

Ndikimi/Efekti: Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj.
Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia: E lartë
Rekomandime: Nëpunësi zbatues duhet të marrë masa për plotësimin e regjistrit të aktiveve që zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.

Titulli i Gjetjes Lëvizje të barnave pa autorizimet përkatëse

Situata: Në kuadër të bashkëpunimit mes spitaleve për shfrytëzimin e barnave dhe materialeve mjekësore para datës së skadencës, nëpërmjet koordinimit me drejtorinë e politikave dhe strategjive të zhvillimit të shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, në MSHMS, bashkëpunim i cili ka sjellë reduktimin e barnave të skaduara në SUSHN, por jo i rregulluar sipas Udhëzimit nr. 30, datë 28.11.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në institucionet publikeò.
Në lëvizjet e barnave mungonte konfirmimi zyrtar i njësisë përfituese si dhe miratimi i nëpunësit autorizues për daljen e tyre.

Në lekë

Dalje	2018	2019	2020
Me te drejtë kthimi	66,240	213,000	5,369,400
Falje	869,459	2,366,289	5,149,016
Totali	**935,698**	**2,579,289**	**10,518,416**

-Gjithashtu vlerat e barnave të falura si dhe pjesët me të drejtë kthimi nuk janë pasqyruar në zërin e shpenzimeve dhe shpjegimeve të pasqyrave financiare të periudhave respektive.

Kriteri: Pikat 107 dhe 114 të Udhëzimit nr. 30, datë 28.11.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në institucionet publikeò, ñDhënia ne përdorim/tjetërsimi i aktiveve te panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit te aktiveve 107. *Aktivet afatgjata qe pas vlerësimit konsiderohen te panevojshme përkohësisht për njësinë ne një periudhe te mëvonshme te funksionimit te saj (ne rast ndryshimi te objektivave afatmesme ose afatshkurtër te njësisë), por qe mbeten ne gjendje përdorimi, mund të jepen ne përdorim te përkohshëm ne rend shterues (nga a ne c): a. jepen për përdorim te përkohshëm brenda njësisë publike (nga qendra ne njësi shpenzuese dhe anasjelltas). b. jepen për përdorim te përkohshëm pa pagese ne njësi*

te tjera te qeverisjes se përgjithshme. Nuk i nënshtrohen kësaj kërkese njësite e sektorit publik sipas nenit 3, pika 2 dhe 3 te ligjit 10296, date 8.10.2010; c. jepen me qira ne njësi jashtë sektorit te qeverisjes se përgjithshme sipas kuadrit ligjor ne fuqi. 108. Aktivet afatgjata qe konsiderohen te panevojshme për njësinë ne një periudhe te mëvonshme te funksionimit te saj (ne rast mbylljeje/shkrirjeje te njësisë, ndryshimi te misionit apo objektivave afatgjate te njësisë), por qe mbeten ne gjendje përdorimi mund të jepen ne rend shterues (nga a ne b). a. transferohen pa pagese në një njësi tjetër publike brenda sektorit te qeverisjes se përgjithshme. Konfirmimi zyrtar nga njësia përfituese vërteton përfundimin e transaksionit;
114. Aktivet afatshkurtra si inventari i imët, ambalazhet, materialet dhe mallrat nxirren jashtë përdorimit me miratimin e Nëpunësit Autorizues te nivelit te dyte, sipas përcaktimeve te Nëpunësit Autorizues të njësisë publike."

Ndikimi/Efekti: Mos pasja e autorizimeve dhe konfirmimeve zyrtare rrit riskun për keq menaxhimin e aktiveve të institucionit, në vlerën 10,518,416 lekë.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Strukturat drejtuese të marrin masa që procesi i faljes/dhënies ose marrjes me të drejtë kthimi i medikamenteve, të jetë i shoqëruar me shkresat përkatëse të nëpunësit autorizues për daljen e tyre si dhe me konfirmimet zyrtare të njësive përfituese duke vërtetuar përfundimin e transaksionit. Vlerat e barnave dhe materialeve mjekësore të dhuruara të paraqiten me saktësi në hartimin e pasqyrave financiare.

Titulli i Gjetjes Kontabilizimi i aktiveve me mungesa të dokumentacionit shoqërues

Situata: -Në shtesat e zërit të pajisjeve mjekësore, monitorë në vlerën 31,303,800 lekë, në periudhën ushtrimore 2020, u konstatua se mungonte letra zyrtare e njësisë donatore, (kalimi kapital i pajisjeve).

Kriteri: Pika 57, e Udhëzimit nr. 30, datë 28.11.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në institucionet publikeò, ku citohet: ñ*57. Për hyrjet e aktiveve të dhuruara* ***dokumentacioni shoqërues përbehet nga Marrëveshja/akti i dhurimit ose letrën zyrtare të njësive donatore****; Faturën që identifikon mallrat dhe vlerën e tyre; Dokumentet e zhdoganimit dhe Certifikatën e origjinës (ne rast importi); Procesverbali i marrjes ne dorëzim te konfirmuar nga sektori i shërbimeve. Ne rastet kur dhurimet ne natyre te aktiveve nga donatore te ndryshëm jepen vetëm ne sasi (pa çmim apo kosto), ato pranohen nga njësia përfituese dhe titullari autorizon vlerësimin e tyre."*

Ndikimi/Efekti: Mos pasja e dokumentacionit zyrtar shoqërues mund të sjellë

problematika lidhur me garancitë e materialeve të marra në dorëzim në vlerën 31,303,800 lekë.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia: E mesme
Rekomandime: Strukturat drejtuese të marrin masa që procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve të dhuruara, të jetë i shoqëruar me shkresat përkatëse të njësisë donatore, për të mundësuar kontabilizimin korrekt të aktiveve të dhuruara si dhe ushtrimin e të drejtave të garancisë ose shërbimeve të mirëmbajtjes të tyre.

Për mangësitë dhe gabimet në pasqyrat financiare ngarkohet me përgjegjësi znj. E. K. në cilësinë e përgjegjëses së sektorit ekonomik dhe hartuese e pasqyrave financiare.
Për moszbatimet e caktimeve të Udhëzimit nr. 30, datë 28.11.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në institucionet publikeò, ngarkohet me përgjegjësi S.Gj. në cilësinë e n/drejtorit ekonomik, dhe Nëpunësit Zbatues të institucionit.

2.5.Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet për investime, për blerje mallrash e shërbimesh, si dhe zbatimi i kontratave (saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit, vlerësimi i kritereve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe zbatimi i punimeve i punimeve deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimi i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve.

Për zbatimin e ligjshmërisë në fushën e prokurimit, auditimi është fokusuar në drejtim të:
-Parashikimi i fondit limit, bazuar në çmimet e publikuara, përvojën e mëparshme ose testimin e tregut.
-Argumentimi ligjor i procedurës së prokurimit që ka zgjedhur enti prokurues.
-Realizimi i parimeve të prokurimit publik, si transparenca, nxitja e konkurrencës, barazia e kandidatëve dhe përdorimi ekonomik dhe efektiv i fondeve publike.
-Zbatimi i procedurave të prokurimit nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit deri në shpalljen e fituesit.
-Lidhja dhe zbatimi i kontratës, marrja në dorëzim e mallrave dhe shërbimeve, etj.

Për vitin 2018, SUSHN, ka zhvilluar 58 procedura prokurimi me vlerë 376,306,100 lekë dhe nënshkruar 72 kontrata me vlerë 378,597,946 lekë. Nga të cilat 45 procedura janë shtesa kontrate dhe negocim pa shpallje.
Janë nënshkruar 143 kontrata me vlerë 141,303,656 lekë, procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga ***Ministria e Shëndetësisë***.
Janë nënshkruar 3 kontrata me vlerë 18,195,262 lekë, procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga ***Agjencia e Blerjeve të Përqendruara***.

Janë përzgjedhur dhe audituar procedurat, si më poshtë:

Nr.	Objekti prokurimit	Procedura	Fondi limit
1	Shërbimi gatim dhe shpërndarje e ushqimit në pavijonet e SUSHN	me negocim	10,090,576
2	Blerje materiale mjekimi	“ “	23,569,782
3	Blerje kite dhe reagente	ñ ñ	15,735,029

4	Shërbimi gatim dhe shpërndarje e ushqimit në pavijonet e SUSHN	Shtesë kontrate	16,656,094
5	Blerje medikamente për nevoja emergjente, ndarë me 123 lote	me negocim	32,087,979
6	Furnizim Vendosje Makineri e Pajisje për Sistemin e Kondicionimit në ambientet e SUSHN	tender i hapur	177,009,573
7	Marrje 2 kaldaja me qira për ngrohje me lëndë djegëse pellet	tender i hapur	11,696,276
8	Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje	tender i hapur	9,956,250
	Shuma		**296,801,559**

Për vitin 2019,SUSHN, ka zhvilluar 28 procedura prokurimi me vlerë 283,906,108 lekë dhe nënshkruar 78 kontrata me vlerë 224,830,418 lekë, nga të cilat 5 janë negocim pa shpallje dhe shtese kontrate.
Janë nënshkruar 167 kontrata me vlerë 115,301,770 lekë, procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga ***Ministria e Shëndetësisë***.
Janë nënshkruar 5 kontrata me vlerë 41,640,804 lekë, procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga ***Agjencia e Blerjeve të Përqendruara***.

Janë përzgjedhur dhe audituar procedurat si më poshtë:

Nr.	Objekti prokurimit	Procedura	Fondi limit
1	Shërbimi i sigurimit te ruajtjes me Roje Private (SH.R.S.F)	Marrëveshje kuadër	15,086,273
2	Shërbimi gatim dhe shpërndarje e ushqimit në pavijonet e SUSHN	“ “	9,871,216
3	Blerje lëndë djegëse për ngrohje (Pellet)	ñ ñ	10,053,000
4	Blerje Medikamente ndarë me 32 lote	ñ ñ	79,241,321
5	Blerje materiale mjekimi për Shërbimin e Hemodinamikës	ñ ñ	35,123,180
6	Rikonstruksioni i disa ambienteve në S.U. "Shefet Ndroqi	tender i hapur	13,356,671
7	F-V. dy kaldaja dhe Aksesorët e tyre	tender i hapur	7,999,583
8	Blerje materiale mjekimi për nevoja Spitalore	tender i hapur	12,224,250
	Shuma		**182,955,494**

Për vitin 2020,SUSHN, ka zhvilluar 25 procedura prokurimi me vlerë 1,034,400,860lekë procedura prokurimi dhe nënshkruar 105 kontrata me vlerë 616,984,158 lekë.
Janë nënshkruar 180 kontrata me vlerë 132,543,396 lekë, procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga ***Ministria e Shëndetësisë***.
Janë nënshkruar 5 kontrata me vlerë 100,740,005 lekë, procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga ***Agjencia e Blerjeve të Përqendruara***.

Janë përzgjedhur dhe audituar procedurat si më poshtë:

Nr.	Objekti prokurimit	Procedura	Fondi limit
1	Shërbimi i sigurimit te ruajtjes me Roje Private (SH.R.S.F)	tender i hapur	15,086, 273
2	Blerje oksigjen për përdorim mjekësor për nevojat spitalore	Marreveshje kuadër	22,989,100
3	Furnizim - vendosje pajisje për hapjen e Sallës se Reanimacionit Kardio Kirurgjisë në SUSHN	tender i hapur	72,500,000
4	Blerje oksigjen për përdorim mjekësor për nevojat spitalore	Marrëveshje kuadër M-K	172,339,828
5	Blerje barna shtesë që nevojiten në kuadër te trajtimit te pacientëve me Covid -19, e ndarë në 31 lote	tender i hapur	198,021,855
6	Blerje Kite dhe Reagente, ndarë në 12 lote	M-K, 12 muaj	21,558,548
7	Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi ne SUSHN	M-K, 48 muaj	167,542,596
8	Blerje Medikamente ndarë me 32 lote	M-K, 12 muaj	79,241,321
9	Blerje materiale mjekimi specifike per kabinetet	M-K, 12 muaj	154,713,267
	Shuma		**903,992,788**

Për muajin Janar 2021,SUSHN, ka zhvilluar 6 procedura prokurimi me vlerë 450,104,604 lekë dhe nënshkruar 18 kontrata me vlerë 131,560,194 lekë.
Janë nënshkruar 167 kontrata me vlerë 37,578,979 lekë, procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga ***Ministria e Shëndetësisë***.
Është nënshkruar 1 kontratë me vlerë 3,542,688 lekë, procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga ***Agjencia e Blerjeve të Përqendruara***.

Janë përzgjedhur dhe audituar procedurat, si më poshtë:

Nr.	Objekti prokurimit	Procedura	Fondi limit
1	Blerje Medikamente ndarë me 31 lote	Marrëveshje kuadër 12 muaj	198,021,855
2	Blerje lëndë djegëse për ngrohje-Pellet, për vitin 2021	Tender i hapur	19,864,080
	Shuma		**217,885,953**

Përzgjedhja e procedurave të prokurimit është kryer referuar vlerave më të larta të prokuruara si edhe objektit të procedurës në lidhje me situatën e krijuar nga pandemia covid-19.
Auditimi është kryer bazuar në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 19.12.2014, ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) si edhe në udhëzimet dhe manualet e APP-së.
U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
-Regjistri i parashikimit dhe realizimit të prokurimeve.
-Dokumentacioni mbi kryerjen e prokurimeve.
-Dokumentacioni shoqërues i likuidimeve të kryera.
-Kontrata e nënshkruar dhe zbatimi i saj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:
Nga Spitali Universitar Shefqet Ndroqi (SUSHN), nuk janë zbatuar plotësisht përcaktimet ligjore të bëra në:
-Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin Publikò, i ndryshuar.
-VKM nr.914, datë 19.12.2014, ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.
-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 ñMbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.
Nga auditimi u konstatuan mangësi në disa raste në llogaritjen e vlerës së kontratave dhe hartimin e kritereve të kualifikimit. Në procedurat e kryera, vërehet pjesëmarrja e vetëm 1 operatori ekonomik ose në disa raste u konstatua se operatorë të ndryshëm pjesëmarrës në tender nuk paraqesnin ofertën ekonomike. Në procedurat e audituara rezulton se nga komisionet e vlerësimit të ofertave nuk është shpallur fitues asnjë operator ekonomik me vlerë më të lartë, si edhe në procedurat e kryera për medikamente për llogaritjen e vlerës së kontratës grupet e ngritura për këtë qëllim, janë bazuar në çmimet e medikamenteve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë. Njësia e prokurimit në 90% të prokurimeve ka kërkuar asistencën dhe marrje mendimi e miratimi nga Agjencia e Prokurimit Publik.

1. Në tenderin e zhvilluar me objekt "F.V makineri pajisje për sistemin e kondicionimit në ambientet e SU "Shefqet Ndroqi", me këto të dhëna:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "F.V makineri pajisje për sistemin e kondicionimit në

ambientet e SU "Shefqet Ndroqi"".				
1. Urdhër Prokurimi nr. 54, datë 20.02.2018 2. lloji i Procedurës së Prokurimit (E hapur)	**3. njësia e prokurimit** E.B. E. T. S.N.		**4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. 55 prot., datë 20.02.2018.** S.Gj. S.T. M. F. M. B. Gj.Sh.	
5. Fondi Limit (pa tvsh) 177,009,573 lekë	**6. Oferta Fituese (pa tvsh)** 155,511,566.2 lekë		**7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh)** 21,498,011 lekë	
8. Data e hapjes së ofertave 23.103.2018	**9. Burimi i Financimit** Buxheti i shtetit		**10. Operatorët Ekonomikë** a. Pjesëmarrës në tender 1.Ag. Kon. me vlerë oferte154,422,127 lekë 2.BOE ñKlim.T.ò shpk &òIT. Gr.ò Shpk me vlerë oferte174,859,214,9 lekë. 3. ñTerò. SHPK me vlerë oferte 176,693,475 lekë 4.BOE ñE. Kon.ò SHPK & ñAlba Konstruksionò me vlerë oferte 155,511,566.2 L.P. - Person Fizik, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike. b. Skualifikuar ï 3 OE	
11. Ankimime -K. t. TB2, nr. 71 prot., datë 03.04.2018. Ter. SHPK nr. 461/12 prot., datë 05.04.2018. Ag. Con. SHPK nr. 72 prot., datë 05.04.2018.	**12. Përgjigje e ankesës nga AK** -nr. 461/11 prot., datë 04.04.2018. Nr. 461/17 prot., datë 05.04.2018. Nr. 461/18,20 prot., datë 06.04.2018		**13. Përgjigje ankesës nga KKP-** Vendim nr. 444/2018 prot., datë 27.06.2018	
b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave				
14. lidhje e kontratës Nr. 461/37, datë 03.08.2018	**15. Vlera e kontratës (me tvsh)** - 175,416,638.4 lekë		**16. Likuiduar** 166,545,095.5 lekë Pa likuiduar: 8,871,543 lekë	
17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë x	**18. afati i kontratës në ditë** Parashikuar 60 ditë		**19. Zgjatja e kontratës me ditë** - Pezulluar për shkak të Covid-19	
20. mbikëqyrësi i punimeve ñTo.ò SHPK	Licencë MK.1431/13	Kontrata 10.09.2018	Likuiduar	Pa likuiduar
21. kolaudatori i punimeve -	Licencë	Kontrata	Likuiduar	Pa likuiduar
22. Akt Kolaudimi Datë-	**23. Akt i marrjes në dorëzim të përkohshëm –**		**24.** Fletë Hyrja nr: -	

Fondi limit është përllogaritur me vlerë 177,009,573 lekë. Fondi limit është bazuar në preventivin e paraqitur nga Shoqëria Konsulente ñSt. Ar.ò, hartuar me datë 26.07.2017. Për realizimin e projekt-tpreventivit, është hartuar procedurë e veçantë prokurimi.

Procedura është zhvilluar me datë 23.10.2018. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 4 operatorë ekonomikë, nga të cilët janë skualifikuar 3.Është shpallur fitues OE me vlerë oferte 155,511,566.2 lekë.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përllogaritjes së fondit limit, dokumenteve të tenderit dhe vlerësimit të ofertave, konstatohen mangësitë si më poshtë:

Titulli i gjetjes:	Janë hartuar kritere të pa argumentuara.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se janë vendosur kritere jo në përputhje me volumin e natyrën e kontratës sa i takon disponimit të licencave profesionale si më poshtë: - Sipas pikës 2.3.2.a, ndër të tjera është kërkuar që OE duhet të jenë të pajisur me licencën me drejtime si më poshtë: NP-11 (E) ñNdërtime për N/Stacione, kabina e transformatorë linja e TN të mesëm dhe shpërndarje energjisë. NS-12 (E) ñImpiante teknologjik termike dhe të kondicionimitò. NS 14 (E) ñImpiante të brendshme elektrike telefoni radiotelefoniò. Përcaktimi A, B, C, D, E, ka të bëjë me nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, sipas vlerës së kontratës. Duke marrë në konsideratë fondin limit me vlerë 177 milionë lekë, klasa D (101 milionë deri 200 milionë lekë) është e mjaftueshme për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, ndërsa klasa E, i përket kontratave me vlerë nga 201 milionë lekë deri 400 milionë lekë. - Sipas pikës 2.3.2.e, ndër të tjera është kërkuar që OE duhet të kenë makineri si më poshtë: Makineri linjë prodhimi tub fleksibël, komplet (në pronësi ose me qira). Makineri linjë prodhimi tub alumini, komplet (në pronësi ose me qira). Kërkesa për linja prodhimi, ndërkohë që materialet janë parashikuar furnizim dhe vendosje, është e pa argumentuar.
Kriteri:	-Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar, Neni 46, pika 3. -VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 61.
Ndikimi:	Vendosja e kritereve, të cilat nuk janë në përputhje me volumin e punës së kontratës, ndikon në uljen e mundësisë së një pjesë të operatorëve ekonomikë për të marrë pjesë në tender.
Shkaku	Mos argumentim i duhur.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Nga ana e SUSHN të merren masa për trajnimin e punonjësve që angazhohen në realizimin e procedurave të prokurimit, me synim realizimin e tyre me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

Për veprimet e mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:
z. S.N., në cilësisë e specialistit të fushës.

- Mbi zbatimine Kontratës "F.V makineri pajisje për sistemin e kondicionimit në ambientet e SU "Shefqet Ndroqi'".

Kontrata është nënshkruar me nr. 461/37 prot., datë 03.08.2018, me Kontraktorin ñE. Kon.ò SHPK, me vlerë 175,416,638.4 lekë me TVSH. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur Shoqëria ñTow.ò SHPK, me administrator z. I. K. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 12 muaj. Janë likuiduar 5 situacione të ndërmjetme me vlerë 166,545,095 lekë. Punimet janë ndërprerë si pasojë e pandemisë dhe deri në momentin e auditimit nuk kanë rifilluar.
Nga auditimi i dokumentacionit të pagesave dhe librezës së masave rezulton se ka mangësi si më poshtë:
Sipas zërit A-3.1.ANM-64 ñF.V llamarinë e galvanizuar për prodhimin e kanaleve të ajrit me trashësi nga 0.6 mm deri 1.2 mm, e kompletuar me gjithë fllanxha dhe të gjitha rakorderitë e nevojshme për prodhimin dhe montimin e kanaleve të ajritò, është certifikuar sasia 40841 kg.
Në specifikimet teknike pika 2.10, përcaktohet: Të gjitha kanalet e ajrit përjashtuar rastet kur specifikohet ndryshe, duhet të ndërtohen me flete metalike te galvanizuar. Te gjithë fletët metalike të galvanizuara duhet të jenë të veshura me zink 275 g/m². Kapëset dhe mbajtëset duhet të jenë të mbrojtura tëgalvanizuara. Trashësia e fletëve metalike të galvanizuara duhet të përgjigjet në funksion të brinjës më të madhe të kanalit të ajrit, madhësia e te cilës jepet për gjerësi deri 30 cm, me trashësi 0.6 mm, për gjerësi nga 35 cm deri 57 cm, me trashësi 0.8 mm, për gjerësi nga 80 mm deri 120 mm me trashësi 1 mm dhe për gjerësi nga 125 cm deri 200 cm, me trashësi 1.2 mm.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se jo në të gjitha rastet janë respektuar përcaktimet e mësipërme, pasi për dimensione të ndryshme janë përllogaritur llamarinë me trashësi më të madhe.Gjithashtu pesha e marrë si referencë ka diferenca me peshën e përcaktuar në manuale.
Nga rillogaritjet (sipas faqeve përkatëse në librezën e masave) rezulton si më poshtë:

Faqe	**Pesha e llogaritur** **kg**	**Pesha faktike** **kg**	**Diferenca** **kg**
1	1190	763.1	426.8
2	1361	873.3	487.6
3	1156.8	746.6	410.1
4	1087.5	681.8	405.7
5	1879	1162.5	716.4
6	889.2	562.8	326.3
7	3457	2100.8	1356
8	1885	1154.5	732.5
9	845.4	537.1	308.2
10	2711.3	1671	1039.8
11	1885	1161.9	723
12	1273.5	799.5	474
13	2705.5	1167.7	1037.8
14	1774	1116	657
15	3106	2099	1006
16	2962	1823	1138
17	1061.4	674.6	386.8
18	1528.2	1054	474.2
19	1912.5	1201.5	711
20	745	458	287
21+22	2886	1707	1178
23	876.6	558.2	309.4
24	540.2	387.2	153

25	1134.4	727.9	406.5
Shuma:	**40852**	**25189**	**15151**

Sa më sipër rezulton se diferenca e peshës e llogaritur më tepër është 15151 kg. Kësaj peshe i zbritet veshja me zink në të dy anët e llamarinës me 275 g/m^2, në sasinë 2522 kg (sipërfaqe 4586 m^2 x dy anë x 0.275 g/m^2).***Rezulton se është certifikuar më shumë vlera 7,577,400 lekë*** [(15151 kg ï 2522 kg) x 600 lekë/kg], është certifikuar në kundërshtim me specifikimet teknike. Sa i përket shmangies së specifikimeve teknike në lidhje me zgjedhjen e trashësisë së llamarinave sipas dimensioneve rakorduese, deri në këtë periudhë të auditimit nuk disponohet dokumentacion që vërteton ndonjë ndryshim gjatë zbatimit të kontratës, si ndonjë referencë e mundshme e gabuar në përcaktimin e trashësisë së tyre.

Nga verifikimi i zërave A-1.03 deri në A-1.11 ñF.V Tubo çeliku i zi pa tegel (Mannesmann)ò, rezultoi se pesha e përllogaritur referuar gjatësisë së tyre nuk rakordon me peshën që duhet të përcaktohej sipas referencave të manualeve, për standardet e përcaktuara në projektin e zbatimit.

Në specifikimet teknike, pika *2.7.5 "Tuba e zinj pa tegel", përcaktohet: "Këto tubo do të përdoren në furnizimin e ujit nga gjeneratorët e nxehtësisë sikurse chilleri deri te terminalet ekateve.Tubat duhet te bëhen prej çeliku te zi me ose pa saldim (sistemi Fretz-Moon) në seritë UNI 3824 ose UNI 4992. Vendet e bashkimit duhet te saldohen dhe ne rastet kur kërkohet, do te përdoren bashkuesit me fllanxhe. Të gjitha bashkuesit e tubave duhet te kenë të njëjtën trashësi si ato te tubave. Mënyra e saldimit do te jete saldim hark ose saldim oksi-acetilen*ò
Në projekt zbatim janë përcaktuar karakteristikat e tubacioneveñ*Tub çeliku i zi, pa saldim, me karakteristika, përmasa dhe peshë sipas UNI 10255 (**seria e mesme** me diametër deri ne 2" te përfshire), ose në përputhje me UNI 10216-1*ò.
Referenca e gabuar për përcaktimin e peshës së tubave dhe rillogaritja e peshës së tyre sipas standardit të kërkuar, paraqitet në tabelën si më poshtë:

Diametri	Pesha njësi e llogaritur Kg/ml	Pasha njësi sipas standardit Kg/ml	Pasha e llogaritur Kg/ml	Pesha faktike Kg/ml	Diferenca Kg/ml
4	16.08	12.5	1086	844.2	241.7
3	11.29	8.53	3337.7	2373.9	963.7
2 ½	9.14	6.54	2897	1995.6	793
2	6.03	5.1	3057.4	2585.8	471.5
1 ½	5.41	3.6	2065	1374.1	690.8
1 ¼	4.47	3.13	1738.7	1217.4	521.2
1	3.24	2.43	1109.6	832.2	277.4
¾	2.2	1.57	1411	1006.9	404
½	1.62	1.22	2100.7	1582	518.7
					4882

Të dhënat e manueleve sipas kësaj tabele i përkasin serisë së mesme, sipas përcaktimeve në projekt. Sa më sipër vetëm për dimensioned nga ½ deri 4 inch, është përllogaritur më shumë pesha e tubacioneve në sasinë 4882 kg.***Vlera 2,196,900 lekë (4882 kg x 450 lekë/kg), është certifikuar padrejtësisht.***

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Specifikimet teknike të kontratës pika 2.10, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar, neni 7, ku përcaktohet:

"...Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit..."

Punimet e zbatimit të kontratës janë ndërprerë për shkak të protokolleve Covid-19, pasi punimet për përfundimin e kontratës janë në ambientet e brendshme të spitalit. Në këto kushte, me përmirësimin e situatës, nga ana e SUSHN dhe Kontraktorit do të nxirret urdhri për rifillimin e tyre.

Punimet e realizuara deri në këtë fazë, kanë të bëjnë kryesisht në vendosjen e kanaleve të ajrimit, kondicionimit, të cilat janë përfunduar në pjesën e jashtme të objektit. Këtyre tubacioneve i është realizuar është shtresa e izolimit. Në këto kushte kemi të bëjmë me punime të cilat janë bërë të padukshme.

Titulli i gjetjes: Përllogaritje të gabuara të peshës së llamarinave dhe tubacioneve.

Situata: Sipas zërit A-3.1.ANM-64 ñF.V llamarinë e galvanizuar për prodhimin e kanaleve të ajrit me trashësi nga 0.6 mm deri 1.2 mm, e kompletuar me gjithë fllanxha dhe të gjitha rakorderitë e nevojshme për prodhimin dhe montimin e kanaleve të ajritò, është certifikuar sasia 40841 kg.

Në specifikimet teknike pika 2.10, përcaktohet: ñ*Trashësia e fletëve metalike të galvanizuara duhet të përgjigjet në funksion të brinjës më të madhe të kanalit të ajrit, konkretisht: deri në 30 cm, trashësi 0.6 mm, nga 35 deri në 57 cm, trashësi 0.8 mm, nga 80 deri 120 cm, trashësi 1 mm dhe nga 125 cm deri 200 cm, me trashësi 1.2 mm*ò.

Bazuar në librezën e masave, pesha e llamarinave nuk përcaktuar për llogaritje sipas kritereve të mësipërme, po ashtu pesha specifike e aplikuar është më e lartë se ajo e manualeve teknike. Rezulton se është përllogaritur më shumë sasia 12651 kg, me vlerë 7,757,400 lekë.

Nga verifikimi i zërave A-1.03 deri në A-1.11 ñF.V Tubo çeliku i zi pa tegel (Mannesmann)ò, rezultoi se pesha e përllogaritur referuar gjatësisë së tyre nuk rakordon me peshën që duhet të përcaktohej sipas referencave të manualeve, për standardet e përcaktuara në projektin e zbatimit.

Në specifikimet teknike, pika *2.7.5 ""Tuba e zinj pa tegel", përcaktohet: "Këto tubo do të përdoren në furnizimin e ujit nga gjeneratorët e nxehtësisë sikurse chilleri deri te terminalet ekateve.Tubat duhet te bëhen prej çeliku te zi me ose pa saldim (sistemi Fretz-Moon) në seritë UNI 3824 ose UNI 4992. Vendet e bashkimit duhet te saldohen dhe ne rastet kur kërkohet, do te përdoren bashkuesit me fllanxhe. Të gjitha bashkuesit e tubave duhet te kenë të njëjtën trashësi si ato te tubave. Mënyra e saldimit do te jete saldim hark ose saldim oksi-acetilen*ò

Në projekt zbatim janë përcaktuar karakteristikat e tubacioneveñ*Tub çeliku i zi, pa saldim, me karakteristika, përmasa dhe peshë sipas UNI 10255 (**seria e mesme** me diametër deri ne 2" të përfshirë), ose ne*

	*përputhje me UNI 10216-1*ò. Nga përllogaritjet, duke marrë në konsideratë standardin e projektimit, rezulton se është certifikuar më shumë sasia 4882 kg, me vlerë 2,196,900 lekë.
Kriteri:	Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar, neni 7. - Specifikimet teknike të kontratës pika 2.10.
Ndikimi:	Si pasojë e gabimeve në përllogaritjen e peshës së llamarinave dhe tubacioneve, është certifikuar dhe likuiduar më shumë vlera 9,954,300 lekë.
Shkaku	Mos respektim i specifikimeve teknike dhe referenca të gabuara të peshës së llamarinave dhe tubacioneve.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	SUSHN të marrë masa për zbritjen nga situacioni pasardhës duke reflektuar edhe në situacionin përfundimtar të vlerës 9,954,300 lekë, përfituar padrejtësisht nga Kontraktori ñE. Kon.ò SHPK.

Për veprimet e mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve Shoqëria "Tow." SHPK.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. M165/29, datë 28.09.2021 ñMbi Projektraportin e Auditimitò, nga mbikëqyrësi i punimeve Shoqëria ñTow.ò SHPK (edhe nga kontraktori janë paraqitur pretendime të njëjta), ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:-*Për prodhimin e kanaleve të ajrit është marrë në konsideratë standardi DIN EN 1505 dhe DIN 18379. Përzgjedhja e trashësisë së llamarinës është bazuar në klasifikimin e presurizimit të sistemeve të kanaleve të ajrit konformë DIN EN 1507.*
Duke ju referuar rekomandimit të dhënë në relacionin teknik, për një presion minimal 500 Pa, kërkesat minimale për rrjedhjen e ajrit nga kanalet referuar normave DIN EN 1507 dhe VD 18303, për kategorizimin e kanaleve të ajrit tek presioni i mesëm, prodhimi i tyre duhet të fillojë me një spesor (trashësi llamarine) jo më të vogël se 0.7 mm. Për shkak të standardizimit, kanalet e ajrit janë realizuar me spesor jo më të vogël se 0.8.
Në observacione është paraqitur libreza e masave, për sasinë e përdorur të llamarinave.
- Në lidhje me përcaktimin e peshës së tubacioneve pretendohet se audituesi nuk është referuar një materiali tjetër që ka të bëjë me katalogët (prospektet) nga ana e prodhuesit të të gjithë sistemeve HVAC-së. E konkretisht UNI 10255 dhe UNI 2016-1 dhe standardeve të tjera, por vetëm standardeve UNI 3824 dhe UNI 4992.
- Në përfundim të observacionit përcaktohet: "Nga studimi i të gjithë sistemit të ngrohjes dhe aspirimit kemi menduar që t'i referohemi dhe katalogëve dhe skedave teknike të prodhuesit të sistemit HVAC".
Qëndrimi i Grupit të auditimit:*Në lidhje me diferencën e konstatuar në llogaritjen e peshës së llamarinave sqarojmë se, në specifikimet teknike dhe dokumentin e projektit është përcaktuar në mënyrë shumë të qartë, trashësia e llamarinave në funksion të dimensionit të kanalizimit të ajrimit. Kjo kontratë nuk përfshin alternativat për të cilin kontraktori mund të aplikojë. Kanalizimet e ajrimit për këtë kontratë funksionojnë me presion të papërfillshëm ose jo nën presion. Përcaktimi i trashësisë së llamarinave nuk është atribut i kontraktorit. Nëse do*

konstatoheshin problematika që rrezikojnë funksionin normal të sistemeve, duhet të bëhej njoftim tek investitori dhe në bashkëpunim me projektuesin mund të ishin marrë në shqyrtim defektet. Nga ana e grupit të auditimit janë bërë llogaritjet për të gjithë librezën e masave, sa i takon përdorimit të llamarinave, ku është konstatuar mangësi jo vetëm në trashësi të përcaktuar por edhe në aplikimin e peshës specifike të llamarinave.
- Në lidhje me diferencën e konstatuar në peshën e tubacioneve sqarojmë se, nga ana e subjektit nuk kundërshtohet referenca e peshës së përllogaritur nga grupi i auditimit sipas standardeve UNI 3824 dhe UNI 4992, të përcaktuar në dokumentet e projektit dhe specifikimet teknike.
- Në lidhje me përcaktimin "Nga studimi i të gjithë sistemit të ngrohjes dhe aspirimit kemi menduar që t'i referohemi dhe katalogëve dhe skedave teknike të prodhuesit të sistemit HVAC", sqarojmë se standardet që do të aplikoheshin janë të mirëpërcaktuara në dokumentet e tenderit, në specifikimet teknike dhe në projekt-zbatimin e rikonstruksionit, për të cilat kontraktori dhe mbikëqyrësi i punimeve kanë detyrimin të zbatojnë. Aplikimi standardeve të tjera, përtej atyre të përcaktuara në aktet e mësipërme është në përgjegjësinë e kontraktorit i cili është përzgjedhur për realizimin e saj.

2. Në tenderin e zhvilluar me objekt "Blerje oksigjen për vitin 2020", me këto të dhëna:

<table>
<tr><td colspan="5">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje oksigjen të lëngët për vitin 2020".</td></tr>
<tr><td colspan="2">1. Urdhër Prokurimi nr. 117/13, datë 10.08.2020
2. lloji i Procedurës së Prokurimit (marrëveshje kuadër), e hapur.</td><td colspan="2">3. njësia e prokurimit Urdhër nr. 117/13, datë 10.03.2020
A. C.
L. Y.
L.M.</td><td>4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
Urdhër nr. 117/15, datë 10.08.2020
Loreta Bica
B. G.
A.M.</td></tr>
<tr><td colspan="2">5. Fondi Limit (pa tvsh)
172,339,828 lekë</td><td colspan="2">6. Oferta Fituese (pa tvsh)
172,339,828 lekë</td><td>7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh)
0 lekë</td></tr>
<tr><td colspan="2">8. Data e hapjes së ofertave
30.12.2020</td><td colspan="2">9. Burimi i Financimit
Buxheti i shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
a. Pjesëmarrës në tender
1. ñGTS.ò SHPK, me ofertë 172,339,828 lekë.
Skualifikuar - OE</td></tr>
<tr><td colspan="2">11. Ankimim
-</td><td colspan="2">12. Përgjigje e ankesës nga AK
-</td><td>13. Përgjigje ankesës nga AKKP-
-</td></tr>
<tr><td colspan="5">b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</td></tr>
<tr><td colspan="2">14. lidhje e kontratës
Nr. 117/45, datë 13.11.2020</td><td colspan="2">15. Vlera e kontratës (me tvsh)
74,470,000 lekë (pa TVSH)
33,850,000 lekë (pa TVSH)
64,019,828 lekë (pa TVSH)</td><td>16. Likuiduar
172,339,828 lekë
Pa likuiduar: -lekë</td></tr>
<tr><td colspan="2">17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë 11 situa</td><td colspan="2">18. afati i kontratës në ditë
Parashikuar 12 muaj</td><td>19. Zgjatja e kontratës me ditë
-</td></tr>
<tr><td>20. mbikëqyrësi i punimeve ñDr.ò SHPK</td><td>Licencë</td><td>Kontrata Nr. 2732, datë 13.08.2019.</td><td>Likuiduar</td><td>Pa likuiduar</td></tr>
<tr><td>21. kolaudatori i punimeve
-</td><td>Licencë</td><td>Kontrata
-</td><td>Likuiduar</td><td>Pa likuiduar</td></tr>
</table>

22. **Akt Kolaudimi** Datë-	**23. Akt i marrjes në dorëzim të përkohshëm –**	**24.** Fletë Hyrja nr: - Sipas sasive ditore (4 muaj)

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit ñBlerje oksigjen për vitin 2020ò, fondi limit është përllogaritur me vlerë172,339,828 lekë. Tenderi është zhvilluar me datë 30.12.2020. Në tender ka marrë pjesë vetëm një operator ekonomik, i cili është shpallur fitues me vlerën e fondit limit. Nga nisja e procedurës, është kërkuar realizimi i procedurave me negocim për sasi të ndryshme, nisur nga situata e renduar e pandemisë.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përllogaritjes së fondit limit, dokumenteve të tenderit, vlerësimit të ofertave, dhe zbatimit të kontratës, konstatohet që:

Titulli i gjetjes: Referencë e gabuar në përllogaritjen e fondit limit.

Situata: Kërkesa për blerje oksigjeni sipas procedurës së prokurimit ñBlerje oksigjen për vitin 2020ònë sasinë 2072820 litra, me vlerë 280,286,720.4 lekë, për periudhën nga data 07.08.2020 deri me datë 01.08.2021 është bërë me datë 27.07.2020. Çmimi i përllogaritur është 135.22 lekë për litër.
Kërkesa për blerjen e oksigjenit i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresë nr. 117/1 prot., datë 28.07.2020. Ministria i ka dhënë miratimin nëpërmjet komunikimit elektronik regjistruar me nr. 117/2 prot., datë 04.08.2020. Nga ana e SUSHN, krahas furnizimit të kontraktuar, është kërkuar furnizimi me 170,000 litra me oksigjen për arsye të rritjes së konsumit pasojë e Covid-19.
MSHMS me shkresë nr. 3601/1 prot., datë 03.08.2020, ka rekomanduar lidhjen e menjëhershme të kontratës së furnizimit më oksigjen, si dhe delegimin e të drejtës së zhvillimit të procedurës për furnizimin me afat 1 vjeçar. Bazuar në këtë shkresë përcaktohet që në kompetencat e deleguara përfshihet edhe përllogaritjet e fondit limit në total, sasitë, specifikimet teknike, llojin e procedurës së prokurimit, lidhje dhe ndjekje e kontratës etj.
Bazuar në sa më sipër, është bërë ftesa për ofertë për BOE ñGTS dhe Me. Alb.ò ñBlerje barna ï B1ò, sipas kontratës së nënshkruar ndërmjet MSHMS dhe BOE ñGTS . dhe Me. Alb.ò. Kontrata për sasinë 170000 litra oksigjen është nënshkruar me nr. 117/8 prot., datë 05.08.2020, me OE ñG.T. S.ò, me çmim njësi 135.4 lekë për litër. Afati i realizimit të kontratës është përcaktuar nga data 05.08.2020 deri me datë 21.08.2020.
Theksojmë se kontrata e nënshkruar nga vetë SUSHN me OE ñG.T. S.ò, për vitin 2019, ka rezultuar me çmimin për njësi 135.22 lekë për litër. Marrja për referencë e çmimit për njësi për kontrata të nënshkruara nga MSHMS dhe jo nga vetë institucioni, ka rezultuar me një rritje të çmimit të blerjes së oksigjenit të lëngshëm me 0.18 lekë për litër.
Bazuar në Informacionin nr. 117/17 prot., datë 17.08.2020, të sektorit teknik, është kërkuar furnizimi me sasinë 630000 litra oksigjen i lëngët, për një periudhë 70 ditore, për arsye të konsumit të lartë. Për këtë arsye, është lëshuar urdhri i prokurimit nr. 117/18 prot., datë 18.08.2020, për zhvillimin e procedurës së prokurimit ñNegocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratësò, me fond limit 85,302,000 lekë, për furnizimin e

	sasisë 630000 litra oksigjen të lëngët (çmim njësi 135.4 lekë/litër). Kontrata përkatëse është nënshkruar me nr. 117/26 prot., datë 24.08.2020, për afatin e zbatimit 70 ditor. Sasia e furnizuar sipas procedurave të mësipërme është 2078820 litra. Vlera 374,187 lekë (2078820 litra x 0.18 lekë/litër) konsiderohet efekt negativ financiar.
Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2.
Ndikimi:	Është shkaktuar efekt financiar me vlerë 374,187 lekë, vlerë e cila nuk është e konsiderueshme në krahasim me vlerën e kontratës.
Shkaku	Marrja për referencë e kontratave me çmim më të lartë.
Rëndësia:	E ulët
Rekomandimi:	SUSHN të marrë masa për realizimin e procedurave të prokurimit duke patur në konsideratë ekonomicitetin, eficiencën dhe efektivitetin në përdorimin e fondeve publike.

Për këtë veprim ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Përllogaritjes së Fondit Limit i përbërë nga z. A. P. , znj. M. B. dhe z. E. V.

-Mbi zbatimin e kontratës.
Bazuar në marrëveshjen kuadër, deri në momentin e auditimit janë nënshkruar 3 kontrata, si më poshtë:
Kontrata nr. 117/46 prot., datë 13.11.2020, me vlerë 74,470,00 lekë pa TVSH, për furnizimin e sasisë 550000 litra oksigjen.
Kontrata nr. 117/51 prot., datë 17.12.2020, me vlerë 33,850,000 lekë, për furnizimin e sasisë 250000 litra oksigjen.
Kontrata nr. 117/56 prot., datë 20.01.2020, me vlerë 64,019,828 lekë pa TVSH, për furnizimin e sasisë 472820 litra oksigjen.
Kontrata është realizuar plotësisht sa i përket sasive dhe vlerës. U verifikua dokumentacioni sa i përket furnizimeve ditore, konsumit ditor për të dy tanket, për të gjithë periudhën e furnizimit të kontratës. Furnizimi është bërë nëpërmjet automjeteve autobote në tankerët e SUSHN. Matja e sasisë bëhet nëpërmjet manometrave. Oksigjeni i lëngshëm i furnizuar, kalon për përdorim nëpërmjet tubacioneve. Gjatë periudhës së zbatimit të kontratës, ka patur një fluks të lartë të pacientëve të sëmurë me Covid-19, për të cilët nevojitej të përdoreshin një burim, dy apo tre burime të oksigjenit të lëngshëm.

*Konkluzion:*Fondi limit është ndryshuar në mënyrë të pa argumentuar.
Operatori ekonomik shpallur fitues është i vetmi OE që ka marrë pjesë në procedurat e blerjes së oksigjenit të lëngët në të gjitha procedurat e zhvilluara për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Ofertat e paraqitura nga ky OE për sa trajtohet më sipër kanë qenë me vlerën e fondit limit, pa asnjë zbritje.
Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, anëtarët e komisionittë përllogaritjes së Fondit Limit i përbërë nga z. A. P. , znj. M. B. dhe z. E. V. .**3. Në tenderin e zhvilluar me objekt "Rikonstruksion i disa ambienteve të Spitalit "Shefqet Ndroqi".**

Procedura e prokurimit ñRikonstruksion i disa ambienteve të Spitalit óShefqet Ndroqiôò, është zhvilluar me dy lote. Fondi limit është përllogaritur me vlerë 13,356,671 lekë për të dy lotet, duke

u referuar në manualet e çmimeve të ndërtimit. Në tender kanë marrë pjesë 2 OE, nga të cilët është skualifikuar 1 OE. Oferta e shpallur fituese është më vlerë 10,789,731 lekë pa TVSH.
Nga ana e disa OE janë paraqitur ankesa për kriteret e vendosura, për shqyrtimin e të cilave është ngritur komisioni i përbërë nga z. A.P., znj. A. N.dhe znj. A.M..
Është bërë ankesë nr. 201/4 prot., datë 09.08.2019, nga OE ñK.Kon.ò SHPK. Ankesa ka të bëjë me vendosjen e kriterit të disponimit të licencës III.2.B ñGrumbullim, transportim, ruajtje e mbetjeve urbaneò. Ankesa e këtij OE nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni i përbërë nga z. A. P., znj. A. N.dhe znj. A.M. dhe i është kthyer përgjigje me shkresë nr. 210/14 prot., datë 19.08.2019.
Është bërë ankesë nr. 201/5 prot., datë 09.08.2019, nga OE ñAv.ò SHPK, në lidhje me numrin e personave të punësuar si dy bojaxhi, dy pllakashtrues, dy hekurkthyes, dy specialistë duralumini, dy specialistë për punime druri, dy suvaxhi, dy punonjës të certifikuar për ndihmën e parë. Këtij OE i është kthyer përgjigje me shkresë nr. 210/15 prot., datë 19.08.2019, duke mos marrë në konsideratë ankesën.
Është bërë ankesë nr. 201/6 prot., datë 09.08.2019, nga OE ñS.AGò SHPK. Ankesa ka të bëjë me numrin e punonjësve të punësuar. Këtij OE i është kthyer përgjigje me shkresë nr. 201/16 prot., datë 19.08.20119, duke sqaruar se numri i punonjësve i përcaktuar është për të dy lotet.
Është bërë ankesë nr. 201/7 prot., datë 09.08.2019, nga OE ñA.Kon.ò SHPK, po në lidhje me stafin dhe punonjësit e kërkuar. Ankesa e këtij OE është shqyrtuar duke mos u marrë në konsideratë. Është bërë njoftimi i OE me shkresë nr. 210/17 prot., datë 19.08.2019.

Nga auditimi u konstatua mangësi në lidhje me hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit si më poshtë:

Titulli i gjetjes:	Janë hartuar kritere të pa argumentuara.
Situata:	Për hartimin e dokumenteve të tenderit është mbajtur procesverbali nr. 1, datë 01.08.2019, nga njësia e përbërë nga znj. E. B. , znj. E. T. dhe z. K.D. Nga shqyrtimi i kritereve të vendosura rezulton se: -Është vendosur si kriter disponimi ose marrja me qira e automjeteve ñKamion vetëshkarkues me kapacitet 1-3 ton, Kamionçinë vetëshkarkuese me kapacitet 3-5 ton dhe Kamion vetëshkarkues mbi 10 ton, ndërkohë që volumi i përafërt për transport për të dy lotet është 100 m^3, si për furnizim me materiale, ashtu dhe për largim materiale të dala nga mbeturinat. -Skelë metalike të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë dhe rrjetë mbrojtëse në sasinë 2000 m^2, ndërkohë që punimet që realizohen janë në ambiente të brendshme dhe procesi i vetëm për të cilin kërkohen skela është suvatimi në tavane i cili është parashikuar në sasinë 120 m^2. -Është kërkuar të ketë të punësuar dy specialistë druri, ndërkohë që nuk ka punime të tilla.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar, Neni 46, pika 3. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 61.
Ndikimi:	Vendosja e kritereve jo në përputhje me volumin e kontratës ndikon në pjesëmarrjen në tender të operatorëve ekonomikë.
Shkaku	Mos argumentimi i duhur.
Rëndësia:	E mesme

Rekomandimi:	SUSHN të marrë masa për trajnimin e punonjësve që angazhohen me realizimin e procedurave të prokurimit, me synim realizimin e prokurimeve me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

Ngarkohet me përgjegjësi z. K. D.

Mbi zbatimin e kontratës së punimeve civile.

Kontrata e punimeve civile për lot 1 *"Rikonstruksion i ambienteve të laboratorit mikrobiologjik"*, është nënshkruar me nr. 201/29 prot., datë 30.09.2019, me BOE ñS.AG dhe A. Kon.ò, me vlerë 6,400,166 lekë. Afati për përfundimin e punimeve Lot 1është përcaktuar 8 javë, referuar fillimit të punimeve.

Për mbikëqyrjen e punimeve për të dy lotet është përzgjedhur Shoqëria ñGB. C. Eng.ò SHPK, përfaqësuar nga z. G. B.

Bazuar në procesverbalin përkatës, punimet kanë filluar me datë 07.10.2019. Bazuar në ditarin përkatës, punimet kanë përfunduar brenda afatit, konkretisht me datë 01.12.2019.

Gjatë zbatimit të kontratës dhe verifikimit të volumeve të preventivit, ka lindur nevoja e rishikimit të tyre, të cilat kanë rezultuar me rritje dhe zbritje. Bazuar në procesverbalin e datës 18.11.2019, janë zbritur punime me vlerë 927,240 lekë dhe janë shtuar punime me vlerë 1,083,978 lekë, ndryshime të cilat janë miratuar dhe diferenca e vlerës është përfshirë në fondin rezervë. Nuk kanë rezultuar zëra të rinj punimesh.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes teknike nuk u konstatuan mangësi.

Kontrata e punimeve civile për lot 2*"Rikonstruksion i ambienteve të reanimacionit të Kardio-Kirurgjisë"*, është nënshkruar, me nr. 201/28 prot., datë 30.09.2019, me BOE ñS.AG dhe A. Kon.ò, me vlerë 6,547,512 lekë.Afati për përfundimin e punimeve Lot 2është përcaktuar 11 javë, referuar fillimit të punimeve.

Bazuar në procesverbalin përkatës, punimet kanë filluar me datë 07.10.2019. Bazuar në ditarin përkatës, punimet kanë përfunduar brenda afatit, konkretisht me datë 22.12.2019.

Gjatë zbatimit të kontratës dhe verifikimit të volumeve të preventivit, ka lindur nevoja e rishikimit të tyre, të cilat kanë rezultuar me rritje dhe zbritje. Bazuar në procesverbalin e datës 18.11.2019, janë zbritur punime me vlerë 874,900 lekë dhe janë shtuar punime po me vlerë 874,900 lekë, duke mbajtur të pa ndryshuar vlerën e kontratës. Nuk kanë rezultuar zëra të rinj punimesh.

Situacioni përfundimtar është hartuar me vlerë 6,547,512 lekë.

Punimet janë kolauduar me procesverbal nr. 201/54 prot., datë 30.12.2019.

Marrja në dorëzim e punimeve është bërë me datë 05.03.2021, nga komisioni i përbërë nga znj. S.T. , z. B. Xh. , z. I.N. , z. B. Q. dhe z. R. F.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes teknike nuk u konstatuan mangësi.

4. Në tenderin e zhvilluar me objekt "Marrje 2 kaldaja me qira për ngrohje me lëndë djegëse Pellet, për vitin 2018", me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Marrje 2 kaldaja me qira për ngrohje me lëndë djegëse Pellet"- Viti 2018		
Urdhër Prokurimi Nr.274, Dt 19.12.2017	**Njësia e Prokurimit** E. T. E.B.	**Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër nr. 275, datë 19.12.2017 S.Gj.

Lloji i Procedurës së Prokurimit ñE Hapurò	H. D. **Komisioni Llog fondit limit** Urdhër Nr. 460/1, datë 05.12.2017 A.P., përgj sekt teknik M. B., përgj sekt kostos E. K. , ekonomiste	M. F. S.N.
Fondi Limit **11,696,276 lekë**	**Oferta fituese** ñL.ò Shpk, 11,480,190 lekë	**Diferenca me fondin limit** 216,086 lekë.
Data e hapjes së tenderit **12.01.2018**	**Burimi Financimit** Të ardhurat dytësore	**Operatorët Ekonomikë** Pjesëmarrës në tender ñLu.ò SHPK ñLa. Plepiò
Zbatimi i Kontratës me objekt: "Marrje 2 kaldaja me qira për ngrohje me lëndë djegëse Pellet" Viti 2018		
Lidhja e kontratës Nr.460/6prot, datë 25.01.2018	**Vlera e kontratës** 10,080,366 lekë (-1 muaj)	**Likuiduar 12, 096,439 lekë.**

-Llogaritja e fondit limit, nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, është kryer bazuar në të dhënat e kontratës së mëparshme në qiranë ditore, në llogaritjen e fondit limit janë përcaktuar vlera totale e shërbimit të 2 kaldajave përfshin koston e kaldajave, shpenzimet për vendosjen e tyre, si edhe procese të tilla si, vendosja e silosit 10 ton, vendosja e 2 paneleve elektrike, vendosja e 2 shnekëve, përgatitja e bazamentit për vendosjen e silosit dhe vlerën e shpenzimeve për mirëmbajtjen e tyre në rast defektesh, pra qiradhënësi do të përgjigjet edhe për defektet që lindin gjatë punës në kaldaja dhe bën riparimin e tyre me shpenzimet e veta brenda afatit prej 2 orë nga momenti i marrjes së njoftimit. Për këta zëra, mungon llogaritja e çmimit dhe vlerës. Fondi limit është i paargumentuar, nuk ka asnjë projekt, preventiv apo analizë të hollësishme çmimesh në lidhje me këtë strukture. Grupi i punës nuk ka argumentuar llogaritjen e fondit limit, duke vepruar në kundërshtim me nenin 59 ñPërllogaritja e vlerës limit të kontratësò, të VKM nr.914, datë 29.12.2014ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.*Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e ngritur për llogaritjen e fondit limit, A.P., M. B. dhe E.K. .*

-Referuar procesverbalit të datës 20.12.2017, për miratimin e dokumenteve të tenderit konstatohet se nuk është kërkuar asnjë kriter vlerësues në pikën 2 ñKriteret e veçanta për kualifikimò pika 2.1 ñKapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikëò

Nuk janë kërkuar bilance, kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse neni 28/4.a VKM nr.914, por është kërkuar xhiro mesatare vjetore e sa vlera e fondit limit.

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:

-kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet.

-Nuk janë të argumentuara kriteret e kualifikimit, veprim në kundërshtim me nenin 61/2 ñHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò të VKM nr.914, datë 19.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, ku citohet se: *"Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre".*

-Sipas procesverbalit të datës 12.01.2018, mbi vlerësimin e ofertave të OE, mbajtur nga komisioni për vlerësimin e ofertave, janë paraqitur 2 OE:
Lu.me ofertë,11,480,190 lekë
L. P. , nuk ka paraqitur ofertë. KVO, ka skualifikuar L. P. , për mosparaqitjen e ofertës ekonomike.
-Kaldajat do të realizojnë shërbimin nga data 01.01.2018-31.12.2018.

Nr.	Emërtimi	Ditë pune
1	Kaldajë ngrohje 1 MG	121
2	Kaldajë avulli 1000g/h	365

Raporti përmbledhës paraqitur e miratuar nga titullari më 22.01.2018 dhe shpallur fitues operatori i vetëm në këtë procedurë ñLu.ò me vlerë 11,480,190 lekë. Kontrata është nënshkruar në vlerën 10,080,366 lekë, pasi është nënshkruar në datën 25 Janar.

<u>Mbi zbatimin e kontratës</u>
Për monitorimin e kontratës, konstatohet se nuk janë mbajtur raporte ose procesverbale për periudhën kur kaldaja ndizet përtej afatit të përcaktuar në kontratë, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò dhe nuk ka bazë dokumentuese për zbatimin e kontratës, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, kreu IX, neni 77 ñEkzekutimi dhe mbikëqyrja e kontratësò.
Kaldaja e ngrohjes dhe pelletit janë instaluar ny ambientin e kaldajave ty vjetra që ky spital disponon, me njy sipërfaqe aseti (dhomy kaldaje prej 90 m²). Kaldaja e ngrohjes instalohet ny muajin nëntor dhe hiqet nga aty ny muajin prill sipas kontraty s sy qiras y, ndërsa kaldaja e avullit qëndron gjatë gjithë vitit kalendarik ny funksion ty aktivitetit ty spitalit.
Nga verifikimet ny terren, deklarimet e punonjy sve ty kaldajës dhe verifikimi fizik i kaldajy s pasi ky to dy kaldaja jany ty lidhura ngushty me njy ra tjetry n, kany ty py rbashky t impiantin e marrjes sy ly ndy s djegëse (silosin, shnekun etj) si rrjedhojy kaldaja e ngrohjes nuk y shty ly vizur nga vendi py r periudhy n mbas py rfundimit ty kontraty s.
Nuk y shty marry asnjy masy nga drejtoria e spitalit py r lirimin e hapsiry s prej 45m² (50% e sipy rfaqes totale ty dhomy s sy kaldajave ty zy ny nga kaldaja e ngrohjes) aq my tepy r nuk i y shty ky rkuar operatorit fitues lirimi i ambienteve apo llogaritja e njy qiraje mujore sipas py rcaktimeve ny VKM nr.54, daty 05.02.2014 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, i ndryshuar. Referuar paragrafit III ty kësaj VKM, ndryshuar me VKM nr. 992, datë 09.12.2015 Tarifat dysheme të qirasë mujore për ndërtesat sipas qarqeve, ny qytetin e Tiray s tarifa dysheme y shty përcaktuar 300 lekë/m², (45m² x 300 lekë/m²) = 13,500 leky /muaj qira e pa llogaritur ndaj operatorit ekonomik py r zënie hapësire përtej afatit kontraktor.
Py r periudhën Mars -Tetor 2018, koh y ny ty cily n kjo kaldajy nuk duhet ty ishte ny këto ambiente operatori *ekonomik i detyrohet Spitalit Universitar "Shefqet Ndroqi" vlerën prej 13,500 lekë/muaj x 8 muaj = 108,000 lekë, vlerë e cila përbën të ardhur të munguar për institucionin, pasi operatori ekonomik ka shfrytëzuar asetet e spitalit pa asnjë detyrim.*
Në komisionin e hartimit të specifikimeve teknike dhe llogaritjes së vlerës së kontratës është caktuar i njëjti punonjës edhe për zbatimin dhe ndjekjen e kontratës nëse janë plotësuar specifikimet e kërkuara, veprim në kundërshtim me neni 22/3.b ñVeprimtaritë e kontrollitò, i ligjit nr.10296, datë ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, ku citohet se: ñ*Veprimtaritë e*

kontrollit përmbajnë, minimalisht: a) procedurat dhe autoritetin për delegimin, transferimin dhe regjistrimin e autorizimit standard dhe të rasteve të veçanta; b) ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin".

Titulli i gjetjes:	Fondi limit nuk është i argumentuar.
Situata:	Llogaritja e fondit limit, nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, është kryer bazuar në të dhënat e kontratës së mëparshme në qiranë ditore, në llogaritjen e fondit limit janë përcaktuar vlera totale e shërbimit të 2 kaldajave përfshin koston e kaldajave, shpenzimet për vendosjen e tyre, si edhe procese të tilla si, vendosja e silosit 10 ton, vendosja e 2 paneleve elektrike, vendosja e 2 shnekëve, përgatitja e bazamentit për vendosjen e silosit dhe vlerën e shpenzimeve për mirëmbajtjen e tyre në rast defektesh, pra qiradhënësi do të përgjigjet edhe për defektet që lindin gjatë punës në kaldaja dhe bën riparimin e tyre me shpenzimet e veta brenda afatit prej 2 orë nga momenti i marrjes së njoftimit. Për këta zëra, mungon llogaritja e çmimit dhe vlerës. Fondi limit është i paargumentuar, nuk ka asnjë projekt, preventiv apo analizë të hollësishme çmimesh në lidhje me këtë strukture. Grupi i punës nuk ka argumentuar llogaritjen e fondit limit.
Kriteri:	Neni 59 ñPërllogaritja e vlerës limit të kontratësò, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.
Ndikimi:	Në vlerën e kontratës
Shkaku	Veprime të pa argumentuara
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Përllogaritja e vlerës së kontratës nga njësia e prokurimit/komisionet e ngritura për këtë qëllim, të bëhet duke analizuar koston e mallrave që do të prokurohen, llogaritje të sakta të vlerës së kontratës që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve si edhe duke harmonizuar metodat dhe alternativat e përllogaritjes së vlerës limit të kontratës në raport me specifikimet teknike, me qëllim arritjen e rezultateve të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.

Titulli i gjetjes:	Nuk janë hartuar drejt dhe nuk janë argumentuar kriteret e kualifikimit.
Situata:	Referuar procesverbalit të datës 20.12.2017, për miratimin e dokumenteve të tenderit konstatohet se nuk është kërkuar asnjë kriter vlerësues në pikën 2 ñKriteret e veçanta për kualifikimò pika 2.1 ñKapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikëò. Nuk janë kërkuar bilance, kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse neni 28/4.a VKM nr. 914, por është kërkuar xhiro mesatare vjetore e sa vlera e fondit limit. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktorkërkon:kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Nuk janë të argumentuara kriteret e kualifikimit.
Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit

	publikò, i ndryshuar, neni 11 ñ*Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit", neni 22 "Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës"* pika 3 e nenit 27, Neni 59 ñPërllogaritja e vlerës limit të kontratësò dhe neni 61/2 ñHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò
Ndikimi:	Në pjesëmarrjen dhe përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë.
Shkaku	Mosveprim nga njësia e prokurimit
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Njësia e Prokurimit, për të ardhmen të marrë të gjitha masat, që kërkesat e veçanta kualifikuese, të hartohen në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit, të përcaktohen kritere kualifikimi të sakta dhe të kuptueshme, pa lënë shteg për interpretime si dhe të detajohen sipas rregullave të prokurimit publik. Gjithashtu të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim detyrimisht të argumentuara, për të arritur rezultatet e dëshiruara në efektivitetin e përdorimit të fondeve.
Titulli i gjetjes:	Monitorim pjesor i kontratës
Situata:	Nga verifikimet ny terren, deklarimet e punonjysve ty kaldajës dhe verifikimi fizik i kaldajys pasi ky to dy kaldaja jany ty lidhura ngushty me njyra tjetryn, kany ty pyrbashkyt impiantin e marrjes sy lyndys djegëse (silosin, shnekun etj) si rrjedhojy kaldaja e ngrohjes nuk yshty lyvizur nga vendi pyr periudhyn mbas pyrfundimit ty kontratys. Nuk yshty marry asnjy masy nga drejtoria e spitalit pyr lirimin e hapsiry s prej 45m² (50% e sipyrfaqes totale ty dhomys sy kaldajave ty zyny nga kaldaja e ngrohjes) aq my tepyr nuk i yshty kyrkuar operatorit fitues lirimi i ambienteve apo llogaritja e njy qiraje mujore sipas pyrcaktimeve ny VKM nr.54, daty 05.02.2014 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, i ndryshuar. Referuar paragrafit III ty kësaj VKM, ndryshuar me VKM nr. 992, datë 09.12.2015 Tarifat dysheme të qirasë mujore për ndërtesat sipas qarqeve, ny qytetin e Tirany s tarifa dysheme yshty përcaktuar 300 lekë/m², (45m² x 300 lekë/m²) = 13,500 leky /muaj qira e pa llogaritur ndaj operatorit ekonomik pyr zënie hapësire përtej afatit kontraktor. Pyr periudhën Mars -Tetor 2018, kohy ny ty cilyn kjo kaldajy nuk duhet ty ishte ny këto ambiente operatori *ekonomik i detyrohet Spitalit Universitar "Shefqet Ndroqi" vlerën prej 13,500 lekë/muaj x 8 muaj = 108,000 lekë, vlerë e cila përbën të ardhur të munguar për institucionin, pasi operatori ekonomik ka shfrytëzuar asetet e spitalit pa asnjë detyrim.*
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, kreu IX, neni 77 ñEkzekutimi dhe mbikëqyrja e kontratësò dhe VKM nr.54, daty 05.02.2014 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, i ndryshuar.
Ndikimi:	Në uljen e të ardhurave

Shkaku	Mos zbatim legjislacioni
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Strukturat drejtuese të SUSHN, në të ardhmen të marrin masa përmonitorimin e kontratave të shërbimit dhe përcaktimin e kushteve kontraktuale për qiradhënien për shfrytëzimin maksimal të hapsirës së spitalit sipas legjislacionit në fuqi me qëllim rritjen e të ardhurave dytësore.

5. Në tenderin e zhvilluar me objekt*"Furnizim-vendosje 2 kaldaja dhe aksesorët e tyre".*

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Furnizim-vendosje 2 kaldaja dhe aksesorët e tyre"		
Urdhër Prokurimi Nr.297/12, Dt .04.01.2019 Nr.297/20, Dt.19.02.2019 **Lloji i Procedurës së Prokurimit** "Kërkesë/propozimò	**Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** **Specifikimet teknike** **Komisioni Llog fondit limit** Urdhër Nr. 347, datë 22.11.2018 A.P., përgj sekt teknik M. B., përgj sekt kostos A.M., ekonomiste **Njësia Prokurimit** E.B., përgj sek prok, jurid. E. T., juriste A.P., përgj sek teknik	**Komisioni i Vlerësimit Ofertave** ***Urdhër Nr. 297/13, dt.04.01.2019*** S.Gj. kryetar M. F. H.D. ***Urdhër Nr. 297/16, dt.24.01.2019*** ***Urdhër Nr. 297/21, dt.19.02.2019*** E. K. kryetar M. F. H.D.
Fondi Limit (pa tvsh) **7,999,583 lekë**	**Oferta fituese** 7,110,000 Lekë	**Diferenca me fondin limit** 889,583 Lekë
Data e hapjes së tenderit 21.01.2019 25.01.2019 10.03.2019 18.03.2019	**Burimi Financimit** Të ardhurat dytësore	**Operatorët Ekonomike** Pjesëmarrës në tender ñLu.ò SHPK ñL. P.ò
Zbatimi i Kontratës Shërbimit		
Lidhja e kontratës Nr. 297/40, Datë 12.04.2019	**Vlera e kontratës** 7,110,000 lekë	**Likuiduar** 8,532,000 Lekë me tvsh U shpenzimin nr.605, datë 10.06.2019.

-Për realizimin e kësaj procedure SUSHN, është bazuar në relacionin për blerje kaldaje me nr.31/207prot, datë 23.11.2018, drejtuar Drejtorit të SUSHN, nga përgjegjësi i Financës S.Gj. në lidhje me blerjen e 2 kaldajave, pasi shpenzimet vjetore për shërbimin janë 14 milionë lekë me tvsh, ndërsa po të blihen, nga studimi i tregut ofertat variojnë rreth 9,6 milionë lekë. Megjithëse është lidhur kontrata me objekt ñFurnizim vendosje makineri e pajisje për sistemin e kondicionimit në ambientet e SUSHNò, procesi i ngrohjes vazhdon të kryhet nëpërmjet kaldajave me pellet, dhe kaldajë avulli për lavanterinë dhe ujin sanitar, pasi punimet ende nuk kanë përfunduar. Fondi është miratuar nga Ministria Shëndetësisë me shkresën nr.100/350, datë 11.12.2018, prej 8 milion lekë, për përdorimin e të ardhurave dytësore.

Në SUSHN, shërbimi me kaldajat e ngrohjes dhe avullit është ofruar nëpërmjet kontratave të qirasë prej vitit 2012-2017, me një vlerë të konsiderueshme prej 57,161,058 lekë. Për këtë, nga auditimet e kryera nga KLSH në vite, është theksuar blerja e kaldajave me qëllim uljen e

shpenzimeve dhe vënien në përdorim të kaldajave të institucionit. Deri në vitin 2019 nuk është mundësuar nga Ministria e Shëndetësisë blerja e kaldajave, duke shtuar vlerën e shpenzuar vetëm për periudhën objekt auditimi me ***12,096,439 lekë***, e cila përbën efekt negativ për SUSHN.
-Me shkresat nr.297/3/4/5 prot, datë 22.11.2018, janë kërkuar ofertat ekonomike nga operatorët ekonomikë (OE) ñLu.ò, ñAE. ALò dhe ñJ.-AL Gr.ò, të cilët janë përgjigjur në datën 23.11.2018, me ofertat si më poshtë:
ñLu.ò, ka paraqitur ofertën në vlerën 8,100,000 lekë pa tvsh.
ñAE. ALò, ka paraqitur ofertën në vlerën 7,903,452 lekë pa tvsh.
ñJ.-AL Gr.ò, ka paraqitur ofertën në vlerën 7,995,298 lekë pa tvsh.
Llogaritja e fondit e limit nga komisioni për këtë procedurë është bërë me shkresën nr.297/10, datë 06.12.2018, me vlerë 7,993,583 lekë, pa tvsh.
Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit, shprehet se në çmim janë përfshirë edhe çmimet për shërbimet si: Transporti kaldajave, montimi i tyre brenda në repartin e kaldajave, vendosja e 2 paneleve komandimi, vendosja e shnekëve me reduktor dhe elektromotor, vendosja e një shneku qendror që bën furnizimin me pellet të silosit ditor nga silosi qendror, montimi i silosit metalik qendror me kapacitet 13 ton, montimi i silosit metalik me kapacitet 2.5 ton brenda në repartin e kaldajave. Për këta zëra mungon analiza e çmimit dhe kosto e detajuar sipas zërave të punëve/shërbimeve, por llogaritja e fondit limit është bazuar në vlerën mesatare të 3 ofertave, fondi limit është i paargumentuar. Grupi i punës nuk ka argumentuar llogaritjen e fondit limit, por vetëm ka marrë mesataren e 3 ofertave, veprim në kundërshtim me nenin 59 ñPërllogaritja e vlerës limit të kontratësò e VKM nr.914, datë 29.12.2014ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.
-Referuar procesverbalit të datës 10.01.2019, për miratimin e dokumenteve të tenderit konstatohet se nuk është kërkuar asnjë kriter vlerësues në pikën 2 ñKriteret e veçanta për kualifikimò pika 2.1 ñKapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikëò.
Për kapacitetin teknik, pika 2.3.2 kërkohet që OE, të jetë i pajisur me certifikatë ISO 9001-2015, kërkesë nuk përputhet me objektin e prokurimit, pasi objekti është furnizim-vendosje dhe jo import.
-pika 2.3.3, kërkohet se ofertuesi duhet të paraqesë kërkesat kryesore të sigurisë të përcaktuara në aktet nënligjore të projektimit, të prodhimit, të vlerësimit të konformitetit, të përdorimit dhe kontrollit teknik për grupin e pajisjeve nënpresion, nga DIP.
-Për kapacitetin teknik, pika 2.3.9, kërkohet se ofertuesi duhet të ketë minimum 3 punonjës:
1 elektricist, 1 mekanik dhe 1 punonjës të certifikuar nga IPNP-ja. Për këtë ata duhet të paraqesin certifikata/dëshmi trajnimi konform objektit të kësaj procedure pa përcaktuar llojin e certifikatës/dëshmive, kategoritë, etj.
Pra, nga AK nuk janë argumentuar kriteret teknike si edhe është lënë shteg për paqartësi dhe interpretime në vlerësimin e operatorëve ekonomikë.
-Sipas procesverbalit të datës 25.01.2019, mbajtur nga komisioni për vlerësimin e ofertave, janë paraqitur 2 OE:
L. me ofertë 7,999,000 lekë
L. P., nuk ka paraqitur ofertë. KVO, ka skualifikuar L. P., për mosparaqitjen e ofertës ekonomike si edhe L., për mosplotësim të kritereve të veçanta të kualifikimit pika 2.3.3. sepse certifikata e paraqitur është kërkuar nga DIPA dhe OE e ka paraqitur nga një subjekt privat. Për këtë, *është anuluar procedura me shkresën nr.297/19, datë 07.02.2019*.

Në datën 20.02.2019, APP ka këshilluar AK për problematikat e konstatuara në kriteret e vlerësimit dhe specifikimeve teknike dhe me shkresën nr.297/27, datë 22.02.2019, është hequr pezullimi duke reflektuar mbi rekomandimet e APP.
Në datën 25.02.2019, pranë AK është paraqitur një ankesë nga OE ñCOM.ò, në lidhje me kriteret e vlerësimit.
Me urdhrin e brendshëm nr.72, datë 27.02.2019, është ngritur komisioni për shqyrtimin e ankesës, i përbërë nga anëtarët e kvo, veprim në kundërshtim me neni 78/6. a të VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikò, i ndryshuar, ku citohet se: *"Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përjashtimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm, i cili duhet të jetë ekspert fushe. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës".* Me procesverbalin e datës 16.02.2019, komisioni i shqyrtimit të ankesës ka pranuar ankesën për të ndryshuar 2 prej kritereve të vlerësimit.
Në datën 19.03.2019, sipas procesverbalit të mbajtur nga kvo, është bërë vlerësimi i ofertave ku kanë marrë pjesë 2OE: ñLu.ò me ofertë 7,110,000 lekë dhe ñL. P.ò nuk ka paraqitur ofertë. Kaldajë ngrohje fuqia 1MW dhe Kaldajë avulli 1000kg/h.
-Njësia e prokurimit nuk ka argumentuar kriteret e kualifikimit, në kundërshtim me nenin 61/2 ñHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò të VKM nr.914, datë 19.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.
-Për kapacitetin teknik, pika 2.3.1 kërkohet që OE, të paraqesë kontrata për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të ulët e 40%, realizuar gjatë 3 viteve të fundit. OE ñLu.ò ka paraqitur si kontrata të ngjashme, 2 kontratat e realizuara me SUSHN për vitet 2017 dhe 2018, të cilat kanë objekt *"Marrje 2 kaldaja me qira për ngrohje me lëndë djegëse - Pellet"* dhe jo ñfurnizim vendosje kaldajeò e ngjashme me objektin e prokurimit, në këto kushte është vlerësuar dhe shpallur fitues nga kvo, në kundërshtim me dokumentet e tenderit kriteret e veçanta/kualifikim ñkapaciteti teknikò dhe neni 66/3 ñShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertaveò i VKM nr.914, datë 19.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.
Me urdhrin nr.118, datë 15.04.2019 është ngritur komisioni ñMbi krijimin e komisionit të marrjes në dorëzimò, i përbërë nga: B. Xh. , i cili shprehet se janë ok nga ana elektrike, S. B., B. B., E. A. dhe H. K. .
Procesverbali për marrjen në dorëzim të kaldajave datë 25.04.2019, ku komisioni shprehet se kaldajat e sjella nga OE, janë në përputhje me kontratën dhe specifikimet teknike.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
z. S.Gj., me detyrë zv/drejtor ekonomik, zj. M. F., me detyrë përgjegjëse e sektorit të shërbimeve, zj. H.D., me detyrë infermiere, z. A.P., me detyrë përgjegjës i sektorit teknik, zj. M. B., me detyrë përgjegjëse sektori kostos, zj. E. K. , me detyrë shefe finance dhe zj. A.M., me detyrë ekonomiste.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 22/40 dhe 22/42, datë 24.09.2021 ñMbi Projektraportin e Auditimitò, nga zj. E. T., zj. E.B., zj. H.D. dhe z. A.P., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:*Për tenderin "Marrje me qira 2 kaldaja për ngrohje me pellet për vitin 2018", Ju bëjmë me dije se llogaritja e fondit limit është kryer bazuar në çmimin e qirasë ditore*

të kontratës nr.67/8, për vitin 2017, sipas VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 59, pika 2, germa b. (Bashkëlidhur dokumenti).

-Për tenderin "Furnizim vendosje kaldaje" Operatorët ekonomikë nuk kanë paraqitur ofertë financiare me zërat si: shpenzimet për vendosjen e tyre, si edhe procese të tilla si, vendosja e silosit 10 ton, vendosja e 2 paneleve elektrike, vendosja e 2 shnekëve, përgatitja e bazamentit për vendosjen e silosit, etj..., por oferta ekonomike ka qenë në total për blerjen e kaldajës duke u shprehur se edhe këto zëra janë të përfshirë në ofertë. Si rrjedhim duke mos patur një ofertë financiare për këto zëra, komisioni i përllogaritjes së fondit limit hartoi procesverbalin e studimit të tregut referuar formatit të këtyre ofertave.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: *Në lidhje me pretendimet paraqitura sqarojmë se, llogaritja e fondit limit sipas dokumenteve bashkëlidhur duke ju referuar tenderit të një viti më parë nuk qëndron për arsye se në dokumentet e tenderit AK, ka ndarë zërat e shpenzimeve dhe nuk ka llogaritur çmimin dhe vlerën për çdo zë.*

Po kështu sqarojmë se pretendimi: operatorët ekonomikë (OE) nuk kanë paraqitur ofertë financiare me zëra dhe oferta ekonomike ka qenë në total për blerje kaldaje .....nuk qëndron sepse llogaritja e fondit limit është detyrë e komisionit të ngritur për këtë qëllim dhe nuk ka lidhje me ofertën e operatorëve ekonomikë. Pra, OE, e paraqesin ofertën ashtu si kërkohet në dokumentet e tenderit. Komisioni i llogaritjes së fondit limit nuk ka kryer llogaritjen e kostos së zërave që përbëjnë ofertën dhe vlerën e kontratës. Komentet nuk kanë mbështetje ligjore dhe nuk merren në konsideratë, do të trajtohen në materialin e auditimit.

Sa i takon mos argumentimit të kritereve sqarojmë se megjithëse në procesverbalin e mbajtur për miratimin e dokumenteve të tenderit citohet se njëri/tjetri kriter është kërkuar sipas nenit x, të ligjit ose VKM, kjo nuk do të thotë që është argumentuar. Argumentimi kërkon arsyen përse është kërkuar kriteri. Meqenëse AK dhe njësia e prokurimit në shumicën e prokurimeve ka argumentuar kriteret, ky fakt do të merret në konsideratë sa i takon shkallës së përgjegjësisë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 22/41, datë 24.09.2021 ñMbi Projektraportin e Auditimitò, nga zj. E. T., zj. E.B. dhe H.D., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:*Për tenderin "Marrje me qira 2 kaldaja për ngrohje me pellet për vitin 2018", pika 1&2, kjo procedurë me të njëjtat kritere është hartuar edhe në vitet e mëparshme dhe në 2019, ku u realizua blerja e kaldajave dhe nga auditimet e mëparshme dhe APP nuk është konsideruar shkelje mospasja e kritereve juridike.*

Së dyti, jemi munduar të vendosim kritere sa më të përgjithshme për rritjen e numrit të konkurrentëve.

Së treti, njësia gjykoi të kërkojmë katalog për kaldajën se sa procedura të ngarkohet me artifica kriteresh që mund të kufizojnë numrin e operatorëve.

Pika 3, së pari për të njëjtën procedurë në furnizim vendosje nuk janë kërkuar bilancet dhe nga grupi auditimit nuk është quajtur shkelje.

Së dyti, sipas rekomandimeve të APP dhe takimeve të organizuara me juristë të prokurimeve dhe trajnimeve të ndryshme nuk është parë e domosdoshme kërkesa e bilanceve, sepse këtë kriter e luan më së miri edhe kriteri i xhiros vjetore për 3 vitet e fundit ku shihet ecuria e biznesit.

Së treti, bilancet në shumicën e institucioneve janë hequr nga kriteret e kualifikimit dhe kjo nuk është konsideruar shkelje në procedurat e tjera nga i njëjti grup auditimi.

Së katërti, ne si njësi kemi vendosur mos kërkimin e bilanceve me argumentin se është më e rëndësishme dhe efikase të kërkojmë katalog për të parë specifikimet teknike të kaldajave se sa të shikonim aktivet dhe pasivet të cilat nuk ndikojnë në cilësinë dhe realizimin me sukses të procedurës.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: *Në lidhje me pretendimet paraqitura sqarojmë se, kriteret janë kërkesa ligjore dhe në rastet e përsëritura kjo mangësi nuk trajtohet për çdo tender nga grupi auditimit. Po kështu edhe pretendimi se njësia ka gjykuar për vendosjen e kritereve sa më të përgjithshme për rritjen e numrit të konkurrentëve duke mos kufizuar pjesëmarrjen e OE. Ju kujtojmë se në këtë procedurë prokurimi me objekt "Marrje kaldaje me qira" ndër vite në SUSHN, është paraqitur i njëjti OE dhe nuk ka pasur konkurrencë. Pra, pretendimi nuk qëndron.Po kështu sqarojmë se edhe kërkesa për xhiro vjetore në nivelin 40%, mund të mos jetë në të gjithë tenderat "copy paste"pasi edhe kjo ndikon në mos arritjen e konkurrencës pasi ka OE që mund të kenë një xhiro edhe më të ulët ligji pranon xhiro jo më > se 40%....Në këtë rast nisur edhe nga historiku kur kjo procedurë prej 2012 kontraktohet nga i njejti OE, ju vemë në dukje këtë kriter. Nga grupi auditimit nuk janë kërkuar kritere të tepërta e artifica por janë trajtuar ato të cilat i shërbejnë procedurës. Në dijeninë e grupit të auditimit nuk ka ndryshim ligjor për mos kërkesë të bilancit.Komentet nuk kanë mbështetje ligjore dhe nuk merren në konsideratë, do të trajtohen në materialin e auditimit.*

Sa i takon mos argumentimit të kritereve sqarojmë se megjithëse në procesverbalin e mbajtur për miratimin e dokumenteve të tenderit citohet se njëri/tjetri kriter është kërkuar sipas nenit x, të ligjit ose VKM, kjo nuk do të thotë që është argumentuar. Argumentimi kërkon arsyen përse është kërkuar kriteri. Meqenëse AK dhe njësia e prokurimit në shumicën e prokurimeve ka argumentuar kriteret, ky fakt do të merret në konsideratë sa i takon shkallës së përgjegjësisë.

Titulli i gjetjes: Fondi limit nuk është i argumentuar.

Situata: Llogaritja e fondit e limit nga komisioni për këtë procedurë është bërë me shkresën nr.297/10, datë 06.12.2018, me vlerë 7,993,583 lekë, pa tvsh. Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit, shprehet se në çmim janë përfshirë edhe çmimet për shërbimet si: Transporti kaldajave, montimi i tyre brenda në repartin e kaldajave, vendosja e 2 paneleve komandimi, vendosja e shnekëve me reduktor dhe elektromotor, vendosja e një shneku qendror që bën furnizimin me pellet të silosit ditor nga silosi qendror, montimi i silosit metalik qendror me kapacitet 13 ton, montimi i silosit metalik me kapacitet 2.5 ton brenda në repartin e kaldajave. Për këta zëra mungon analiza e çmimit dhe kosto e detajuar sipas zërave të punëve/shërbimeve, por llogaritja e fondit limit është bazuar në vlerën mesatare të 3 ofertave, fondi limit është i paargumentuar. Grupi i punës nuk ka argumentuar llogaritjen e fondit limit, por vetëm ka marrë mesataren e 3 ofertave.

-Në SUSHN, shërbimi me kaldajat e ngrohjes dhe avullit është ofruar nëpërmjet kontratave të qirasë prej vitit 2012-2017, me një vlerë të konsiderueshme prej 57,161,058 lekë. Për këtë, nga auditimet e kryera nga KLSH në vite, është theksuar blerja e kaldajave me qëllim uljen e shpenzimeve dhe vënien në përdorim të kaldajave të institucionit. Deri në vitin 2019 nuk është mundësuar nga Ministria e Shëndetësisë blerja e kaldajave, duke shtuar vlerën e shpenzuar vetëm për periudhën objekt

auditimi me ***12,096,439 lekë***, e cila përbën efekt negativ për SUSHN.

Kriteri: Neni 59 ñPërllogaritja e vlerës limit të kontratësò, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.

Ndikimi: Në vlerën e kontratës

Shkaku Veprime në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi:
-Përllogaritja e vlerës së kontratës nga njësia e prokurimit/komisionet e ngritura për këtë qëllim, të bëhet duke analizuar koston e mallrave që do të prokurohen, llogaritje të sakta të vlerës së kontratës që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve si edhe duke harmonizuar metodat dhe alternativat e përllogaritjes së vlerës limit të kontratës në raport me specifikimet teknike, me qëllim arritjen e rezultateve të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.
-Strukturat drejtuese të SUSHN, njësia e prokurimit/komisionet e ngritura për kryerjen e prokurimeve/shërbimeve, të analizojnë koston e mallrave/shërbimeve që do të prokurohen, duke zgjedhur vlerëne kontratave në favor të institucionit, me qëllim arritjen e rezultateve të dëshirueshme për të siguruar ekonomicitet dhe efektivitet në përdorimin e fondeve publike.

Titulli i gjetjes: Nuk janë argumentuar kriteret e kualifikimit.

Situata: Referuar procesverbalit të datës 10.01.2019, për miratimin e dokumenteve të tenderit**.** Për kapacitetin teknik, pika 2.3.2 kërkohet që OE, të jetë i pajisur me certifikatë ISO 9001-2015, kërkesë nuk përputhet me objektin e prokurimit, pasi objekti është furnizim-vendosje dhe jo import. -pika 2.3.3, kërkohet se ofertuesi duhet të paraqesë kërkesat kryesore të sigurisë të përcaktuara në aktet nënligjore të projektimit, të prodhimit, të vlerësimit të konformitetit, të përdorimit dhe kontrollit teknik për grupin e pajisjeve nën presion, nga DIP. -Për kapacitetin teknik, pika 2.3.9, kërkohet se ofertuesi duhet të ketë minimum 3 punonjës: 1 elektricist, 1 mekanik dhe 1 punonjës të certifikuar nga IPNP-ja. Për këtë ata duhet të paraqesin certifikata/dëshmi trajnimi konform objektit të kësaj procedure pa përcaktuar llojin e certifikatës/dëshmive, kategoritë, etj.

Kriteri: VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, Neni 59 ñPërllogaritja e vlerës limit të kontratësò, neni 61/2 ñHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò.

Ndikimi: Në pjesëmarrjen dhe përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë.

Shkaku Mosveprim nga njësia e prokurimit

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi:	Njësia e Prokurimit, për të ardhmen të marrë të gjitha masat, që kërkesat e veçanta kualifikuese, të hartohen në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit, të përcaktohen kritere kualifikimi të sakta dhe të kuptueshme, pa lënë shteg për interpretime si dhe të detajohen sipas rregullave të prokurimit publik. Gjithashtu të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim detyrimisht të argumentuara, për të arritur rezultatet e dëshiruara në efektivitetin e përdorimit të fondeve.
Titulli i gjetjes:	Vlerësim i OE pa plotësuar kriterin/kualifikim
Situata:	Për kapacitetin teknik, pika 2.3.1 kërkohet që OE, të paraqesë kontrata për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të ulët e 40%, realizuar gjatë 3 viteve të fundit. OE ñLu.ò ka paraqitur si kontrata të ngjashme, 2 kontratat e realizuara me SUSHN për vitet 2017 dhe 2018, të cilat kanë objekt *"Marrje 2 kaldaja me qira për ngrohje me lëndë djegëse Pellet"* dhe jo ñfurnizim vendosje kaldajeò e ngjashme me objektin e prokurimit, në këto kushte është vlerësuar dhe shpallur fitues nga kvo, në kundërshtim me dokumentet e tenderit kriteret e veçanta/kualifikim ñkapaciteti teknikò.
Kriteri:	neni 66/3 ñShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertaveò i VKM nr.914, datë 19.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.
Ndikimi:	Në rezultatin eprokurimit
Shkaku	Mos zbatim i legjislacionit
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Strukturat drejtuese të SUSHN, në të ardhmen të marrin masa për përcaktimin në komisionet e vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë, të punonjësve specialistë të fushës me qëllim arritjen e rezultateve të kërkuara.

6. Në tenderin e zhvilluar me objekt"Për shërbimin gatim dhe shpërndarja e ushqimit (katering) në pavijonet e SUSHN", me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Për shërbimin gatim dhe shpërndarja e ushqimit (katering) në pavijonet e SUSHN"		
Urdhër Prokurimi Nr.267/4, Dt 11.10.2018	**Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** **Specifikimet teknike**	**Komisioni i Vlerësimit Ofertave** ***Urdhër Nr. 267/5, dt.11.10.2018***

Lloji i Procedurës së Prokurimit **"**Negocim pa shpalljeò	**Komisioni Llog fondit limit** Urdhër Nr. 274, datë 01.10.2018 M. F., përgj sekt shërbimeve E. K. , ekonomiste E. H. , mjeke **Njësia Prokurimit** E.B., përgj sek prok, juridik. E. T., juriste M. F., përgj sek shërbimeve	S.Gj. kryetar M. B. H.D.
Fondi Limit (pa tvsh) **10,090,576 lekë**	**Oferta fituese** 10,050,590 Lekë	**Diferenca me fondin limit** 39,986 Lekë
Data e negocimit 12.10.2018	**Burimi Financimit** Të ardhurat dytësore	**Operatorët Ekonomike** Pjesëmarrës në tender ñSo.ò SHPK
Zbatimi i Kontratës Shërbimit		
Lidhja e kontratës Nr. 267/11, Datë 15.10.2018	**Vlera e kontratës** 10,050,590 lekë	**Likuiduar** 8,739,493Lekë me tvsh.

Sipas kërkesës nr.267, datë 01.10.2018, drejtuar Drejtorit Spitalit nga përgjegjëse e shërbimeve M. F., bëhet me dije se në shtesën e kontratës së shërbimit lidhur me firmën ñSo.ò datë 11.04.2018, janë planifikuar 29,362 racione. Deri në datën 30.09.2018 janë konsumuar 27,080 racione, mbeten për tu konsumuar 2282 racione, e cila është për rreth 10 ditë. Duhet të merren masa të mos mbeten të sëmurët pa ushqim. Kryerja e procedurës është argumentuar me faktin se deri në përfundimin e procedurave të tenderit nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara pranë Ministrisë Brendshme, SUSHN duhet të marrë masa për plotësimin e nevojave me ushqim për pacientët.

Në komisionin e hartimit të specifikimeve teknike dhe llogaritjen e vlerës së kontratës është caktuar i njëjti punonjës edhe për zbatimin, ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të ushqimit dhe konfirmimin nëse janë plotësuar specifikimet e kërkuara, veprim në kundërshtim me neni 22/3.b ñVeprimtaritë e kontrollitò, i ligjit nr.10296 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, ku citohet se: *"Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht: a) procedurat dhe autoritetin për delegimin, transferimin dhe regjistrimin e autorizimit standard dhe të rasteve të veçanta; b) ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin".*

<u>Mbi zbatimin e kontratës.</u>

Kontrata është realizuar në masën 72.4%, për muajt shtator-dhjetor të vitit 2018. Ndjekja e kontratës është kryer nga sektori i shërbimeve, nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se janë mbajtur kronologjikisht aktet e furnizimit me ushqim nga pavionet sipas numrit të pacientëve të shtruar dhe dietat ushqimore të secilit sipas kategorive të përcaktuara në kontratë.

Janë kryer likuidimet me urdhër transfertat nr.20, datë 04.02.2019 në vlerën 1,956,959 lekë, nr.21, datë 04.02.2019 në vlerën 3,186,313lekë dhe nr. 22 datë 04.02.2019 në vlerën 3,596,220 lekë.

Për vitin 2018, është nënshkruar kontrata shtesë Nr.33/4, datë 11.04.2018 me vlerë 19,986,113 lekë me tvsh, e cila është realizuar në masën 100%.

Për shërbimin ñGatim dhe shpërndarje ushqimiò ***për vitin 2019***, janë nënshkruar 4 kontrata:
-Për nevojat e fillim vitit kontrata shtesë Nr.267/18, datë 31.12.2018 me vlerë 2,412,092 lekë me tvsh, e cila është realizuar në masën 99.99%.
-Kontrata Nr.313/14, datë 23.01.2019, me vlerë 121,798,090 lekë me tvsh, e cila është realizuar në masën 76.62%.
-Kontrata Nr.175/29, datë 01.04.2019, me vlerë 18,546,927lekë me tvsh, e cila është realizuar 86.2%. Janë kryer likuidimet me urdhër transfertat nr.478, datë 08.05.2019 në vlerën 3,694,726 lekë, nr.607, datë 12.06.2019 në vlerën 3,812,540 lekë, nr.678, datë 09.07.2019 në vlerën 3,669,680 lekë, nr. 751, datë 13.08.2019 në vlerën 3,127,904 lekë, nr.751, datë 13.08.2019 në shumën 3,127,904 lekë dhe nr. 820, datë 06.09.2019 në vlerën 1,690,618lekë. Në total shuma 15,995,468 lekë.
-Kontrata Nr.175/37, datë 21.08.2019, me vlerë 17,140,363lekë me tvsh, e cila është realizuar në masën 84.6%. Janë kryer likuidimet me urdhër transfertat nr.27, datë 07.02.2020 në vlerën 3,700,238 lekë, nr.67, datë 07.02.2020 në vlerën 3,468,739 lekë, nr.68, datë 07.02.2020 në vlerën 3,372,951lekë, nr. 1302, datë 11.12.2020 në vlerën 851,256 lekë dhe nr.1303, datë 11.12.2020 në vlerën 3,118,424 lekë. Në total shuma 14,511,608 lekë.
Përvitin 2020, për shërbimin ñGatim dhe shpërndarje ushqimiò, është nënshkruar kontrata nr.3, me nr.175/45.prot, datë 31.12.2019, me vlerë të përcaktuar në nenin 3.3 të kontratës në shumën 47,867,973 lekë me tvsh, e cila është realizuar në masën 67.8%. Kontrata është lidhur bazuar në shkresën nr.52/8, datë 04.03.2019 nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP) ñ*Autorizim për lidhje kontrate*ò si edhe Marrëveshjes Kuadër midis ABP dhe Shoqërisë ñSori - ALò për llogari të SUSHN, me vlerë 167,542,596 lekë, me afat 48 muaj.
Janë kryer likuidimet me urdhër transfertat nr.140, datë 12.03.2020 në vlerën 3,641,170lekë, nr. 141, datë 12.03.2020 në vlerën 3,613,408 lekë, nr. 275, datë 07.04.2020 në vlerën 1,928,809lekë, nr. 350 datë 06.05.2020 në vlerën 499,833lekë, nr.623, datë 06.07.2020 në vlerën 931,518 lekë, nr.656, datë 16.07.2020 në vlerën 1,884,668 lekë, nr.718, datë 20.08.2020 në vlerën 1,830,008 lekë, nr.755, datë 23.09.2020 në vlerën 3,817,062 lekë, nr.789, datë 07.10.2020 në vlerën 2,250,133 lekë, nr.1132, datë 28.12.2020 në vlerën 3,547,403 lekë, nr.72, datë 03.03.2021 në vlerën 4,338,039 lekë dhe nr.113, datë 03.03.2021 në vlerën 4,160,065 lekë. Në total shuma 32,492,116lekë.
Për vitin 2021, për shërbimin ñGatim dhe shpërndarje ushqimiò, është nënshkruar kontrata me nr.175/54.prot, datë 31.12.2020, me vlerë 48, 084,559 lekë. Janë kryer 2 likuidime me urdhër transfertat nr.284, datë 30.03.2021 në shumën 2,553,204 lekë dhe nr.259, datë 24.03.2021 në shumën 3,960,175 lekë.
Nga auditimi i likuidimeve të kryera konstatohen në disa raste vonesa me 1-3 muaj, veprime në kundërshtim me ligjin nr.48/2014 ñPër pagesat e vonuara në detyrimet kontraktoreò neni 6 ñAfatiò.
Referuar dokumentacionit të mbajtur për kontrollin periodik të ushqimit, konstatojmë se përmbajtja e të gjitha akteve të mbajtura nga komisioni i ngritur nga SUSHN, (i përbërë nga M. F., L. T. dhe B. H.) dhe përfaqësuesi i shoqërisë Sori-al, është njësoj duke cituar vetëm 4 tregues si: ushqimi është sipas menysë dhe gramaturës, orari i ushqimit është sipas kontratës, ushqimi ka cilësi të mirë dhe ushqimi është i paketuar.
Në këto aktkontrolle nuk është pasqyruar në asnjë rast ndonjë mangësi në zbatimin e kontratës si edhe nuk janë pasqyruar kërkesa të tjera të kontraktuesit sipas neneve 6, 9, 10, 12 dhe 13, të kontratës në lidhje me transportin, pajisjet e përdorura, higjienën, treguesit matës të cilësisë, servirjen e ushqimit, etj.

Në nenin 6.4 të kontratës përcaktohet se porositësi në çdo pavijon ka caktuar një dhomë të veçantë (minikuzhinë) që përdoret për mbajtjen e inventarit dhe për shpërndarjen e ushqimit, i cili i është dhënë në përdorim kontraktuesit për ta mirëmbajtur në funksion të kryerjes së shërbimit.

Për ambientet e vëna në dispozicion të operatorit ekonomik nuk janë përcaktuar në marrëdhëniet kontraktuale detyrimet mes palëve sa i takon qirasë së ambientit ose shpenzimeve për ujë dhe drita.

Në nenin 29 të kontratës përcaktohet se të drejtën e kontrollit të ushqimit, pastërtisë e ka personi i caktuar nga AK, në prani të kontraktuesit i cili është i detyruar të ruaj kampionet e çdo lloj ushqimi dhe vakti jo më pak se 24 orë. Përfaqësuesi i SUSHN, çdo vakt firmos procesverbalin e ndërrimit të kampionit. Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e kontrollit në prani të përfaqësuesit të autorizuar të kontraktuesit sipas ligjit "Mbi inspektoratin sanitar".

Nga auditimi i zbatimit të kontratave për shërbimin ñGatim dhe shpërndarje ushqimiò për periudhën objekt auditimi, konstatohet se dokumentacioni është nënshkruar nga k/infermieri i çdo pavijoni dhe përmbledhësja nga përgjegjësi i kartotekës ku konfirmohet forca ushqimore e çdo pavijoni. Dokumenti(formulari) ku pasqyrohet forca ushqimore ka të përcaktuar në ekstremitete se duhet nënshkruar nga k/infermieri dhe shefi i pavijonit, por konstatohet se janë në numër të pakët rastet ku dokumenti është nënshkruar nga shefat e pavijoneve, rezulton të jetë nënshkruar vetëm nga k/infermieri, veprime në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 ñMbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò Kreu III/2 ñDokumentimi i lëvizjes së aktiveveò pika 35/b, 36 dhe 54, ku citohet:

"35. Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në: a. Dokumente autorizues - janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Të tilla janëurdhrat e blerjeve, kontratat, urdhripër krijimin e komisioneve, urdhërpër nxjerrje jashtëpërdorimit, etj. b. Dokumente vërtetues - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe ne mënyre kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe te tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi. c. Dokumente të kontabilitetit - janë dokumentetpërmbledhës ose regjistratkontabël (libri i madh, librat analitike, kartelat e aktiveve, etj) te çdo lloj forme 11, bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

36. Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative12. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnëmundësinëpër gabime, harresa, numërim te dyfishte si dhe atë te mashtrimeve.

54. Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë nëse fletëhyrja ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve te kontratës si proces verbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, fletë hyrje origjinale, proces-verbal i marrjes në dorëzim të mallit, etj."

Punonjëset e kartotekës dhe sektori statistikës, të cilat hartojnë përmbledhëset mujore mbi bazën e këtij dokumentacioni kanë pranuar dokumentin ñForca ushqimoreò të plotësuar dhe nënshkruar vetëm nga k/infermieri, në kundërshtim me sa më lart.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:*z. S.Gj., me detyrë zv/drejtor ekonomik, zj. M. F., me detyrë përgjegjëse e sektorit të shërbimeve dhe zj. S. T. me detyrë përgjegjëse e sektorit të informacionit mjeksor dhe statistikës.

Titulli i gjetjes:	Mangësi në përbërjen e grupeve të punës për prokurime.
Situata:	Në komisionin e hartimit të specifikimeve teknike dhe llogaritjen e vlerës së kontratës është caktuar i njëjti punonjës edhe për zbatimin, ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të ushqimit dhe konfirmimin nëse janë plotësuar specifikimet e kërkuara.
Kriteri:	ligji nr. 10296 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar, neni 22/3.b ñVeprimtaritë e kontrollitò
Ndikimi:	Në zbatimin e kontratës
Shkaku:	Mos zbatim i ligjit
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Strukturat drejtuese të SUSHN, të marrin masa për ndarjen e detyrave dhe përcaktimin në grupet e punës për kryerjen e procedurave të prokurimit e deri në zbatimin e kontratës, të punonjësve të cilët nuk janë përgjegjës në faza të ndryshme të procesit që nga propozimi, miratimi, zbatimi e marrja në dorëzim i mallrave, punëve/shërbimeve.

Titulli i gjetjes:	Mangësi në monitorimin e kontratave të ushqimit të pacientëve
Situata:	Referuar dokumentacionit të mbajtur për kontrollin periodik të ushqimit, konstatojmë se përmbajtja e të gjitha akteve të mbajtura nga komisioni i ngritur nga SUSHN, (i përbërë nga M. F., L.T. dhe B.H.) dhe përfaqësuesi i shoqërisë So.-al, është njësoj duke cituar vetëm 4 tregues, si: ushqimi është sipas menysë dhe gramaturës, orari i ushqimit është sipas kontratës, ushqimi ka cilësi të mirë dhe ushqimi është i paketuar. Në këto aktkontrolle nuk është pasqyruar në asnjë rast ndonjë mangësi në zbatimin e kontratës si edhe nuk janë pasqyruar kërkesa të tjera të kontraktuesit sipas neneve 6, 9, 10, 12 dhe 13, të kontratës në lidhje me transportin, pajisjet e përdorura, higjienën, treguesit matës të cilësisë, servirjen e ushqimit, etj.
Kriteri:	Kontrata nr.175/45.prot, datë 31.12.2019, nenet 6, 9, 10, 12 dhe 13
Ndikimi:	Subjektivizëm në vlerësimin e Cilësisë së ushqimit
Shkaku	Nuk janë ndjekur të gjitha detyrimet kontraktore
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Shërbimeve në bashkëpunim me strukturat e caktuara në pavijonet e spitalit për monitorimin e kontratës së shërbimit ñgatimi dhe shpërndarja e ushqimit të sëmurëveò, të hartojnë dokumentacionin mbi të

cilin do të kryhet monitorimi, duke pasqyruar të gjitha detyrimet e kontraktorit ndaj shërbimit, me qëllim arritjen e treguesve në parametra sasiorë dhe cilësorë të kontraktuar.

Titulli i gjetjes:	Mangësi në kushtet e kontratës
Situata:	Për ambientet e vëna në dispozicion operatorit ekonomik ñSo.-alò nuk janë përcaktuar në marrëdhëniet kontraktuale detyrimet mes palëve sa i takon qirasë së ambientit dhe shpenzimeve për ujë dhe drita. Në nenin 6.4 të kontratës përcaktohet se porositësi në çdo pavijon ka caktuar një dhomë të veçantë (minikuzhinë) që përdoret për mbajtjen e inventarit dhe për shpërndarjen e ushqimit katering, i veçantë (minikuzhinë) që përdoret për mbajtjen e inventarit dhe për shpërndarjen e ushqimit, i cili i është dhënë në përdorim kontraktuesit për ta mirëmbajtur në funksion të kryerjes së shërbimit.
Kriteri:	Kontrata nr.175/45.prot, datë 31.12.2019, neni 6.4
Ndikimi:	Ulje e të ardhurave
Shkaku	Mos zbatimi ligjit
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Strukturat drejtuese të SUSHN, të marrin masa për të përcaktuar në kontratën e shërbimit me operatorin ekonomik ñSo.-alò, detyrimet e qirasë që rrjedhin nga përdorimi i ambienteve të spitalit dhe shpenzimet për ujë e energji elektrike referuar legjislacionit në fuqi, me qëllim rritjen e të ardhurave dytësore.

Titulli i gjetjes:	Mangësi në mbajtjen e dokumentacionit
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të kontratave për shërbimin ñGatim dhe shpërndarje ushqimiò për periudhën objekt auditimi, konstatohet se dokumentacioni është nënshkruar nga k/infermieri i çdo pavijoni dhe përmbledhësja nga përgjegjësi i kartotekës ku konfirmohet forca ushqimore e çdo pavijoni. Dokumenti(formulari) ku pasqyrohet forca ushqimore ka të përcaktuar në ekstremitete se duhet nënshkruar nga k/infermieri dhe shefi i pavijonit, por janë në numër të pakët rastet ku dokumenti është nënshkruar nga shefat e pavijoneve, rezulton të jetë nënshkruar vetëm nga k/infermieri. Punonjëset e kartotekës dhe sektori statistikës, të cilat hartojnë përmbledhëset mujore mbi bazën e këtij dokumentacioni kanë pranuar dokumentin ñForca ushqimoreò të plotësuar dhe nënshkruar vetëm nga k/infermieri.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 ñMbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò Kreu III/2 ñDokumentimi i lëvizjes së aktiveveò pika 35/b, 36 dhe 54.
Ndikimi:	Saktësia e dokumenteve vërtetues për kryerjen e pagesës

Shkaku	Mos zbatim i legjislacionit
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Sektori i Statistikës në bashkëpunim me strukturat e caktuara në pavijonet e spitalit për monitorimin e kontratës së shërbimit ñgatimi dhe shpërndarja e ushqimit të sëmurëveò, të plotësojnë dhe pranojnë dokumentacionin mbi të cilin do të kryhet pagesa ndaj operatorit ekonomik ñSo.-alò, duke pasqyruar saktë numrin e të shtruarve në çdo pavijon, lëvizjet ditore,etj, të nënshkruar nga personat përgjegjës për ti dhënë forcën e dokumentit vërtetues pagese.

7. Në tenderin e zhvilluar me objekt"*Furnizim vendosje pajisje për hapjen e sallës së kardio kirurgjisë"*, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "*Furnizim vendosje pajisje për hapjen e sallës së kardio kirurgjisë*"		
Urdhër Prokurimi Nr. 111/32 Dt. 25.02.2020.	**Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** **Specifikimet teknike** Urdhër Nr. 111/4 datë 26.12.2019. M. S., mjek hemodinamist A.M., ekonomiste L.P. , ing biomjeksor **Njësia Prokurimit** Urdhër Nr. 111/32 datë 25.02.2020.	**Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër Nr. 111/33 dt. 25.02.2020. A. C. R. D. O. Dh.
Lloji i Procedurës së Prokurimit ñE hapurò		
Fondi Limit (pa tvsh) **72, 500, 000 lekë**	**Oferta fituese** **71.700.000** lekë	**Diferenca me fondin limit** 800,000 lekë
Data e hapjes së tenderit 10.07.2020.	**Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit - investime.	**Operatorët Ekonomike** Pjesëmarrës në tender: **"FE." SHPK & B.O.E. "MO." & "BIOM. ALB." SH.P.K.**
Zbatimi i Kontratës Shërbimit		
Lidhja e kontratës Nr. 111/111, Datë 28.12.2020	**Vlera e kontratës** 72,500,000lekë	**Likuiduar** 78,048,000 Lekë me tvsh UShpenzimi nr. 95, datë 16.02.2021 shuma 34,878,000lekë. UShpenzimi nr.279, datë 29.03.2021 shuma 7,818,000 lekë U Shpenzimi nr.341, datë 22.04.2021 shuma 35,352,000 lekë

Procedura e tenderit ka filluar në datë 25.02.2020 me ngritjen e njësisë së prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave. Në datën 10.07.2020, është bërë hapja e ofertave.
Vlerësimi i Ofertave nga Komisioni është kryer më datë 13.07.2020. Kanë paraqitur ofertë operatorët ekonomikë, si më poshtë:
-ñFE.ò shpk me ofertë ekonomike 71,700,000 lekë pa TVSH

-Bashkimi ekonomik i operatorëve ñMO.- J620...07F dhe BIOM. Albania -J618....2Eò, me përfaqësues operatorin ñBIOM. Alb.ò me ofertë ekonomike 58,597,000 lekë,pa TVSH.
-ñO.E.S Dis. - K31....54Nò, i cili nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
KVO me Procesverbalin e datës 13.07.2020, ka kualifikuar 2 Operatorët ekonomikëpjesëmarrës, FE. shpk, dhe Bashkimin ekonomik te operatorëve ñMO. - J62..07F dhe BIOM. Alb. -J61...2Eò, me përfaqësues operatorin ñB. Albaniaò.
Operatori ekonomik ofertues i renditur i dyti ñFe.ò shpk, ka paraqitur Formular Ankese pranë A.K ñShefqet Ndroqiò, Nr. 111/ 87 Prot., datë 17.07.2020. A.Kka pezulluar kryerjen e veprimeve nëpërmjet Urdhrit tëBrendshëm Nr. 111/ 88 Prot., datë 20.07.2020 dhe ka ngritur Komisionin e Shqyrtimit te Ankesës.
Në datën 04.08.2020 K.P.P , me Vendimin Nr. 862/1 Prot., date 04.08.2020, protokolluar me Nr. 111/89 Prot., datë 05.08.2020, urdhëron A.K Spitalin Universitar ñShefqet Ndroqiò, të pezullojë veprimet dhe të vendos në dispozicion të KPP-se dokumentacionin përkatës të dosjes së prokurimit.
K.P.P nëpërmjet Vendimit Nr. 547/1 Prot., date 03.12.2020, protokolluar ne SUSHN me Nr. 111/97 Prot., datë 07.12.2020, vendos të pranojë Ankesën e O.E Fe., duke u shprehur:
ñé *Pranimin e ankesës se O.E "Fe." shpk., për procedurën e prokurimit publik "Procedurë e hapur", me Nr. REF: 53063-03-05-2020, me objekt: "Furnizim vendosje pajisje, për hapjen e sallës së reanimacionit të Kardio-kirurgjisë" në S.U. Shefqet Ndroqi, me fond limit 72.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar nëdatën 10.07.2020, nga A.K., Spitali Universitar Shefqet Ndroqi, Tiranë.*
A.K prokurues të anulojë vendimin e KVO-se për kualifikimin e bashkimit te O.E "Biom. Alb." shpk & "Mo." shpk dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara , duke e skualifikuar këtë Operator Ekonomik ..."
Komisioni i Vlerësimittë Ofertave, nëdatën 10.12.2020, në mënyrë individuale, ka kryer vlerësimin elektronik sipas rregullave të procedurës elektronike, duke zbatuar vendimin Nr. 547/1 Prot., datë 03.12.2020.
Pas pasqyrimit te vendimit Nr. 547/1 Prot., datë 03.12.2020, në SPE, Bashkimi i përkohshëm i shoqëriveñBi. Alb. dhe Mo.ò kanë paraqitur një Ankesëpranë A.K protokolluar me Nr. 111/101 Prot., datë 17.12.2020. Kthyer përgjigje shkresore në datë Nr. 111/102 Prot., datë 18.12.2020.
Në përfundim, KPP me vendimin Nr. 547/4/2020, protokolluar me Nr. 111/104 Prot., datë 21.12.2020, ka hequr nga pezullimi procedurën ñ*Furnizim - Vendosje Pajisje, për hapjen e Sallës së Reanimacionit të Kardio-Kirurgjisë"* në S.U ñShefqet Ndroqiò Tiranë*, me Fond limit: 72,500,000 lekë pa TVSH,* identifikuar me NR. REF-53063-03-05-2020.
Ky vendim i KPP-se është pasqyruar me Urdhrin e Brendshëm Nr. 111/105 Prot., datë 21.12.2020, për heqjen nga pezullimi të kësaj procedure.
Me publikimin e vendimit të kvo në sistemin prokurimit elektronik datë 10.12.2020, ku është sõkualifikuar bashkimi i operatorëve ñBiom.&Mo.ò, ky i fundit ka paraqitur ankesë pranë KPP në datë 17.12.2020. Në lidhje me vendimin e KPP, ky operator ekonomik, sqaron se në lidhje me furnizimin e artikullit 15-makinë anestezie, konkretisht me parametrin e ndriçimit LED si edhe në lidhje me alarmin APNEA, ku pretendohet se ky artikull nuk është i rregullt sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit, sqarojmë se artikulli 15, është ofruar me 2 opsione të mundshme:
-produktin model CARESCAPE 620 nga prodhuesi amerikan General Elekrtik dhe produktin model CAELUS nga prodhuesi Medec Internacional BV. Produkti i prodhuesit amerikan General Elektric me model CARESCAPE 620, është sõkualifikuar nga KPP me argumente të pabazuara

klinikisht, të cilat nuk mund të konsiderohen as devijime minore. Mosgjendja në katalog e ndriçimit në ekranin e pasëm të ekranit me teknologji LED(për të cilin mund të ishin kërkuar sqarimeduke konsideruar diferencën e ofertave prej 13,103,000lekë) dhe alarmin APNEA për 30 sekonda. Ju evidentojmë se në ditët e sotme të gjithë ekranet me prekje aq më shumë ata mjekësorë përdorin ndriçim LED.....ky është një produkt i njohur ndërkombëtarisht për sigurinë dhe cilësinë që ofron....ndërsa për alarmin APNEA, nëse pacienti qëndron në gjendje APNEA për 120 sekonda si kërkohet në DT, nuk ka më mundësi rikuperimi nëse indet cerebrale qëndrojnë për 120 sekonda pa oksigjen. Alarmi APNEA vendoset deri maksimumi 30 sekonda për arsye sigurie. Kërkesa e alarmit jo rastësisht përputhet 100% me specifikimin e makinës së anestezisë model Flow-c nga prodhuesi Gentinge i përfaqësuar nga kompania ñFE.ò në Shqipëri. Pra, KPP ka skualifikuar thjesht njërin nga 2 opsionet e pajisjeve të ñBiom.&Mo.ò.
Gjithashtu, evidentojmë faktin se oferta përveçse më e ulët ekonomikisht ofron edhe produktet më të mira të prodhuesve më të mirënjohur në botë. Për informacion KPP njoftojmë se ñFe.ò ka disa mangësi në ofertën e tij, në lidhje me produktin 600 artikulli 12, 12.4 Respirator, i cili nuk plotëson plotësisht specifikimet e kërkuara në DST. Produkti elisa 600 nuk disponon funksionet e avancuara të respiratorit, i cili është shumë i papërshtatshëm në reanimacion. Po kështu, duke qenë se ñFe.ò përfaqëson kompaninë kineze MI. për pajisjet e ekografisë, ju informojmë se ky prodhues nuk disponon në portofolin e tij asnjë produkt për aplikime të dedikuara dhe të avancuara kardiake ekogratike. Pajisja model FALCO e paraqitur nga OE ñFE.ò nuk plotëson specifikimet e kërkuara, kjo pajisje mundëson trigger fluksi në interval të kufizuar 0.3-15 litra/minutë.....e cila është e papërshtatshme me nevojat e pacientëve të cilët i janë nënshtruar ndërhyrjeve kirurgjikale të cilët kanë nevojë për ndjeshmëri maksimale në identifikimin e nevojave respiratore. Autoriteti kontraktor në datën 18.12.2020, ka kthyer përgjigje se ka zbatuar vendimin e KPP. Në datën 24.12.2020 bashkimi operatorëve ñBiom.&Mo.ò ka paraqitur ankesë në KPP, me të njëjtat pretendime.
Komisioni i Prokurimit Publik, ka vendosur të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ñBiom.&Mo.ò, pasi nuk sjell fakte të reja si edhe kjo çështje e pretenduar merr cilësinë e një çështjeje të shqyrtuar tashmë nga KPP, situatë kjo analoge me çështjet që janë gjykuar njëherë nga gjykata, për të cilat zbatohet parimi i ñgjësë së gjykuar njëherëò nga gjykata, iso lege, pretendimet nuk mund të merren në shqyrtim. Operatori ekonomik nuk legjitimohet për paraqitjen e ankesës në KPP, e rrjedhimisht pretendimet nuk merren në shqyrtim nga KPP.
KPP, para shqyrtimit në themel të pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues, konstaton se ky i fundit nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë për skualifikimin e operatorit ekonomik ñFe.ò për shkak se nuk gëzon asnjë interes të ligjshëm në këtë procedurë prokurimi, etj. Akoma më tej KPP, gjykon se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorit për të cilin paraqet pretendime për kualifikim duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorët e renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike.

Nga auditimi i dosjes konstatohet se,procedurat e ankimimit janë tejzgjatur duke kaluar afatet, pasi nga KPP procedura pa kthyer përgjigje me vendim ka zgjatur prej datës 17.07.2020 - 21.12.2020, ose 5 muaj me vonesë, e cila ka sjellë vështirësi në lidhjen dhe zbatimin e kontratës, pasi në fund të vitit mbyllen fondet buxhetore të akorduara për vitin 2020.
Komisioni i vlerësimit të ofertave ka vlerësuar në vend të parë operatorin ekonomik Bashkimi i përkohshëm i shoqërive ñBi. Alb. dhe Mo.ò me ofertë ekonomike 58,597,000 lekë pa TVSH. Nga ballafaqimi i kryer me anëtarët e kvo, u konfirmua se pajisjet e sjella dhe vlera e bashkimit të

operatorëve ñBi. Alb. dhe Mo.ò përmbushnin parametrat dhe ishin pajisje cilësore të kompanisë ñGe. Elek.ò.
Specifikimet teknike të hartuara nga AK, kanë pësuar disa ndryshime si pasojë e ankesave të operatorëve ekonomikë.
Referuar dokumenteve në dispozicion dhe ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, ***vendimi i KPP ka gjeneruar fituesin me vlerë më të lartë prej13,103,000 lekë.***
Veprimet e mësipërme janë shkaktuar nga vendimi nr.547/2020 i KPP.

Titulli i gjetjes:	Vonesë në përfundimin e tenderit shoqëruar me efekt negativ
Situata:	Procedurat e ankimimit janë tejzgjatur duke kaluar afatet, pasi nga KPP procedura pa kthyer përgjigje me vendim ka zgjatur prej datës 17.07.2020 - 21.12.2020, ose 5 muaj me vonesë, e cila ka sjellë vështirësi në lidhjen dhe zbatimin e kontratës, pasi në fund të vitit mbyllen fondet buxhetore të akorduara për vitin 2020. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka vlerësuar në vend të parë operatorin ekonomik Bashkimi i përkohshëm i shoqërive ñBi. Alb. dhe Mo.ò me ofertë ekonomike 58,597,000 lekë pa TVSH. Nga ballafaqimi i kryer me anëtarët e kvo, u konfirmua se pajisjet e sjella dhe vlera e bashkimit të operatorëve ñBi. Alb. dhe Mo.ò përmbushnin parametrat dhe ishin pajisje cilësore të kompanisë ñGe. Elek.ò. Specifikimet teknike të hartuara nga AK, kanë pësuar disa ndryshime si pasojë e ankesave të operatorëve ekonomikë. Referuar dokumenteve në dispozicion dhe ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, *vendimi i KPP ka gjeneruar fituesin me vlerë më të lartë prej 13,103,000 lekë*
Kriteri:	Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar, neni 1 ñQëllimi i ligjitò
Ndikimi:	Rritje e vlerës prokurimit
Shkaku	Specifikimet teknike
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Autoriteti Kontraktor (SUSHN), për procedurat e prokurimit kryesisht me objekt ñpajisje mjekësoreò që do të kryej në të ardhmen, të marrë masa për përcaktimin e saktë të specifikimeve teknike nga specialistë të fushës në bashkëpunim me mjekë specialistë që do tí përdorin, me qëllim arritjen e prokurimit brenda afateve, me efektivitet dhe ekonomicitet.

8. Në tenderin e zhvilluar me objekt*"Shërbimi i sigurimit të ruajtjes me roje private 2019 – Marrëveshje kuadër",* me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "*Shërbimi i sigurimit të ruajtjes me roje private*"		
Urdhër Prokurimi Nr. 257/5 dt 22.10.2018	**Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** **Specifikimet teknike**	**Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër Nr. 257/6 dt. 22.10.2018.

Lloji i Procedurës së Prokurimit **"**E hapurò Marrëveshje kuadër 12 muaj	Urdhër Nr. 257/1, datë 19.09.2018. **Njësia Prokurimit** Urdhër Nr. 257/5 datë 22.10.2018. E.B. - Përgjegjëse e Zyrës Juridike dhe Prokurimeve, E. T. - Juriste A.P. - Përgjëgjes i Teknikes.	S.Gj. - Kryetar i KVO, M. F. - Anëtare H. D. - Anëtare.
Fondi Limit (pa tvsh) **15,086,273 lekë**	**Oferta fituese - Marrëveshje kuadër** 15,011,221.26 lekë	**Diferenca me fondin limit** 75,051.74Lekë
Data e hapjes së tenderit 24.12.2018; ora: 10:00.	**Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit.	**Operatorët Ekonomike** Pjesëmarrës në tender 10 Operatorë Ekonomikë

Referuar dokumentacionit të administruar dhe të vënë në dispozicion nga AK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, konstatohet si më poshtë vijon:

-Me kërkesën nr. 257 e datës 19.09.2018, z. A.P. me detyrë Përgjegjësi i Sektorit Teknik*: është kërkuar krerja e shërbimit me njëturn në vend rojen e Administratë, Bodrumit dhe Parkingut si rrjedhojë e shkurtimit të buxhetit.*

-Titullari i AK z.P. K. , me nr.257/1 prot., datë 19.09.2018 ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për përllogaritjen e fondit limit.

-Grupi i Punës për Përllogaritjen e Fondit limit: A.P. Përgjegjës i sektorit teknik, E. K. ekonomiste e lartë dhe A. M. Ekonomiste.

-Përllogaritja fondit limit për prokurimim me objekt:*"Shërbim i rojeve private të SUSHN, me 4 vend-roje me 24 orë tre turne, dhe 4 vënd–roje me një turn dhe dy ndërtesa me kamera"*

- **-**Vlera mujore e përllogaritur për një roje në muaj është **49,037.9** lekë për rojet me tre turne
- - Vlera mujore e përllogaritur për një roje në muaj është **42,222.06** lekë për rojet me një turn
- -Numri total i rojeve që nevojitet për të të përmbushur shërbimin është 26.56 rojenë muaj.
- -Vlera monetare pa TVSH që duhet tenderuar është **15,086,273.2** lekë
- -TVSH **3,017,254.6**lekë
- -Vlera monetare me TVSH që duhet tenderuar është **18,103,527.8** lekë

Formularin e Deklarimit të mungesës së konfliktit të interest në zbatim të nenit 56 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò.

-Përllogaritja e fondit limit është bërë për periudhën kohore nga data 19.09.2018 deri më datë 04.10.2018.

Nr	**Emërtimi**	**Vlera Lekë/ roje/muaj**
1	Paga minimale	36,000
2	Shtesa për turne II, III, festa zyrtare dhe pushime vjetore	5,811.44
	Shuma I	**41,811.44**
3	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore 16.7% punëdhënësi	6,982.51
	Shuma II	**7,207.51**
	Shuma III = I + II	**48,793.95**
4	**Fitimi 4 %**	243.96
	Totali I + II + III	**49,037.9**

<u>Përllogaritja e detajuar e zërave të tabelës është si më poshtë:</u>

a- Paga bazë e vendosur me VKM nr.391, datë 03.05.2017 është 24,000 lekë.

b- Paga bazë për punonjësit e SHPSF-së referuar ligjit nr. 75/2014 òPër shërbimin privat të sigurisë fizikeò, neni 18 pika g òPaga e punonjësit të rolit bazë të shërbimit të jetë minimalisht 50% më e madhe se paga minimale e përcaktuar me VKMò është 36,000 lekë.

c- Shtesat për turne II, III festa zyrtare dhe pushime vjetore paraqiten si më poshtë;

- Punonjësit që punojnë natën, në ditën e pushimit javor e të festave zyrtare, brenda kohëzgjatjes normale ditore të punës përfiton një shtesë page në masën.

- 20% për çdo orë e shërbimit të kryer nga ora 19 ^{00}-22 ^{00}

- 50% për çdo orë e shërbimit të kryer nga ora 22 ^{00}-06 ^{00}

-25% për punën e kryer në ditët e festave zyrtare dhe të pushtimit javor.

-75 % për çdo orë e shërbimit të kryer natën në ditët e festave zyrtare dhe të pushtimit javor.

Në dosje e prokurimit gjendet procesverbali për miratimin e kritereve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike i asistuar nga APP me shkresën nr. 257/3 datë 11.10.2018 email.

- **Urdhri i Prokurimit.**

Titullari i autoritetit kontraktor., ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr.257/5 e prot., datë 22.10.2018 ku është përcaktuar : Fondi limit 15,086,273.16 lekë pa TVSH. Lloji i procedurës Marveshje Kuadër (e hapur) e është ngarkuar Njësia e Prokurimit për zbatimin e këtij urdhëri e përbër nga E.B., E. T.dhe A.P..

Me urdhërin nr.257/6 prot., datë 22.10.2018, është përcaktuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për prokurimin me objekt:*"Shërbim me roje private të SUSHN", KVO-ja S.Gj.(Kryetar), M. F. dhe H.D. antarë*

Njoftimi i kontrtës me shkresën nr. 257/7 datë 30.10.2018.

Pas njoftimit dhe publikimit me kërkes të APP procedura është pezulluar me urdhërin nr. 257/9 datë 02.11.2018 për përmirësim e DST.

-Me shkresën nr. 257/10 datë 05.11.2018 është miratuar shtojca për ndryshimin e DST.

Me shkresën nr. 257/11 datë 05.11.2018 është nxjerr urdhëri nga Titullari i Ak për heqjen nga Pezullimi.

-Me shkresën nr.257/12 datë 07.11.2018 SHPSF ñLe. Sec.ò Shpk kanë paraqitur ankesën për DT pranë AK,

Me urdhër nr.257/13, datë 08.11.2018 Titullari i AK ka pezulluar procedurën e prokurrimit, ka ngarkuar; z. S.Gj., znj.M. F. e znj.H.D. Komisioni për shqyrtimit të ankesës.

Me shkresën nr.257/14 datë 09.11.2018 SHPSF ñSTA.ò Shpk kanë paraqitur ankesën për DT pranë AK.

Me shkresën nr.257/15 datë 09.11.2018 SHPSF ñPl. Sec.ò Shpk kanë paraqitur ankesën për DT pranë AK.

Me urdhër nr.257/16, datë 09.11.2018 Titullari i AK ka pezulluar procedurën e prokurrimit, ka ngarkuar; z. S.Gj., znj.M. F. e znj.H.D. Komisioni për shqyrtimit të ankesës.

Me shkresën nr. 257/17 datë 12.11.2018 nga KSHA është hartuar procesverbali për shqyrtimin e ankesës.

Procedurë që ka vazhduar në ankimime të njëpasnjëshme deri në KPP e cila me vendimin nr. 113/2019 datë 01.03.2019

Me urdhërin nr.257/54, datë 06.03.2019 është hequr pezullimi i procedurës së prokurimit e në zbatim të LPP e VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñpër miratimin e rregullave të prokurimit publicò, të ndryshuar, në zbatim të vendimit të KPP nr. 113/2019,.

Raport përmbledhës për shqyrtim e miratim mbi proçedurën "Proçedurë e Hapur" me objekt ***"Shërbimi me Roje Private"*** *në SU "Shefqet Ndroqi" Tiranë - Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj. Fondi limit: Fondi i Marrveshjes Kuadër për 12 muaj - 15,086,273.16 (pesëmbëdhjetëmilion e tetëdhjetë e gjashtëmijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre.16) lekë pa TVSH me nr. REF-92069-10-30-2018 , të zhvilluar në datë 24.12.2018 në SU "Shefqet Ndoqi" Tiranë.*

Mbështetur në Rregullat e Prokurimit Publik, VKM nr.914 date 29.12.2014, Kreu VII, neni 68, po ju paraqesim raportin përmbledhës të këtij prokurimi.

Më datë 22.10.2018 janë nxjerrë Urdhëri Prokurimit me Nr. 257/5 Prot., Dhe Urdhëri i Veçantë Nr. 257/6 Prot. Dt.22.10.2018.

Anëtarët e Njësisë së Prokurimit E.B. ï Përgjegjëse e Zyrës Juridike dhe Prokurimeve, E. T. ï Juriste dhe A.P. ï Përgjëgjes e Zyrës Teknike në rolin e anëtareve të njësisë së prokurimit kanë plotësuar formularët e deklarimit që nuk janë në kushtet e konfliktit të interesit.

Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave Skender Gjoni ï Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, M. F. ï Anëtare i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe H. D. ï Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave kanë plotësuar formularët e deklarimit që nuk janë në kushtet e konfliktit të interesit.

Në datën 22.10.2018 në SUñ Shefqet Ndroqiñ u mblodh Njësia e Prokurimit, në zbatim të Urdhërit të Prokurimit nr.257/5 Prot., datë 22.10.2018, për proçedurën me objekt ***"Shërbimi me Roje Private" në SU "Shefqet Ndroqi" Tiranë - Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj. Fondi limit : Fondi i Marrveshjes Kuadër për 12 muaj - 15,086,273.16 (pesëmbëdhjetëmilion e tetëdhjetë e gjashtëmijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre.16) lekë pa TVSH***ò.

Njësia e Prokurimit hartoi dokumentat e tenderit në përputhje me dokumentat standarde të miratuara.

Mbështetur në Ligjin 9643 date 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò të ndryshuar dhe ne VKM 914 datë 29.12.2014 neni 39 pika 4, të gjithë anëtarët e Njësisë së Prokurimit firmosën dokumentet e tenderit në çdo fletë.

Në datën 31.12.2018, në Spitalin Universitar ñShefqet Ndroqiò në prezencë të KVO-së: S.Gj.-kryetar, H.D.-anëtare dhe M. F. -anëtar, me objekt prokurimi **Objekti: "Shërbimi me Roje Private" në SU "Shefqet Ndroqi" Tiranë - Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.**

Fondi limit: **Fondi i Marrveshjes Kuadër për 12 muaj - 15,086,273.16 (pesëmbëdhjetëmilion e tetëdhjetë e gjashtëmijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre.16) lekë pa TVSH.** REF-92069-10-30-2018

KVO u mblodh më datë 24.12.2018, ora 10:00 për të bërë hapjen e ofertave në sistemin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

Gjatë mbylljes së dorëzimit të Ofertave nga Njësia e Prokurimit, pas hap-shpalljes në Sistemin Elektronik, rezultoi se: Kishin marrë pjesë 10 (dhjetë) operatorë ekonomikë Ofertues.

Më pas u bë shqyrtimi i dokumenteve të secilit operator ekonomik të hedhur në sistemin Elektronik të APP-së. Në mënyrë unanime Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi: skualifikimin e të gjithë operatorëve ekonomikë ofertues.

Më poshtë gjendet argumentimi për secilin Operator Ekonomik.

1)OPERATORI EKONOMIK "TRE."

Ne DST ne Shtojcen 2 te dates 15.11.2018 eshte kerkuar

- Kapaciteti teknik shtohet si me poshte:

1. Operatori ekonomik duhet te kete tre grupe te gatshme 24h qe ti pergjigjen ketij sherbimi, ne rast bashkimi operatoresh , cdo operator ekonomik duhet te kete tre grupe te gatshme 24h. (Administrata do te ruhet me nje vendroje turn i pare dhe gjate dy turneve te tjera nepermjet sistemeve te alarmit . Farmacia nga dita e hene deri te premten pas orarit zyrtar te punes, si dhe ditet pushim dhe festa do ruhet me sistem alarmi).

Operatori ekonomik ne Vertetimin e performances leshuar Nga DPV Tirane me nr 270/243 prot date 07/12/2018 ka te deklaruar sherbime me grupe te gatshme vetem per turnet te dyte dhe te trete,pra nuk e plotesom kriteret e percaktuara ne Shtojcen 2 te dates 15.11.2018 per sherbim 24h me grupe te gatshme.

Argumentat e paraqitura perbejne shkak per skualifikimin e Operatoreve ekonomike ñTRE.ò.

2)OPERATORI EKONOMIK "NA."

1)- Ne DST ne Shtojcen 2 te dates 15.11.2018 eshte kerkuar

Kapaciteti teknik:

Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore.

Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 27 punonjës të siguruar në muaj, 27 punonjes sherbimi roje si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin.

Operatori Na. ka paraqitur liste pagesat te pa konfirmuara nga nga organet tatimore.

Ne nenin 46, pika 1, te Ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 ñPer prokurorimin publikò, i ndryshuar , parashikohet shprehimisht se: *"Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurorimit, duhet te kualifikohen , pasi te kene permbushur te gjitha kriteret qe autoriteti kontraktor i vlerson te nevojshme,per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohen dhe jodiskrimininuese".*

Ndersa ne nenin 53/3 te LPP-se percaktohen seò*Autoriteti kontraktor ne zbatim te pikes 4 te ketij neni , vlereson nje oferte te vlefshme , vetem nese ajo eshte ne peruthje me te gjitha kerkesat dhe specifikimete percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentat e tenderit…."*

*Bazuar ne vendimin e KPP te dates 24/04/2018 me nr vendimi 233/2018 ka vendosur qe liste pagesat (*formularët E-sig 025 a) *liste* pagesat duhet te jene konfirmuara nga organet tatimore sipas kerkesës së AK ne DST.

2)- Ne DST TEK <u>SPECIFIKIMET TEKNIKE eshte kerkuar:</u>

<u>Kërkesat për zbatimin e shërbimit</u>

Punonjësit e shërbimit të jenë të pajisur me uniformë të rregullt të miratuar nga Ministria e Brendshme, ku të jetë e reklamuar dhe stema e shoqërisë dhe të kenë dokumente që vërtetojnë identitetin e tyre

Rojet duhet të kenë në përdorim për realizimin e shërbimit të ruajtjes, radio komunikimi.

Rojet duhet të kenë leje arme.

Rojet e turnit të tretë të jenë te pajisur me armë

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur lejet e armeve (autorizimet) te kërkuar ne Dokumentet Standarde ,Specifikimet Teknike sipas shtojces 9, dhe te tek Termat e Referencës ku kërkohet;

Rojet duhet të kenë në përdorim për realizimin e shërbimit të ruajtjes, radio komunikimi.

- Rojet duhet të kenë leje arme.
- Rojet e turnit të tretë të jenë te pajisur me armë.
- Të jetë i pajisur me armë dhe ta përdorë atë në bazë të legjislacionit në fuqi.

3)Nuk ka paraqitur dëshmitë per operatore,pergjegjesa shërbimi dhe verifikues sinjal alarmi sipas Udhëzimit te Ministrit te Brendshëm 130 date 05.03.2018

Bazuar ne ligjin 75 ñPër funksionimin e shërbimit privat te sigurisë fizikeò , 2014 si dhe udhëzimit te Ministrit te brendshëm nr.130 date 05.03.2018 kreu V, Menaxhimi shërbimeve te SHPSF germa ñAò PIKA 11 shprehet se

Veprimtaria e SHPSF-se realizohet nëpërmjet organizimit me

a) Roje objekti për ruajtjen fizike

b) Truproje për ruajtjen e personave

c) Sisteme sinjalizuese elektronike per ruajtjen e objekteve

d) Punonjës shërbimi operatore ne qendrën e kontrollit

e) Punonjës shërbimi për verifikimin e sinjaleve elektronike për objektet qe janë te lidhura me sisteme elektronike

f) Përgjegjës shërbimi

g) Punonjës shërbimi (Shofer) për drejtimin e automjeteve

h) Punonjës shërbimi drejtimi

Ne nenin 46, pika 1, te Ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar , parashikohet shprehimisht seòOperatoret ekonomike , për te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen , pasi te kenë përmbushur te gjitha kriteret qe autoriteti kontraktor i vlerëson te nevojshme,për sa kohe qe ato janë ne përpjesëtim me natyrën dhe permasat e kontratës qe do te prokurohen dhe jodiskrimininueseò.

Ndërsa ne nenin 53/3 te LPP-se përcaktohen seò*Autoriteti kontraktor ne zbatim te pikës 4 te këtij neni , vlerëson një oferte te vlefshme , vetëm nëse ajo është ne përudhje me te gjitha kërkesat dhe specifikimete përcaktuara ne njoftimin e kontratës dhe ne dokumentet e tenderit…."*

Per rrjedhoje bazuar ne aktet ligjore te lartepermendura nje Operator ekonomik i SHPSF per ushtrimin e veprimtarisë se tije ne indicie te Udhëzimit nr. 130 date 05.03.2018 kreu V Menaxhimi shërbimeve te SHPSF germa ñAò pika 11 duhet detyrimisht te kete numrin e nevojshëm te dëshmive për pergjegjesa shërbimi, Operatore,Verifikues sinjal alarmi, e pare kjo ne raporte ne përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës qe do te prokurohen.

Argumentet e paraqitura përbejnë shkak për skualifikimin e Operatorit ekonomike NA. .

3) OPERATORI EKONOMIK "ISA ."

Nuk ka paraqitur Oferte ekonomike

Pa oferte. Është i skualifikuar automatikisht Operatori ekonomik INT.SEC.

4) OPERATORI EKONOMIK "EUR. SEC."

1)- **Kapaciteti teknik:**

Ne piken 3 te saj është kërkuar

Dokumenti i Performancës mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik (OE të mos ketë gjoba administrative apo proçedim penal për shkelje te rregullave te shërbimit gjate aktivitetit te tij si Shpsf, vërtetim ky i lëshuar brenda 6 muajve te fundit).

Ne vërtetimin e DPV Tirane qe ka paraqitur Operatori ka masa administrative

2)- **DST ne Shtojcen 2 te datës 15.11.2018 është kërkuar**

- Kapaciteti teknik shtohet si me poshtë:

Ne piken 2; Operatori ekonomik duhet te kete tre grupe te gatshme 24h qe ti përgjigjen këtij shërbimi, ne rast bashkimi operatoresh, çdo operator ekonomik duhet te kete tre grupe te gatshme 24h. (Administrata do te ruhet me një vendroje turn i pare dhe gjate dy turneve te tjera nëpërmjet sistemeve te alarmit . Farmacia nga dita e hënë deri te premten pas orarit zyrtar te punës, si dhe ditët pushim dhe festa do ruhet me sistem alarmi).

-Operatori ekonomik ne Vërtetimin e performances lëshuar Nga DPV Tirane me nr 722/218 prot date 07/12/2018 ka te deklaruar shërbime me grupe te gatshme vetem per turne te dyte dhe te trete,pra nuk e plotëson këtë kriteret e përcaktuara ne Shtojcen 2 te dates 15.11.2018 per sherbim 24h me grupe te gatshme.
-Ne Vërtetimin e Performances te DVP Tirane te lëshuar nga ky organ ne piken VI ka deklaruar se Shoqeria Euro Gjici nuk plotëson kriteret ligjore sipas kërkesave te nenit 18 pika 1germa dñ te ligjit nr.75/201 ,pasi numri i punonjësve te shërbimit te deklaruar ne maredhenie pune nuk përputhet me numrin e punonjësve me numrin e punonjësve sipas kontratave te nënshkruara nga subjektet shtetërore dhe private.
Performance e dobët
Argumentet e paraqitura përbejnë shkak per skualifikimin e Operatorit ekonomike EUR.SEC.
5) OPERATORI EKONOMIK "FLE."
Operatori ekonomik nuk paraqitur numrin e duhur te certifikatave te punonjesve ku jane kerkuar 27 certifikata . Operatori ka hedhur 19 certfikata ne direktorine e tij.
Nuk ka plotësuar oferten sipas shtojces 1 për një vendroje ne muaj.
Nuk ka hedhur vërtetimin e xhiros .
Nuk ka paraqitur vërtetimin e performances se DVP Tirane.
Nuk ka paraqitur vërtetimin e Organit Tatimor nese ka detyrime.
Nuk ka paraqitur Licensat e shoqerise.
Argumentet e paraqitura perbejne shkak per skualifikimin e Operatorit ekonomike FLE.SEC.
6)- OPERATORET EKONOMIK "TONI SECURITY"
1)- **Ne DST ne Shtojcen 2 te dates 15.11.2018 eshte kerkuar**
- Kapaciteti teknik shtohet si me poshtë: Ne piken 2. Operatori ekonomik duhet te kete tre grupe te gatshme 24h qe ti përgjigjen këtij shërbimi, ne rast bashkimi operatoresh , çdo operator ekonomik duhet te kete tre grupe te gatshme 24h. (Administrata do te ruhet me një vendroje turn i pare dhe gjate dy turneve te tjera nëpërmjet sistemeve te alarmit . Farmacia nga dita e hënë deri te premten pas orarit zyrtar te punës, si dhe ditët pushim dhe festa do ruhet me sistem alarmi).
Operatori ekonomik ne Vërtetimin e performances lëshuar Nga DPV Tirane me nr 239/221 prot date 20/11/2018 ka te deklaruar shërbime me grupe te gatshme vetëm për turnet te trete,pra nuk e plotëson këtë kriteret e përcaktuara ne Shtojcen 2 te datës 15.11.2018 per shërbim 24h me grupe te gatshme.
Operatori ekonomik ne Vërtetimin e performances e ka te deklaruar shërbime me grupe te gatshme vetëm për turn te dyte dhe te trete,pra nuk e plotëson këtë kriter.

Dhe kjo perben shkak per skualifikimin e operatorit òToni Securityò
7) -OPERATORI EKONOMIK "MY. SEC."
1)- Ne DST ne Shtojcen 2 te dates 15.11.2018 eshte kerkuar
- Kapaciteti teknik shtohet si me poshte:
Operatori ekonomik duhet te kete tre grupe te gatshme 24h qe ti pergjigjen ketij sherbimi, ne rast bashkimi operatoresh , cdo operator ekonomik duhet te kete tre grupe te gatshme 24h. (Administrata do te ruhet me nje vendroje turn i pare dhe gjate dy turneve te tjera nepermjet sistemeve te alarmit . Farmacia nga dita e hene deri te premten pas orarit zyrtar te punes, si dhe ditet pushim dhe festa do ruhet me sistem alarmi).
Operatori ekonomik ne Vertetimin e performances leshuar nga DPV Tirane me nr 441/166 prot date 07/12/2018 ka te deklaruar sherbime me grupe te gatshme vetem per turnet te dyte dhe te

trete,pra nuk e plotesom kete kriteret e percaktuara ne Shtojcen 2 te dates 15.11.2018 per sherbim 24h me grupe te gatshme.

Operatori ekonomik ne Vertetimin e performances e ka te deklaruar sherbime me grupe te gatshme vetem per turn te dyte dhe te trete,pra nuk e ploteson kete kriter.

Argumentat e paraqitura perbejne shkak per skualifikimin e Operatorit ekonomike MY. SEC. .

8) OPERATORI EKONOMIK "AR."

Nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për këtë proçedurë prokurimi.

- OPERATORI EKONOMIK "OK." KUALIFIKOHET

- OPERATORI EKONOMIK "LEK. SEC." KUALIFIKOHET

Në datë 03.01.2019 u realizua vlerësimi në Sistemin Elektonik të Agjensisë së Prokurimit Publik të proçedurës së mësipërm. Argumentimi mbi Operatorët Ekonomik është pasqyruar në Proces-verbal Nr.257/30 datë 31.12.2018.

Në datë 07.01.2019 në institucionin tonë paraqitet ankesa e operatorit ekonomik ñTo.-Sec.ò sh.p.k., të protokolluar këtu me 257/32 datë 07.01.2019 si dhe ankesa e operatorit ekonomik ñEu.-Securityò shpk të protokolluar këtu me 257/33 datë 07.01.2019.

Autoriteti Kontraktor pasi u njoh me ankesat e operatorëve ekonomikë nxorri Urdhërin e Brendshëm me 257/34 datë 09.01.2019. për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të përbërë nga A.P.-Anëtar, E. K. - Anëtare dhe A. M. - Anëtare.

Në datë 09.01.2019 në institucionin tonë paraqitet ankesa e operatorit ekonomik ñNa. 2000ò sh.p.s.f., të protokolluar këtu me 257/35 datë 09.01.2019 si dhe ankesa e operatorit ekonomik ñTr.ò sh.p.s.f., të protokolluar këtu me 257/36 datë 10.01.2019.

Autoriteti Kontraktor pasi u njoh me ankesat e operatorëve ekonomikë nxorri Urdhrin e Brendshëm me 257/37 datë 10.01.2019. për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të përbërë nga A.P.-Anëtar, E. K. - Anëtare dhe A. M. - Anëtare.

Autoritetit Kontraktor pasi u njoh me proçes-verbalin që relatoi Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave me Nr.257/38 në datë 17.01.2018, dhe Nr.257/39 në datë 17.01.2019 i dërgoi shkresë me Nr.257/40 prot., datë 21.01.2019 me lëndë: Kthim Përgjigje shoqërisë ñTo.-Sec.ò shpk. me shkresë me Nr.257/41 prot., datë 21.01.2019 , shoqërisë ñEu.-Securityò shpk, me shkresë me Nr.257/41 prot., datë 21.01.2019 , shoqërisë ñNa. 2000ò sh.p.s.f., shpk, me shkresë me Nr.257/42 prot., datë 21.01.2019, shoqërisë ñTr.ò sh.p.s.f, duke mos marrë parasysh ankesat e operatorëve ekonomik të lartpërmendur.

Në datë 25.01.2019 në institucionin tonë paraqitet ankesa e operatorit ekonomik ñNa. 2000ò sh.p.s.f të protokolluar këtu me 257/44 datë 25.01.2019, operatorit ekonomik ñTr.ò sh.p.s.f të protokolluar këtu me 257/45 datë 25.01.2019, operatorit ekonomik ñEu.-Securityò shpk të protokolluar këtu me 257/46 datë 25.01.2019 , operatorit ekonomik ñTo.-Sec.ò shpk të protokolluar këtu me 257/47 datë 25.01.2019 drejtuar KPP-së për dijeni SU ñShefqet Ndroqiò Tiranë.

Autoriteti Kontraktor pasi u njoh me ankesën e operatorëve ekonomikë drejtuar KPP-së nxorri Urdhërin e Brendshëm me Nr.257/48 prot., datë 28.01.2019 për vazhdimin e pezullimit të proçedurës.

Komisioni i Prokurimit Publik me anë të Vendim Nr.91/1 Protokolli datë 25.01.2019, të protokolluar në institucionin tonë me Nr.257/49 Prot., datë28.01.2019 vendos pezullimin e proçedurës së prokurimit dhe shqyrtimin në themel të saj.

Autoriteti Kontraktor pasi u njoh meVendim Nr.91/1 Protokolli datë 25.01.2019 nxorri Urdhërin e Brendshëm Nr.257/50 prot.,datë 30.01.2019 për pezullimin e proçedurës.

Autoriteti Kontraktor me anë të shkresës me nr.257/51 datë 01.02.2019 informoi Komisionin e Prokurimit Publik nëpërmjet dokumentacionit bashkëlidhur mbi zhvillimin e deritanishëm të proçedurës.

Në datë 07.02.2019 Autoriteti Ynë Kontraktor i dërgoi shkresë KPP-së dhe për dijeni APP-së për të shqyrtuar me përparësi proçedurën tonë të prokurimit.

Në datë 06.03.2019 Autoriteti Kontraktor u njoh me Vendim K.P.P. 113/2019 me anë të shkresës Nr.113/1 Prot., datë 01.03.2019 të protokolluar në institucionin tonë me nr.257/53 datë 06.03.2019.

Autoriteti Kontraktor pasi u njoh me Vendim K.P.P. 113/2019 nxorri Urdhërin e Brendshëm Nr.257/54 prot.,datë 06.03.2019 për zbatimin e këtij vendimi dhe heqjen nga pezullimi i proçedurës së prokurimit.

Autoriteti Kontraktor me anë të shkresës me nr.257/55 datë 15.03.2019 informoi Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin Vendim K.P.P. 113/2019 dhe mbi zhvillimin e deritanishëm të proçedurës.

Në datat 06.03.2019, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave realizoi vlerësimin individual në Sistemin Elektronik.

Në përfundim të vlerësimit individual nga secili nga tre anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, Komisioni autorizon Njësinë e Prokurimit të përfundojë vlerësimin e ofertave në sistemin elektronik.

Në datë 15.03.2019 u realizua njoftimi elektronik ne sistemin elektronik të APP-së për operatorët ekonomik të mëposhtëm:

- ñTr.ò sh.p.k;
- ñEu. Securityòsh.p.k;
- ñNa. 2000ò sh.p.k;
- ñLe. Sec.ò sh.p.k

Si rrjedhim, Autoriteti Kontraktor në datë 18.03.2019 zhvilloi shortin në Spitalin Universitar ñShefqet Ndroqiò, në prezencë të Komisionit të Vlerësimit të Ofetave me S. Gj. ï Kryetar, M. F. - Anëtare, dhe H.D.- Anëtare si dhe në prezencë të Njësisë së Prokurimit me anëtarë, E.B. ï Përgjegjëse e Zyrës Juridike dhe Prokurimeve,E. T. - Juriste dhe A.P.- Përgjegjës i Zyrës Teknike, me objekt prokurimi: ***"Shërbimi me Roje Private" në SU "Shefqet Ndroqi" Tiranë*** **-** Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj. Fondi limit: Fondi i Marrëveshjes Kuadër për 12 muaj - 15,086,273.16 (pesëmbëdhjetëmilion e tetëdhjetë e gjashtëmijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre.16) lekë pa TVSHò.

Në datën e caktuar u zhvillua shorti në prani të operatorëve ekonomikë që rezultuan me vlerë ekonomike të njëjtë në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të Vendim Vendim K.P.P. 113/2019 të Komisioni i Prokurimit Publik i cili përcakton si të kualifikuar Operatorët Ekonomikë të mëposhtëm:

ñEu.- Securityò me vlerë ekonomike 15,011,221.26 lekë pa tvsh,
ñTr.ò shpk me vlerë ekonomike 15,011,221.26 lekë pa tvsh,
ñLe. Sec.ò shpk me vlerë ekonomike 15,011,221.26 lekë pa tvsh,
ñNa. 2000ò shpk me vlerë ekonomike 15,011,221.26 lekë pa tvsh.

Në orën e caktuar në njoftimin e bërë në sistemin elektronik të APP-së, ku u njoftuan secili nga operatorët ekonomikë u paraqiten përfaqësuesit me autorizim të shoqërisë ñEu.- Securityñ sh.p.k znj. E. N. dhe z. A. S., përfaqësuesit me autorizim të shoqërisë ñNa. 2000ò shpk Z.P. A., administratori i shoqërisë ñTr.ò shpk z. A.T., si dhe administratori i shoqërisë ñLe. Sec.ò shpk z. A. L. në mbështetje të VKM-së Nr.914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit

publik Neni 66 pika 8, të cilët ishin të pranishëm në hedhjen e shortit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Të pranishëm ishin dhe Njësia e Prokurimit.
Komisioni, bazuar në VKM-në Nr.914 datë 29.12.2014 ñ Për miratimin e rregullave të prokurimit publikñ, procedoi me hedhjen e shortit. Nga hedhja e shortit rezultoi fitues operatorin ekonomik ñLe. Securityòshpk.
Në zbatim të LPP-së dhe të Vkm-së Nr.914 datë 29.12.2014 ñ Për miratimin e rregullave të prokurimit publikñ u mbajtën proces-verbalet përkatëse mbi prezencën e shoqërive dhe anëtarëve të komisionit si dhe mbi shpalljen e operatorit fitues të procedurës së prokurimit me objekt ñShërbim me roje privateñ
Për sa më sipër KVO me unanimitet vendosi :

- Të konsiderojë të kualifikuar operatorëve ekonomikë:

ñLe. Securityò shpk., me ofertën me vlerë ekonomike 15,011,221.26 lekë (pa tvsh).

- Të konsiderojë të skualifikuara shoqëritë:

ñTr.ò shpk me vlerë ekonomike 15,011,221.26 lekë pa tvsh
ñNa. 2000ò shpk me vlerë ekonomike 15,011,221.26 lekë pa tvsh
ñEu.- Securityò shpk me vlerë ekonomike 15,011,221.26 lekë pa tvsh.
Në përfundim të procedurës së hedhjes së shortit asnjë nga përfaqësuesit e shoqërive nuk patën ankesa.

- Fitues i shortit u shpall operatori ekonomik:

ñLe. Securityòshpk., me ofertën me vlerë ekonomike 15,011,221.26 lekë (pa tvsh).
Administratorët e **shoqërive** u njohën me vlerësimin e Komisionit, dhe nuk pati ankesa.

Nga tejzgjatja e procedurës marrëveshje kuadër AK është detyruar të kryej procedurëne prokurimit ñShërbim me roje privateñ negocim pa shpallje në bazë të kërkesës nr. 292 datë 29.10.2018 të përgjegjësit të sektorit teknik A.P..
Nga auditimi i vlerësimit të ofertave nga KVO e përbërë nga S.Gj., M. F. dhe H.D. u konstatua se. Në këtë procedurë morën pjesë 2 OE , Le. Security dhe Ke. (pa ofertë).
Nga aditimi i ofertës teknike të OE Le. Security u konstatua se: Në DST pika 2.1 Kapaciteti ligjorë i OE pika 3.
-Certifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 36 punonjës shërbimi të lëshuar nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë.
Nga auditimi i licencave të dërguara në ofertë nga OE Le. Security u konstatua se vetëm 32 punonjës janë me licenca aktive sipas ofertës se dorëzuar, nga 36 punonjës që kërkohen.
Gjithashtu nga auditimi në listë pagesa të këtyre punonjësve rezultoi se vetëm 35 prej tyre rezultojnë në listë pagesat e kompanisë dhe nga këto vetëm 16 veta rezultojnëme licenca aktive.
Praktikisht OE ka paraqitur Licenca punonjësish të cilat nuk janë nëlistë pagesat e OE për tu kualifikuar në këtë procedurë prokurimi dhe KVO i ka marrë të mirëqena.*(Aneksi nr.2)*

Titulli i gjetjes:	Kualifikim i gabuar nga ana e KVO
Situata:	Nga auditimi i vlerësimit të ofertave nga KVO u konstatua se: Në ofertën teknike të OE Le. Security , DST pika 2.1 Kapaciteti ligjor i OE pika 3. kërkohet; *-Certifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 36 punonjës shërbimi të lëshuar nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë.*

	Nga auditimi i licencave të dërguara në ofertë nga OE Le. Security u konstatua se vetëm 32 punonjës janë me licenca aktive sipas ofertës se dorëzuar, nga 36 punonjës që kërkohen. Gjithashtu nga auditimi në listë pagesa të këtyre punonjësve rezultoi se vetëm 35 prej tyre rezultojnë në listpagesat e kompanisë dhe nga këto vetëm 16 punonjës rezultojnëme licenca aktive. OE i kualifikuar nga kvo dhe shpallur fitues nga titullari i Ak, nuk plotëson kapacitetin ligjor ñpunonjës me licencaò, edhe pse me këtë devijim nga ana e KVO është kualifikuar.
Kriteri:	Situata është në kundërshtim me DST pika 2.1 Kapaciteti ligjor i OE pika 3. kërkohet; *Veprime në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar me. Neni 46 pika 1 dhe neni 58 i Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.*
Ndikimi:	Vlerësimin e OE i gabuar
Shkaku	Vlerësim subjektiv
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	KVO të marrë masa që në të ardhmen të kryej vlerësim sa më objektiv duke ruajtur paanshmërinë në procedurat që vlerësohen qofshin ato me ofertë më të ulët apo më të lartë, duke pasur në vëmendje plotësimin e të gjitha kritereve për kualifikimin e ofertuesve.

Nga auditmi i zbatimit të kontratës u konstatua se:

OE Le. Security ka paraqitur ofertën ekonomike me analizë kosto ku shprehet se për rojet me 3 turne kosto për një roje paraqitet me vlerën 48,793. 95 lekë nga ku 6,982.51 lekë sigurime shoqërore e shëndetsore pjesa takuese e OE 16.7%.

Nga verifikimi i librit të planizimit të shërbimeve dhe librave të ndërrimit të turneve asnjë nga punonjësit të shërbimit të cilët kanë kryer shërbime turne të 2 apo të 3 nuk është paguar sipas ofertës së OE Le. security. Por është paguar si punonjës shërbimi me 1 turn duke përfituar padrejtësisht pagën e punonjësve pasi për rojet me 1 turn detyrimi për sigurime shoqërore e shëndetësore 16.7* kap vlerën e 6,012 lek ndërsa për rojet me 3 turne ky detyrim është 6,982.51 lek ose 970.51 lek për roje në muaj ose 4,833.13 lek për vendroje x 7 = 33,831 lek në muaj shmangie nga detyrimi i pagimit të Sigurimeve shoqërore e shëndetësore për punonjësit me tre turne në muaj.

Nga verifikimi i listy pagesave punonjësit e ofrimit ty shërbimit ty rojeve ny SUSHN paguhen me 36,000 leky ny muaj pagy bazy pa py rfshiry shtesat e përcaktuara py r ky ty pozicion pune ku sipas ofertës dhe kontratës duhet ty paguheshin me 48,793.95 leky pagy ny muaj. Operatori ekonomik ñLe. Sec.ò ka përfituar padrejty sisht 5,811.44 lek për roje në muaj (sipas Ofertës së Le. security) x 4.98 vend roje = 28,941 lekë në muaj x 7 vend roje = 202,586.8 lekë përfitim i pa drejtë nga paga e rojeve që mban OE Le. security.

Nga verifikimi i kryerjes së shërbimit dhe pagesës sipas ofertës dhe kontratës së nënshkruar u konstatua se: asnjë nga punonjësit e shërbimit të cilët kanë kryer shërbim me turne të 2 apo të 3 nuk është paguar sipas kushteve të kontratës, por është paguar si punonjës shërbimi me 1 turn

duke përvetsuar padrejtësisht diferencën e shtesës mbi pagë të punonjësve që punojnë turne të dyta e të treta 5,811.44 lekë/roje/ muaj x 4.98 vend roje = 28,941 lekë/muaj x 7 vend roje = 202,586.8 lekë përfitim i pa drejtë nga paga e rojeve që mban OE Le. Gjithashtu nga ky përvetësim i pagës është shmangur dhe pagesa e detyrimit për sigurime shoqërore e shëndetsore 16.7% ose 970.51 lek/muaj për roje ose 4,833.13 lek për vendroje x 7 = 33,831 lek në muaj shmangie nga detyrimi i pagimit të Sigurimeve shoqërore e shëndetsore për punonjësit me tre turne në muaj. Në total ky përvetësim pagë + sigurime shoqërore e shëndetsore është 236,417 x 9muaj (kontratë) = 2,127,753 lekë.
Kjo vlerë sipas legjislacionit në fuqi DST së miratuar mbi të gjitha dhe ofertës së dërguar nga OE Le. security është vlerë që duhet të përfitoi punonjësi i shërbimit dhe jo OE Le. Security.
Ky është një fond i miratuar për paga e detyrime sig. Shoqërore e shëndetësore nga buxheti i shtetit ndërkohë që OE i ka ndryshuar destinacionin.

Titulli i gjetjes:	Shmangie nga detyrimi i pagimit të Sigurimeve shoqërore e shëndetësore për punonjësit
Situata:	Nga verifikimi i listy pagesave punonjësit e ofrimit ty shërbimit ty rojeve ny SUSHN paguhen me 36,000 leky ny muaj pagy bazy pa py rfshiry shtesat e përcaktuara py r ky ty pozicion pune ku sipas ofertës dhe kontratës duhet ty paguheshin me 48,793.95 leky pagy ny muaj. Operatori ekonomik ñLe. Sec.ò ka përfituar padrejty sisht 5,811.44 lek për roje në muaj (sipas Ofertës së Le. security) x 4.98 vend roje = 28,941 lekë në muaj x 7 vend roje = 202,586.8 lekë përfitim i pa drejtë nga paga e rojeve që mban OE Le. security. Nga verifikimi i kryerjes së shërbimit dhe pagesës sipas ofertës dhe kontratës së nënshkruar u konstatua se: asnjë nga punonjësit e shërbimit të cilët kanë kryer shërbim me turne të 2 apo të 3 nuk është paguar sipas kushteve të kontratës, por është paguar si punonjës shërbimi me 1 turn duke përvetsuar padrejtësisht diferencën e shtesës mbi pagë të punonjësve që punojnë turne të dyta e të treta 5,811.44 lekë/roje/ muaj x 4.98 vend roje = 28,941 lekë/muaj x 7 vend roje = 202,586.8 lekë përfitim i pa drejtë nga paga e rojeve që mban OE Le.. Gjithashtu nga ky përvetësim i pagës është shmangur dhe pagesa e detyrimit për sigurime shoqërore e shëndetsore 16.7% ose 970.51 lek/muaj për roje ose 4,833.13 lek për vendroje x 7 = 33,831 lek në muaj shmangie nga detyrimi i pagimit të Sigurimeve shoqërore e shëndetësore për punonjësit me tre turne në muaj. Në total ky përvetësim pagë + sigurime shoqërore e shëndetësore është 236,417 x 9muaj (kontratë) = 2,127,753 lekë.

Kriteri:	DST pika 2.1 Kapaciteti ligjor i OE pika 3. kërkohet; -Certifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 36 punonjës shërbimi të lëshuar nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë. Ligji i prokurimit publik nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, Neni 46 pika 1 dhe neni 58 i Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar.
Ndikimi:	Në të ardhurat e punonjësve
Shkaku	Përfitim i OE
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Të kërkohet nga Drejtoria e Tatim Taksave Tiranë informacion i plotë për këtë kontratë si dhe të kryhen sistemimet përkatëse të pagave të punonjësve, ty cily t kanë kryer shërbimin e rojeve sipas kushteve të kontratës. Të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative py r përvetësimin e padrejty ty pagës sipas kushteve ty ofertës sy tenderuar dhe kontratës sy kontraktuar mes operatorit ekonomik dhe SUSHN.

2.6. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj).

Për veprimet e kryera nëpërmjet arkës dhe bankës, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
Dokumentacioni i pagesave të bankës
Dokumentacioni i arkëtimeve, pagesave të arkës.
Dokumentacioni hyrjeve dhe daljeve të magazinës.
Dokumentacioni i mbajtur mbi marrjen në dorëzim të furnizimeve.
Dokumentacioni i mbajtur për blerjet me vlera të vogla
Dokumentacioni i mbajtur për shpenzimet për dieta brenda dhe jashtë vendit
Dokumentacioni për konsumin e karburantit
Dokumentacioni për sponsorizimet
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:
Dokumentacioni i bankës për periudhën objekt auditimi vazhdon të mbahet në mënyrë manuale(edhe pse është rekomanduar vazhdimisht përdorimi i sistemeve financiare), (ditar, partitar) çka e vështirëson nxjerrjen e raporteve për efekt krahasueshmërie, për rrjedhojë dhe auditimin e shumave përmbledhëse të shpenzimeve dhe ngarkimin e tyre në kontabilitet. Nga kryerja e disa sondazheve për shumat e kaluara nga thesari në total për paga shpenzime operative dhe *investime* me totalin e librit të bankës dhe arkës nuk rezultuan diferenca. Mbajtja e kontabilitetit me një nga programet e integruara, e përshtatshme për institucionet buxhetore, përbën domosdoshmëri, pasi i bën më të përshtatshme në kohë dhe cilësi mbajtjen e kontabilitetit dhe nxjerrjen e informacionit kontabël të saj në çdo kohë dhe llogari.
Nga auditimi i dokumentacioni të bankës është konstatuar fenomeni i pagesave të vonuara të furnitorëve të ndryshëm si më poshtë:

Nr	Objekti	Viti	NR prokurimeve	Fondi Limit	Vlera e kontratës
1	Prokurimet me vlerë të vogël	2018	63	19,988,316	21,060,872
2	Prokurimet me vlerë të vogël	2019	35	14,138,574	14,554,097
3	Prokurimet me vlerë të vogël	2020	22	9,523,563	10,195,660

Titulli i Gjetjes Vonesa në likuidimet e detyrimeve

Situata: Nga auditimi i urdhër shpenzimeve të kryera nga SUSHN, për periudhën 2019-2020, u konstatuan 20 procedura të likuiduara me vonesë nga 1 deri në 4 muaj. Pagesat e kryera me vonesë kanë rritur riskun e penaliteteve nga operatorët ekonomikë ndaj institucionit.

Kriteri: kontratat e lidhura me OE fitues, pika likuidimi i faturës.

Ndikimi/Efekti: Krijimi i riskut të maturimit të penaliteteve për mospagesat e faturave në afat.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Strukturat drejtuese të marrin të gjitha masat për të kryer likuidimet e detyrimeve kontraktore në afat, për të mos maturuar penalitete ndaj operatorëve ekonomikë.

-Blerjet me vlera të vogla

-Mbi auditimin e procedurës ñRimbushje fikse zjarri dhe kolaudimin e tyre në ñS.U. Shefqet Ndroqiò, Tiranë, viti 2020

Titulli i Gjetjes Parregullsi në procedurën ñRimbushje fikse zjarri dhe kolaudimin e tyre në ñSU Shefqet Ndroqiò, Tiranë 2020

Situata: Me shkresën nr. 85 Prot., datë 11.05.2020, përgjegjësi i sektorit teknik, A.P., i ka kërkuar n/drejtorit ekonomik S.Gj., inicimin e procedurës së rimbushjes së fikseve të zjarrit dhe kolaudimin e tyre.

Në kërkesat për tu plotësuar nga OE, është kërkuar se duhet të jetë i pajisur me Licencë QKL, kodi 1.2 A, për shërbim ekspertize, pika dhënia e asistencës teknike, si dhe të ketë ekspert privat zjarrfikës të pajisur me leje të lëshuar nga drejtoria MZSH në fushën e mësipërme. Në pikën 5, kërkohet se OE ofertues duhet të ketë në emër të shoqërisë ose me kontratë qiraje një auto-laborator për mbushjen dhe kolaudimin e fikseve në vend në prani të personit përgjegjës të ngarkuar nga AK. Auto laboratori duhet të jetë i pajisur me skedën teknike ku të përcaktohet qartë kryerja e shërbimit të kërkuar, thithja dhe shkarkimi i pluhurit ekzistues, prova e presionit hidraulik të enës së fikses së zjarrit, rimbushja dhe kolaudimi, pluhur dhe CO2. Skeda teknike të jetë e noterizuar dhe e përkthyer.

-Në ofertën e kërkuar janë dhe 120 copë F.V. bateri për sinjalizuesit e zjarrit dhe F.V. llampa LED me bateri 10 copë. Për këto mallra nuk janë paraqitur të dhënat specifike si amperazhi, kapaciteti, fuqia në W.

Komisioni i blerjeve me vlera të vogla, i përbërë nga E. K., L. Y. dhe A. I., pasi kreu testimin e tregut, me datë 20.05.2020, me shkresën nr. 85/4, i relatoi n/drejtorit ekonomik për përllogaritjen e fondit limit në vlerën 500,000 lekë pa tvsh.

Më datë 20.05.2020, titullari i AK, S.Gj., me shkresën nr. 85/5 datë 20.05.2020, ka urdhëruar zhvillimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël me fond limit 500,000 lekë, dhe me shkresën 85/6 është shpallur ftesa për ofertë.

-Kërkesat nga përgjegjësi teknik për licencën kodi 1.2 A, për shërbim ekspertize, pika dhënia e asistencës teknike si dhe ekspert privat zjarrfikës i pajisur me leje të lëshuar nga drejtoria e MZSH janë të paargumentuara dhe jo të justifikuara pasi objekti i punës së ekspertit është ñstudimi dhe përgatitja e projekteve mbi masat nga zjarri të ndërtesave të çdo llojiò., kur objekti i procedurës është rimbushja dhe kolaudimi i fikseve të zjarrit.

Kriteri: Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me pikat 5, 7 të Udhëzimit nr.3, datë 08.01.2018, i ndryshuar, ñ Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò, ku citohet: ñ5. Përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e referencës, përllogarit fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, në përputhje me nenin 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukture të posaçme. 7. Urdhri i prokurimit duhet të shoqërohet me ftesën për ofertë, që u drejtohet operatorëve ekonomikë, në të cilën përcaktohen të gjitha të dhënat e nevojshme që lidhen me objektin e prokurimit. a) Ftesa për ofertë, përgatitet nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, sipas formularit standard Nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi. b) Ftesa për ofertë përmban objektin e prokurimit, të dhënat teknike e sasiore të mallit/shërbimit/punës që prokurohet, grafikun e lëvrimit/ekzekutimit të mallit/shërbimit/punës objekt prokurimi, afatin e paraqitjes si dhe dokumentet që duhet të dorëzojë operatori ekonomik i shpallur fitues, nëse është rasti. Në raste specifike, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, në varësi të llojit të objektit të prokurimit, mund të kërkojë plotësimin e një ose disa kritereve të veçanta, duke përcaktuar në ftesën për ofertë dokumentacionin përkatës provues.ò

Ndikimi/Efekti: Shtimi i kërkesave jo të argumentuara dhe jo të nevojshme kufizon numrin e pjesëmarrësve

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Strukturat drejtuese të marrin masa për trajnimin e punonjësve lidhur me procedurat e prokurimit për aftësimin e tyre dhe realizimin me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm.

Meqenëse OE të tjerë të shpallur fitues, nuk janë paraqitur, komisioni ka kualifikuar OE Vic. -Al shpk, me vlerë të ofertuar 479,000 lekë, pa tvsh.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e komisionit të blerjeve me vlera të vogla dhe përgjegjësi i sektorit teknik, A.P..

-Mbi auditimin e procedurës "Evadimi i mbetjeve urbane në S.U. "Shefqet Ndroqi", Tiranë, 2019

Titulli i Gjetjes	Parregullsi në procedurën ñEvadimi i mbetjeve urbane ne S.U. ñShefqet Ndroqiò, Tiranëò, 2019
Situata:	Me shkresën nr. 21. Prot., datë 16.01.2019, AK ka iniciuar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, 778,764 lekë pa tvsh, me objekt ñEvadimi i mbetjeve urbane ne S.U. ñShefqet Ndroqiò, Tiranëò. Në kërkesat e hartuara nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla, i përbërë nga E.B., E. K. dhe A. I., janë kërkuar licencë nga QKB, III 2. B., dhe licencë III. 2. A., në përputhje me ligjin nr. 10 463, datë 22.09.2011, ñPër menaxhimin e integruar të mbetjeveò, i ndryshuar. Në ligjin e sipërcituar, kreu iv menaxhimi i integruar i mbetjeve, neni 21, Përgjegjësia për menaxhimin e integruar të mbetjeve, citohet: ñ pika 1. Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve e kryen trajtimin e tyre vetë ose përmes një tregtari a personi tjetër që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 448 ,datë 14.7.2011 ñPër lejet e mjedisitò. 2. Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve, që transferon mbetjet te një tregtar ose person që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, nuk çlirohet nga përgjegjësia për operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit të tyre. -Në kërkesat e OE pjesëmarrësit në procedurë, duhet që me ofertën ekonomike, të paraqisnin dhe opsioni/opsionet se ku shkojnë mbetjet, shoqëruar me kontrata, lejet, dokumentet përkatëse që vërtetojnë plotësimin e tyre.
Kriteri:	Në VKM Nr. 229, datë 23. 04. 2014 ñPër miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshmeò, citohet: ñ 1. Ky vendim përcakton rregullat për transferimin në mënyrë profesionale të mbetjeve jo të rrezikshme nga një person tek një tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe formatin e Dokumentit të Transferimit të Mbetjeve jo të Rrezikshme. Të gjithë termat e përdorur në këtë vendim kanë kuptimin e dhënë nga ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 ñPër Menaxhimin e Integruar të Mbetjeveò, i ndryshuar. Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme bëhet sipas formatit për òDokumentin e Transferimit të Mbetjeve jo të Rrezikshmeò të përcaktuar në Aneksin 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Dokumenti i Transferimit të Mbetjeve jo të Rrezikshme plotësohet

	për të gjithë hallkat që ndjek transferimi i mbetjeve që nga krijimi deri në destinacionin përfundimtar. Dokumenti i transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme plotësohet dhe nënshkruhet nga krijuesi i mbetjeve, grumbulluesi, transportuesi dhe pritësi që merr në dorëzim mbetjet, sipas aneksit 1 bashkëlidhur, në aq kopje sa janë personat që nënshkruajnë Dokumentin. Transporti i mbetjeve jo të rrezikshme bëhet në bazë të kontratës midis palëve, në të cilën përcaktohet detyrimisht përgjegjësia për rastin e kthimit mbrapsht pjesërisht ose plotësisht të mbetjeve nga pritësi duke plotësuar seksionin C të aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Në seksionin C, të aneksit 1, të VKM Nr. 229, datë 23. 04. 2014 ñPër miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshmeò, në seksionin d, që plotësohet nga pritësi, është pjesa se ku shkojnë mbetjet, a. Për rikuperim, b. Landfill, c., incenerim, d., operacione të tjera asgjësimi.
Ndikimi/Efekti:	Mos përcaktimi i saktë i pjesës se ku shkojnë mbetjet mund të krijojë penalitete dhe për SUSHN
Shkaku:	Mos vlerësim sa dhe si duhet nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Strukturat drejtuese të marrin masa për trajnimin e punonjësve lidhur me procedurat e prokurimit për aftësimin e tyre dhe realizimin me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e komisionit të blerjeve me vlera të vogla.

Titulli i Gjetjes	Parregullsi në procedurën ñSigurimi i godinës së Spitalit Universitar ñShefqet Ndroqiò, në tërësi (shërbim mbrojtje kundër zjarrit).ò
Situata:	Me shkresën nr. 112/1 Prot., datë 08.04.2019, është iniciuar procedura e prokurimit me vlerë 800,000 lekë pa tvsh, me objekt: ñSigurimi i godinës së Spitalit Universitar ñShefqet Ndroqiò, në tërësi (shërbim mbrojtje kundër zjarrit). Në përgatitjen e kërkesave të kërkuara nga OE, nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla, i përbërë nga E.B., E. K. dhe A. I., u konstatua se: -Nuk është kërkuar që ofertuesi duhet të ketë kontratë ri-sigurimi për periudhën kohore në të cilën ofertuesi merr përsipër sigurimin e dëmit që kërkohet në këtë procedurë prokurimi. -Hartimi i termave të referencës është bërë në mënyrë të përgjithshme, nuk janë përcaktuar detajet apo karakteristikat për objektet e ndërtimit dhe konstruksionet të shoqëruara me foto, skica apo planimetri, gjendjen teknike të tyre, gjithashtu nuk janë përcaktuar karakteristikat për artikuj të përfshirë në llogarinë 214-Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla puna dhe llogarinë 218

	inventarin ekonomik. Mangësitë në hartimin e termave të referencës, e bëjnë të paargumentuar hartimin e fondit limit dhe për pasojë ofertimin e marrë nga operatorë të tregut.
Kriteri:	Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò e ndryshuar, neni 59- Përllogaritja e vlerës limit të kontratës, Neni 61-Hartimi i dokumenteve të tenderit, Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, ñPër prokurimin publikò i ndryshuarò.
Ndikimi/Efekti:	Mos përcaktimi i termave të referencës në mënyrë të detajuar e bën të vështirë, në rast se sigurimi do duhet të rimbursohet.
Shkaku:	Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Strukturat drejtuese të marrin masa për trajnimin e punonjësve lidhur me procedurat e prokurimit për aftësimin e tyre dhe realizimin me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 22/44 Prot,, datë 24.09.2021 ñMbi Projektraportin e Auditimitò nga L. Y., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

<u>Pretendimi i subjektit:</u>*Observacion për blerjet me vlera të vogla, në faqen nr.87, konkretisht. blerjes me objekt "Rimbushje fikse zjarri dhe kolaudimi i tyre ne SUSHN". ne ketë konstatim citohet: " ...*
Në oferten e kërkuar janë dhe 120 copë F. v bateri për sinjalizuesit e zjarrit dhe f v llampa led me bateri 10 copë. Për këto mallra nuk janë paraqitur të dhenat specifike si amperazhi, kapaciteti, fuqi ne W .... "
Ashtu sikurse jemi shprehur edhe verbalisht pranë grupit auditues, lidhur me percaktimet specifike të këtyre baterive kemi thënë: "....bateritë në këtë objekt prokurimi janë të lidhura me shërbimin që do të kryhet pra rimbushje fikese zjarri dhe kolaudimi i tyre në SUSHN. Si të tilla këto mallra që do të blihen janë të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit për këtë blerje... " Të dhenat specifike lidhen me këtë shërbim dhe për kutitë e tavaneve të sinjalizueseve të këtij shërbimi për dhënie alarmi, janë standart dhe operatoret ekonomike që kanë objekt të veprimtarisë së tyre këtë shërbim, kanë njohuritë e nevojshme për të ofertuar cmimin e duhur dhe për të realizuar me sukses këtë prokurim.
-Referuar paragrafit të fundit te faqes 88, kerkesat nga përgjegjësi teknik për licensen kodi 1.2.A., për shërbim ekspertize, pika dhënia e asistencës teknike si dhe ekspert privat zjarrefikes i pajisur me leje të lëshuar nga drejtoria e MZSH janë të paargumentuara dhe jo të jusitifkuara pasi objekti i punës së eksperitit është "studimi dhe përgatitja e projekteve mbi masat nga zjarri të ndërtesave të cdo lloji", kur objekti i procedurës është rimbushja dhe kolaudimi i fikeseve te zjarrit.
Përsa i përket këtij kriteri është vendosur në bazë të vetë objektit të prokurimit që po kryhet dhe specifikimeve teknike të tij, referuar edhe nenit 46/a & b te LPP Nr. 9643/2018.
N. 46, Kualifikimi i ofertuesve
1. Operatoret ekonomike, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të

nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesetim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:
a) kualifikimi profesional: i cdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shteterore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do te lidhet kontrata,
b) aftesia teknike: operatoret ekonomike vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, per te zbatuar kontraten, si është pershkruar nga autoriteti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates;
Sipas kërkesave të këtij kriteri "Licensën kodi 1.2.A., për shërbim ekspertize, pika dhënia e asistences teknike si dhe ekspert privat zjarrëfikës i pajisur me leje të lëshuar nga drejtoria e MZSH', është për të siguruar A.K lidhur me cilesinë dhe përgjegjshmërinë e Operatorit Ekonomik, për sa i përket objektit te blerjes që po prokurohet, dhe sigurimit teknik lidhur me rreziqet profesionale të tij.
Referuar nenit 28/ 5 te VKM-se Nr. 914/ 2014:
Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kerkon:
a) licencat profesionale per realizimln e sherbimeve, objekt i kontrates, te licesuara nga autoritetet kompetente shteterore; dhe /ose
b) një listë të personelit kryesor, të nevojshem per te zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose, komponentet e saj. Lista e personelit kryesor duhet te perfshije CV-te e tyre dhe licencat profesionale, kur kane te tilla; dhe/ose
c) dëshmi per fuqine punetore te operatorit ekonomik te nevojshem per ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
e) dëshmi per mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo qe mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten.
Pra, lidhur me licensen 1.2.A, te kerkuar, për sherbim ekspertize, kerkesa per dhenie asistence teknike nga nje ekspert privat zjarrefikes, komisioni i prokurimit me vlere te vogel, ne varesi te llojit te objektit te prokurimit, mund të kërkoje plotësimin e një ose disa kritereve te vecanta, duke përcaktuar në ftesen për ofertë dokumentacionin përkates provues, për pikë dhënien e asistences teknike, të statit teknik si dhe udhezimet perkatese te veprimit ne rast se ne institucion do të kemi të bëjme me një rast zjarri.
Këto kërkesa jane të vlerësuara së pari nga Përgjegjësi i Sek. Teknik A.P., si të nevojshme dhe janë lënë në ftesën për ofertë të publikuar në faqen zyrtare të APP-së për vetë rëndësinë që institucioni yne ka. Ne jemi një institucion publik spitalor në të cilin dhënia e shërbimit për pacientin e hospitalizuar është shumë e rëndësishme dhe kryefjalë.
Linjat e gazrave mjekësore dhe oksigienit mjekësor jane të ndërtuara në të gjithë tërësinë e Institucionit spitalor si të tilla kërkojnë kuides dhe vëmendje të shtuar.
Duke vleresuar këo komisioni i blerjeve të vogla ka realizuar prokurimin dhe ka shpallur një operator të suksesshem i cili ka realizuar me sukses shërbimin e kerkuar.
Sa me lart, citimi i grupit të punës së KLSH-së, në të cilën thuhet: " .... objekti i punes se ekspertit është "studimi dhe pergatitia e proiekteve mbi masat nga ziarri te ndertesave te cdo lloii" .... Në gjykimin tonë, është mëse i nevojshem për Institucionin tonë Spitalor, në të cilin është kryer prokurimi.
<u>Qëndrimi i Grupit të auditimit:</u>*Lidhur me pretendimin për kërkesat specifike jo të argumentuara, nuk janë sjellë dokumente ose argumente shtesë nga intervistat e punës në subjekt,*

prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit. Përsa sa i përket domosdoshmërisë së trajnimit për rastet e rënies së zjarrit, është në kompetencat dhe detyrimet e Institucionit për shqyrtimin e rrisqeve për rastet e mësipërme si dhe marrjen e masave parandaluese përkatëse. Por pasja e licencës e OE i cili do të mbushë fikset e zjarrit nuk siguron se stafi është trajnuar për rreziqet dhe masat parandaluese të gazrave të oksigjenit. Komenti nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

2.7.Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore.

Të ardhurat e realizuara nga veprimtaria e spitaleve janë klasifikuar nga Ministria e Financave në zbatim të udhëzimeve të zbatimit të buxhetit si të ardhura jashtë limitit me të drejtë përdorimi edhe pas mbarimit të vitit buxhetor përkatës. Mënyra e përdorimit të këtyre të ardhurave është e përcaktuar në udhëzimin e FSDKSH nr.2, datë 11.02.2014 ñPër përdorimin e të ardhurave që realizojnë Spitalet nga veprimtaria e tyre dhe nga dhurimetò.
Për zbatimin e dispozitave ligjore, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
-Dokumentacioni mbi pasqyrimin dhe evidentimin e të ardhurave.
-Korrespodenca me Ministrinë për miratimin e përdorimit të të ardhurave e rakordimi me thesarin.
-Dokumentacioni mbi respektimin e % së përdorimit sipas klasifikimit të udhëzimit FSDKSH.
Të ardhurat që realizojnë spitalet nga veprimtaria e tyre, janë:
a)Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve që u kryhen pacientëve, të cilët nuk kanë rekomandimin e mjekut të përgjithshëm dhe të familjes, si tarifa për vizita, analiza dhe ekzaminime të ndryshme.
b)Të ardhurat nga veprimtaria ekonomike,si qiratë, parkingu i automjeteve në territorin e spitalit, shërbime kancelarie, shtypshkrime të ndryshme,etj.
c) Të ardhurat e krijuara nga dhurimet në vlerë materiale e monetare.
Spitali Universitar Shefqet Ndroqi (SUSHN) realizon të ardhura nga veprimtaria e tij kryesore.
Për periudhën objekt auditimi, SUSHN, ka realizuar të ardhura nga qiratë, parkimi si dhe kryerja e ekzaminimeve të ndryshme, të cilat për 3 vitet paraqiten si më poshtë:

në lekë

Të ardhurat dytësore	***Viti 2018***	***Viti 2019***	***Viti 2020***
Të trashëguara nga viti i mëparshëm pa përdorur.	***1,223,493***	***7,958,867***	***4,722,806***
Të ardhura nga shërbimet spitalore	*6,947,050*	*6,487,000*	*1,437,450*
Të ardhura nga qiratë	*534,830*	*389,138*	*547,372*
Të ardhura nga parkingu	*8,786,700*	*14,320,400*	*4,463,900*
Shuma vetëm për vitin përkatës	***16,268,580***	***21,196,538***	***6,448,722***
Shuma gjithsej në fund viti	***17,492,073***	***29,155,405***	***11,171,528***

Burimi: Të dhëna të marra nga evidenca e rakorduar me degën e thesarit

Referuar tabelës së më sipërme rezulton se të ardhurat nga shërbimet spitalore për vitin 2019, krahasuar me vitin 2018, janë në nivele të qëndrueshme, të ardhurat nga qiratë janë ulur në shumën 145,692 dhe të ardhurat nga parkimi janë rritur në shumën 5,533,700 lekë. Gjatë vitit 2020,krahasuar me 2019, të ardhurat nga shërbimet spitalore janë pakësuar ndjeshëm me

5,049,550 lekë, si rezultat i shtimit të shërbimeve falas, situata e krijuar nga pandemia covid-19 dhe kalimi i SUSHN në spital COVID,të ardhurat nga qiratë janë rritur me 158,234 lekë si rezultat i nënshkrimit të kontratës dhe arkëtimit menjëhershëm të qirasë dhe të ardhurat nga parkimi janë ulur me 9,856,500 lekë, si rezultat i pezullimit të hyrjes së mjeteve dhe vizitorëve nga situata e krijuar nga pandemia.
Të ardhurat në total për vitin 2019, krahasuar me 2018, janë rritur në shumën 4,927,958 lekë, ose në masën 30%. Për vitin 2020, krahasuar me 2019, të ardhurat janë ulur në shumën 14,747,816 lekë, ose në masën 70%. Niveli i ulët i të ardhurave për vitin 2020, pasqyron faktorin kryesor që ka ndikuar gjatë këtij viti, pandemia covid -19.
Udhëzimi nr.2, datë 11.02.2014, i FSDKSH, përcakton edhe % e përdorimit të të ardhurave për Spitalet Universitare, Spitalet Rajonale dhe Spitalet Bashkiake.
Përdorimi i të ardhurave, për Spitalet Universitare, referuar përqindjeve të përcaktuara në udhëzim është i paraqitur si më poshtë:

në lekë

Përdorimi i të ardhurave dytësore	Çelur për 2018	Përdorur në 2018	Çelur për 2019	Përdorur në 2019	Çelur për 2020	Përdorur në 2020
Për investime	12,201,430	7,252,440	15,897,404	20,948,800	4,668,417	5,417,600
Mallra						27,406
Për paga	4,067,150	2,280,766	5,299,134	3,483,799	1,780,305	4,976,376
a. Përdorur gjatë vitit ushtrimor		**9,533,206**		**24,432,599**		**10,421,382**
b. Mbetur pa përdorur të ardhura të çelura	1223493	7,958,867	7,958,867	4,722,806	4,722,806	750,146
c. Të ardhura të realizuara dhe të paçelura	0	0	0	0	0	0
Të ardhura të trashëguara në vitin 2018	1,223,493		7,958,867		4,722,806	750,146
Çelur gjithsej të ardhura	**16,268,580**		**21,196,538**		**6,448,722**	

Burimi: Të dhëna të marra nga evidenca e rakorduar me degën e thesarit

Siç shihet dhe nga tabela e mësipërme, për vitin 2018 të ardhurat dytësore janë përdorur në vlerën 9,533,206 lekë, ndërsa pjesa e papërdorur në vlerën 7,958,867 lekë, është mbartur në vitin 2019. Për vitin 2019, të ardhurat dytësore janë përdorur në vlerën 24,432,599 lekë, ndërsa pjesa e papërdorur në vlerën 4,722,806lekë, është mbartur në vitin 2020. Për vitin 2020, të ardhurat dytësore janë përdorur në vlerën 10,421,382 lekë, ndërsa pjesa e papërdorur në vlerën 750,146 lekë, është mbartur në vitin 2021.
Përdorimi i të ardhurave dytësore për vitet 2018, 2019 dhe 2020, është kryer duke respektuar përqindjet e përcaktuara në Udhëzimin e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor nr. 2, datë 11.02.2014 ñPër përdorimin e të ardhurave që realizojnë Spitalet nga veprimtaria e tyre dhe nga dhurimetò, pika 4.1, e cila përcakton se përdorimi për Spitalet Universitare do jetë në masën 75% për investime e shërbime dhe në masën 25% për mbulimin e kostos së shërbimit të pagesave të punonjësve me kontratë shërbimi dhe pagesave për anëtarët e komisioneve teknike të hartimit të paketave të shërbimit.
Çelja e të ardhurave për përdorim, është realizuar sipas shkresave të autorizuara nga SUSHN, miratuar nga thesari mbas krijimit të të ardhurave përkatëse, ku për çdo fond të autorizuar janë përcaktuar përqindjet e përdorimit për lloj shpenzimi si ñpagaò, ñshpenzime operativeò, apo ñinvestimeò. Përqindja e përcaktuar në autorizim rezultoi të jetë sipas përcaktimeve të udhëzimit të FSDKSH nr. 2, datë 11.02.2014.

Veprimet e mësipërme janë në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra nëUdhëzimin nr. 2, datë 11.02.2014, të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor ñPër përdorimin e të ardhurave që realizojnë Spitalet nga veprimtaria e tyre dhe nga dhurimetò.

2.8. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, informimi, komunikimi dhe monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Për zbatimin e ligjshmërisë në funksionimin e sistemeve të kontrollit, u shqyrtua dokumentacioni dhe u konstatua, si më poshtë:

- Mjedisi i kontrollit.

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm.

-Vendosja e objektivave.

Njësia e SUSHN, nuk ka hartuar plan strategjik për periudhën 201-2020, i cili të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, por si njësi e varësisë së Ministrisë së Shëndetësisë zbaton disa strategji sektoriale të hartuara dhe miratuara nga MSH, siç është, strategjia e shëndetit publik, etj apo nga Ministria e Arsimit.

Veprimet janë në kundërshtim me kapitullin III të ñManualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, miratuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr. 54, datë 15.07.2010 si dhe me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011 ñPër cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin e mëparshëm buxhetorò.

-Etika personale dhe profesionale.

Nëpunësit e njësisë duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 ñKodi i Punësò, i ndryshuar, dhe Spitali Universitar ñShefqet Ndroqiò në respektim të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, neni 20 ñMjedisi i kontrollitò, pika 2, germa a) dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 ñMjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)ò, paragrafi ñIntegriteti dhe vlerat etikeò.

Spitali ka një Kod Etik të miratuar me nr. 211 prot., datë 09.02.2016 i ndarë në disa kapituj ku përmendim Rregullat e Etikës për stafin e administratës, Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore (Mjekët), Kodi etik-deontologjik i profesioneve infermier/e, mami, fizioterapist/e, teknik/e laboratori, teknik/e imazherie, logopedist/e.

Të gjitha nën-ndarjet e kodit etik mbështeten në kërkesat e Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999 ñPër Kodin e Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisëò, Ligjit Nr. 8615, datë 01.06.2000 ñPër Urdhrin e Mjekutò, Ligjit Nr. 9718, datë 19.04.2007 ñPër Urdhrin e Infermierit në Republikën e Shqipërisëò, Ligjit nr. 8615, datë 01.06.2000 ñPër Urdhrin e Mjekutò, si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që rregullon sistemin shëndetësor. Rregullorja e brendshme monitoron pajtueshmërinë e punonjësve me legjislacionin për etikën personale dhe profesionale ndërsa relacionet e ndryshme të paraqitura nga zyra juridike raportojnë për shkelje të ligjit të etikës.

-Menaxhimi i riskut.

Menaxhimi i riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut.

Pas planifikimit të fondeve buxhetore institucionit analizon dhe bën kontrollin e risqeve hap pas hapi të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore dhe institucioni nuk ka

hartuar strategjinë e riskut dhe nuk jep informacion për të në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.2 ñMenaxhimi i riskutò dhe në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò.
Drejtimi i SUSHN ka kryer disa trajnime në lidhje me shmangien e riskut të procedurave të prokurimeve ose për legjislacionin shëndetësor dhe menaxhim të pajisjeve mjekësore.
Menaxhimi i riskut kryhet nëpërmjet takimeve të vazhdueshme mes drejtuesve të të gjitha niveleve por nuk raportohen me shkrim as risqet kryesore të evidentuara dhe as masat e marra për kontrollin, reduktimin apo eliminimin e tyre.
-Aktivitetet e kontrollit.
Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave.
Proceset kryesore të punës janë të shkruara në strukturën organike dhe në rregulloren e brendshme. Në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave. Gjithashtu proceset e punës janë të përshkruara në planet e punës të secilit sektor.
Nëpunësi autorizues në bazë të ligjit për buxhetin merr përsipër angazhimet për realizimin e programit buxhetor. Transaksionet financiare kryen në bazë të rregullave të vendosura nga Ministria e Financave dhe për çdo transaksion zbatohet rregulli i firmës së dyfishtë. Edhe pse ka dokumente që verifikojnë proceset kryesore operacionale dhe financiare, nuk ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemeve IT apo sistem rezervë.
-Informimi e komunikimi.
Informimi është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen me cilësi të detyrave të ngarkuara dhe i duhet komunikuar titullarit dhe nëpunësve të tjerë në formën dhe kohën e duhur për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësive. Menaxherët e njësisë nuk zotërojnë informacion të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit pasi, ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk ka funksionuar në të gjitha hallkat e njësisë dhe se njohuritë janë të kufizuara. Titullari informohet nga shefat e shërbimeve me anë të mbledhjeve, relacioneve dhe raporteve të ndryshme.
Drejtoria e Financës, raporton tek nëpunësi autorizues me anë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin, por nuk ka raporte të monitorimit çdo 3-muaj. Nëpërmjet raportimit tek eprori i drejtpërdrejtë, sigurohet dhe komunikimi mbi parregullsitë dhe problemet e mundshme por, njësia nuk ka hartuar një procedurë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe analizën e tyre. Kjo procedure kryhet nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Cilësisë dhe e Akreditimit por nuk janë hartuar raporte për gabime të identifikuara.
-Monitorimi.
Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur.
Si konkluzion nga më lart rezulton se, menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm në Spitali Universitar ñShefqet Ndroqiò ka funksionuar vetëm në disa hallka të njësisë dhe për pasojë, drejtimi nuk ka mundur të bëjë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Për veprimet e mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z.P. K., në cilësinë e NA, dhe n/drejtori ekonomik S.Gj. në cilësinë e NZ, auditit të brendshëm si dhe grupit të menaxhimit strategjik.

Titulli i Gjetjes Mangësi në zbatimin e aspekteve të Menaxhimit Financiar dhe

kontrollit.

Situata: Njësia e SUSHN, nuk ka hartuar plan strategjik për periudhat 2019-2020, i cili të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, por si njësi e varësisë së Ministrisë së Shëndetësisë zbaton disa strategji sektoriale të hartuara dhe miratuara nga MSHMS dhe Ministria e Arsimit.

-Në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 28, datë 15.12.2011 ñMbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publikeò, nuk është hartuar dhe dërguar në ministri deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Për periudhën 2018-2020, SUSHN nuk ka plotësuar dhe dërguar në Ministri pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK.

Kriteri: -Veprimet janë në kundërshtim me kapitullin III të ñManualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, miratuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr. 54, datë 15.07.2010 si dhe me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011 ñPër cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin e mëparshëm buxhetorò.

-Mungesa e raportimit është në kundërshtim me Ligjin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit Nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, neni 18, i cili citon: 1. Nëpunësi autorizues i njësisë publike, sipas pikës 1 të nenit 3 të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitë e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji. 2. Nëpunësi i parë autorizues përgatit dhe depoziton te Ministri i Financave raportin vjetor të konsoliduar jo më vonë se fundi i muajit maj, duke u mbështetur në raportet, sipas pikës 1 të këtij neni, për kontrollin e brendshëm të sektorit publik. Ky raport është përmbledhje e raporteve vjetore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e auditimin e brendshëm në sektorin publik.

Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, Kreu II, neni 8 ñPërgjegjshmëria menaxheriale e titullaritò, pika 8. b, SUSHN nuk ka miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), në kundërshtim me nenin 27 të ligjit i cili citon:

Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë publike. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashtrohen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave

Grupi për menaxhimin strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendës titullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë. Kreu i auditimit të brendshëm merr pjesë në mbledhjet e grupit për menaxhimin strategjik pa të drejtë vendimmarrjeje.
Ligji i MFK dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kap V ñShtojcatò, Shtojca 2ï Pyetësori i vetë-vlerësimit për komponentët e MFK-së.
Në kundërshtim me ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, Kreu II, neni 8 ñPërgjegjshmëria menaxheriale e titullaritò, pika 8. b, Spitali nuk ka miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) me ndryshimet përkatëse për periudhën 2019-2020, në kundërshtim me nenin 27 të ligjit.

Ndikimi/Efekti: Mos plotësimi i hallkave sa më sipër rrit riskun e mos vlerësimit e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandime: Strukturat drejtuese të marrin masa për hartimin e sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi si pjesë e rëndësishme e realizimit të objektivave kryesore.

Titulli i Gjetjes Mos zbatimi i rregullave të përcaktuara në kontratën koncesionare me SaniServise, nga SUSHN.

Situata: Në procesin e monitorimit të kontratave të SUSHN me FSDKSH, për ñFinancimin e shërbimeve spitaloreò, u konstatua mos realizimi i detyrimeve të spitalit në lidhje me kontratën konçesionare Saniservice. Spitali është përgjegjës për kontrollin e zbatimit të rregullave të përcaktuara në Kontratën Konçesionare Nr. 1440/40 prot., datë 24.12.2015, ñPër ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumentave kirurgjikale sterile, furnizimin me materiale mjekësore sterile një përdorimëshe në sallat kirurgjikaleò, të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Shoqërisë Konçesionare Sa.Se. Sh.p.k. Spitali është përgjegjës për ruajtjen, plotësimin dhe nënshkrimin mbi modulet për gjurmueshmërinë klinike dhe administrative të shërbimit.
Gjatë auditimit të dokumentacionit të mbajtur nga spitali për periudhën 2019-2020, për setet kirurgjikale të sterilizuara nga koncesionari, të përdorura në 78 operacione, u konstatua se, dokumentacioni i kërkuar nga FSDKSH, është plotësuar jo në përputhje me aneksin nr. 4, të kontratës lidhur ndërmjet Ministrisë së

Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me koncesionarin Sani Service. Në modulet administrative të shërbimit të plotësuara nga mjekët që kryejnë operacionet, lidhur me zgjedhjen e kompleksitetit të setit kirurgjikal, përdoren diagnozat mjekësore të terminologjisë profesionale dhe jo klasifikimet e përcaktuara në aneksin 4.
Vlera e sterilizimit të seteve kirurgjikale, varion nga kompleksiteti i ulët i seteve në vlerën 13,900 lekë, në vlerën 22,300 lekë për kompleksitetin e mesëm dhe në vlerën 37,700 lekë në kompleksitetin e lartë.
Për periudhën 2019-2020 janë kryer 78 operacione kirurgjikale, nga të cilat 54 me kompleksitet të lartë dhe 24 me kompleksitet të ulët, me vlerë financiare 2,369,400 lekë, në të cilët modulet për gjurmueshmërinë klinike dhe administrative të shërbimit, lidhur me përzgjedhjen e kompleksitetit të setit, nuk i referoheshin aneksit 4, të kontratës me koncesionarin.

Kriteri:

Në kontratat me FSDKSH, është dhe pika e detyrimeve të spitalit në lidhje me kontratën konçesionare Sani service.
1. Spitali është përgjegjës për kontrollin e zbatimit të rregullave të përcaktuara në Kontratën Konçesionare Nr. 1440/40 prot., datë 24.12.2015, ñPër ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me materiale mjekësore sterile një përdorimesh në sallat kirurgjikaleò, të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Shoqërisë Konçesionare Sani Service Sh.p.k.
Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 9 të kontratës Konçesionare Nr. 1440/40 prot., datë 24.12.2015, ñPër ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me materiale mjekësore sterile një përdorimesh në sallat kirurgjikaleò, të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Shoqërisë Konçesionare Sani Service Sh.p.k.
Ne kontrate citohet: ñ9. Klasat e kompleksitetit ose intensiteti i ndërhyrjes kirurgjikale.
9.1 Klasat e Kompleksitetit të ndërhyrjeve kirurgjikale përcaktohen nga një seri faktorësh si për shembull por pa u kufizuar me to: i) tipologjia e instrumenteve kirurgjikal; ii) numri i instrumenteve që përbejnë setin kirurgjikal dhe numri i seteve kirurgjikale te nevojshëm për një ndërhyrje kirurgjikale; iii) materiali një përdorimesh për çdo ndërhyrje kirurgjikale.
9.2 Palët bien dakord për klasifikimin e ndërhyrjeve kirurgjikale që përfshihen në Shërbimet objekt të kësaj Kontrate, ne tre Klasa Kompleksiteti sipas faktorëve të përcaktuar ne nenin 9.1 më lartë. Palët bien dakord se Klasat e Kompleksitetit janë:
i) Kompleksitet i larte;
ii) Kompleksitet i mesem; dhe

iii) Kompleksitet i ulet.
9.4. Palët bien dakord gjithashtu se kriteret për vlerësimin e numrit dhe tipologjisë se seteve kirurgjikale dhe materialit një përdorimesh te nevojshëm dhe te mjaftueshëm për te kryer tipologjitë kryesore të ndërhyrjeve kirurgjikale te listuar ne Aneksin 4, do te përcaktohen gjate periudhës pas nënshkrimit të Kontratës dhe para fillimit te ekzekutimit te Shërbimit nga Konscesionari, pa ndryshuar çmimet dhe Klasat e Kompleksitetit sipas Kontrates. Për vlerësimet e mësipërme do te behet referim ne treguesit teknik dhe operativ te shprehur ne Projektin Teknik te Koncesionarit.
9.5 Palët përcaktojnë se Klasat e Kompleksitetit sipas kësaj Kontrate mund te jene objekt diskutimi, ndryshimi apo integrimi te mëtejshëm, nëse do te ndryshonin protokollet kirurgjike dhe/ose ne rast te përditësimeve teknologjike qe kane efekt mbi Shërbimet. Gjithashtu, Palët bien dakord për të verifikuar çdo vit, në mënyre periodike, nevojën për ndryshime apo integrime te Klasave të Kompleksitetit sipas kësaj Kontrate. **Ndryshime apo integrime të Klasave të Kompleksitetit sipas kësaj Kontrate do te bëhen vetëm me miratim te Autoritetit**, brenda muajit nëntor të çdo viti, dhe konform Projektit Teknik e Business Plan te Koncesionarit dhe ofertës se paraqitur nga Koncesionari në Procedurën për Dhënien me Koncesion dhe pranuar nga Autoriteti.ò

Ndikimi/Efekti: Mos përcaktimi i saktë i seteve që do të përdoren, rrit riskun e subjektivizmit në përzgjedhjen e kompleksitetit të tyre, gjë e cila shoqërohet me kosto financiare shtesë. Vlera 2,369,400 lekë, është kosto e sterelizimit të seteve kirugjikale të përdorura në 78 operacione, ku modaliteti i përzgjedhjes së tyre nuk është kryer sipas kushteve të përcaktuara për tu ndjekur nga SUSHN.

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia: E Lartë
Rekomandim: Strukturat drejtuese të marrin masa për përcaktimin e ndërhyrjeve kirurgjikale shtesë, që nuk janë të përfshira në aneksin 4, të kontratës koncesionare për sterilizimin dhe tõ kërkojë MSHMS për klasifikimin e kompleksitetit të seteve që përdoren në to, shoqëruar me ndryshimet përkatëse në kontratën me koncesionarin.

2.9.Organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditit të brendshëm, kapacitetet audituese që mbulojnë këtë aktivitet. Planifikimi, realizimi i programit vjetor të auditimit dhe analiza sipas llojeve dhe gjetjeve. Rezultatet dhe eficenca e strukturave të ngritura për realizimin e auditit të brendshëm. Ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga drejtimi.

Organizimi i sektorit të AB në SUSHN
Njësia e Auditimit të Brendshëm të ñSUSHNò Tiranë, është miratuar me shkresën nr 1208/1 datë 03.03.2017 për miratimin e strukturës analitike të SUSHN , është e organizuar në rang Njësie me

tre punonjë ku njeri është në cilësinë e drejtorit të AB. NJAB është në varësi të Drejtorit të institucionit dhe ka në përbërjen e saj 3 punonjës (Drejtor + 2 punonjës) sipas strukturës analitike të miratuar, por që operon vetëm me një punonjës, i cili është i certifikuar nga Njësia e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave si Auditues të Brendshëm.
Kjo strukturë nuk është plotësuar asnjëher e plotë duke vënë në vështirësi dhe NJAB për arritjen e planit të auditimeve, aktualisht NJAB operaon vetëm me një punonjës e cila është pocicionin e drejtorit të NJAB.

Veprimtaria e NJAB në SUSHN për periudhën objekt auditimi

Njësia e Auditimit të Brendshëm të ñSUSHNò Tiranë, ka hartuar planin vjetor 2018 dhe planin strategjik 2019-2021 për veprimtarinë e Njësisë së Auditit Brendshëm , të spitalit Universitar ñShefqet Ndroqiò Tiranë dhe miratuar me urdhër të Drejtorit të spitalit Universitar ñShefqet Ndroqiò me nr.20/3, datë 23.10.2018.
Llojet e auditimeve të planifikuara për vitin 2019 janë:
Angazhime auditimi për shërbimet e sigurisë nga të cilat , Auditime përputhshmërie 3, Auditime financiare 1 dhe Auditim i kombinuar 1.
Llojet e auditimeve të planifikuara për vitin 2020 janë:
Angazhime auditimi për shërbimet e sigurisë nga të cilat , Auditime përputhshmërie 5, Auditime financiare 1 dhe Auditim i kombinuar 2.

Referuar planifikimit dhe realizimit të auditimeve nga Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë SUSHN Tiranë për çdo vit objekt auditimi, konstatohet se:

-Për vitin 2018 NJAB ka hartuar planin vjetor 2018, të sektorëve për tu audituar në SUSHN, i cili është miratuar me urdhër të Drejtorit të spitalit Universitar ñShefqet Ndroqiò, në të cilin janë planifikuar 6 auditime dhe janë realizuar 6 auditime, nuk janë realizuar 6 auditime , më hollësisht e detajuar si më poshtë si vijon:
Auditime të planifikuara dhe të realizuara në vitin 2018.

Nr	Objekte për tu audituar	Lloji dhe fusha e auditimit	Numri i auditimeve	
			Plan	Fakt
1	Sektori i Shërbimeve	I Plotë	1	1
2	Sektori i Biostatistikës	I Plotë	1	1
3	Kirurgjia Torakale	I Plotë	1	1
4	Laboratori Klinik-Biokimik	I Plotë	1	1
5	Sektori Juridik	I Plotë	1	1
6	Raport në lidhje me kartelat mjeksore	I Plotë	1	1
	TOTALI		**6**	**6**

Burimi: Të dhëna të SUSHN, përpunuar nga grupi i auditimit

Për vitin 2019,NJAB ka hartuar planin vjetor 2019, të sektorëve për tu audituar në SUSHN, i cili është miratuar me urdhër të Drejtorit të spitalit Universitar ñShefqet Ndroqiò me nr.20/3, datë 23.10.2018, në të cilin janë planifikuar 6 auditime dhe janë realizuar 7 auditime, ky plan auditimi ka pësuar ndryshime me kërkes të titullarit të institucionit nga janë hequr:
Sektori i Faramcisë
Shërbimi i Pneumologjisë nr. 2
Sektori i Pneumonologjisë nr. 3
Janë shtuar:
1.Sektori i Financës në lidhje me :"Për trajtimin financiar te punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë shtetit".
2. Sektori i Kostos auditimi i cili ishte planifikuar për vitin 2018 por nuk u realizua pasi me urdhër të Drejtorit të Institucionit u realizua auditimi ñMbi kontrollin e shpenzimeve midis

farmacisë dhe kartelave mjeksore për disa antibiotikë"
3.Auditimi në Shërbimin e Urgjencës Mjekësore Paraspitalore edhe kjo me urdhër te Drejtuesit të Institucionit.
4. Auditimi në Sektorin Teknik në lidhje me "Efektivitetin dhe eficencën e përdorimit të 02",me urdhër të Drejtuesit të Institucionit.
Auditime të planifikuara dhe të realizuara në vitin 2019

Nr	Objekte për tu audituar	Lloji i auditimit Fusha e auditimit	Numri i auditimeve	
			Plan	Fakt
1	1.Sektori i Financës në lidhje me "Për trajtimin financiar te punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë shtetit".	I Plotë	1	1
2	Sektori i Kostos	I Plotë	1	1
3	Shërbimi i urgjencës paraspitalore (mekërkes të titullarit të institucionit)	I Plotë	1	1
4	Sektori Teknik (Në lidhje me efektivitetin e O2)	I Plotë	1	1
5	Shkalla e realizimit të rekomandimeve të KLSH	I Plotë	1	1
6	Sektori i Finacës	I Plotë	1	1
7	Shërbimi i Pneomologjisë nr. 1	I plotë	1	1
	TOTALI		**7**	**7**

Burimi: Të dhëna të SUSHN përpunuar nga grupi i auditimit

Për vitin 2020,NJAB ka hartuar planin vjetor 2020, të sektorëve për tu audituar në SUSHN, i cili është miratuar me urdhër të Drejtorit të spitalit Universitar ñShefqet Ndroqiò, në të cilin janë planifikuar 8 auditime dhe janë realizuar 4 auditime, si rezultat i situatës pandemike dhe kthimin e këtij spitali në COVID ky plan auditimi ka pësuar ndryshime me kërkesë të drejtorit të NJAB dhe miratuar me urdhër të drejtorit të institucionit nr. 300 datë 16.02.2020. Kërkesa për ndryshimin e planit të auditimit është kryer thuajse formale pasi mban datën 16.12.2020 praktikisht pa patur afat fizik kohorë për kryerje auditimi e për rrjedhoje ishte e pa mundur realizimi i planit të auditimeve.
Auditime të planifikuara dhe të realizuara në vitin 2020

Nr	Objekte për tu audituar	Lloji i auditimit Fusha e auditimit	Numri i auditimeve	
			Plan	Fakt
1	Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH	I Plotë	1	1
2	Sektori i Juridik	I Plotë	1	1
3	Shërbimi i Farmacisë	I Plotë	1	1
4	Sektori i farmacisë në vazhdim	I Plotë	1	1
	TOTALI		**4**	**4**

Burimi: Të dhëna të SUSHN, përpunuar nga grupi i auditimit.

Për periudhën 2018-2020,gjendja e zbatimit të rekomandimeve nga strukturat e SUSHN, në total janë dhënë nga NJAB rreth 92 rekomandime nga të cilat 92 rekomandime janë pranuar nga menaxhimi, janë zbatuar 80 rekomandime, në proces janë 12 rekomandime.
Ndër rekomandimet kryesore që kanë mbetur pa u realizuar brenda afateve të përcaktuara janë ato që kanë lidhje me :

-Ndërtimi i gjurmës së auditimit për proceset kryesore të punës;
-Hartimi i regjistrit të riskut;
-Hartimi i planeve të kontrollit të brendshëm;
-Përmirësimi i kushteve të ruajtjes së aktiveve në magazina, në drejtim të kryerjes së investimeve, riparimeve, sistemimit të baranve etj.
-Për sa më lart grupi i auditimit konstaton se për periudhën 2018-2020, nuk është realizuar plani i auditimeve sipas periudhës së përcaktuar në programin strategjik 2019-2021 dhe planet vjetore të auditimit, por disa nga auditimet e planifikuara nga NJAB për çdo vit të mbetura pa u audituar janë mbartur në vitin pasardhës, ose nuk janë realizuar. Kjo si rezultat i mungesës së stafit në strukturën e NJAB dhe të ndryshimeve të herëpashershme të planit të auditimit nga kërkesat e titullarit të institucionit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 22/46 prot. datë 27.09.2021 ñMbi Projektraportin e Auditimitò, nga z. P. K., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Eshtë paraqitur emërimi në pozicionin e audituesës në pozicionin vakant e ka plotësuar strukturën e Auditit të brendshëm, i cili u morr në konsideratë nga grupi i auditimit dhe nuk trajtohet në Raportin e Auditimit.

2.10.Mbi auditimin e fondeve të akorduara dhe të shpenzuara, për përballimin e situatës së pandemisë Covid-19.

Spitali Universitar Shefqet Ndroqi, me Urdhrin e Ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr.413, datë 13.07.2020, ka kaluar në Spital Covid. Për këtë qëllim referuar misionit specifik dhe destinacionit të përdorimit të mjekimit janë paraqitur kërkesa për shtesë fondesh për mbulimin me pajisje dhe medikamente mjeksore anti Covid-19. Për këtë qëllim, me VKM nr.207, datë 10.03.2020 ñPër dhënie shpërblimi për personelin mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerëò, është përcaktuar masa e shpërblimit, kategoritë përfituese dhe fondi për përballimin e këtij shpërblimi. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në zbatim të VKM nr.207, datë 10.03.2020, ka nxjerrë shkresën nr.1429/1, datë 12.03.2020 ñDhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerëò dhe Urdhrin e Ministrit nr.224, datë 01.04.2020 ñPër dhënien e shpërblimit dhe miratimin e listës emërore të përfituesve, përfshirë ditët e angazhimit në diagnostikimin dhe trajtimin e personave të prekur nga COVID-19ò, ku janë përcaktuar veprimet që duhen ndjekur dhe dokumentacioni që duhet plotësuar për këtë qëllim. Për këtë qëllim nga drejtoria e SUSHN, janë hartuar kërkesat sipas nevojave dhe klasifikimit buxhetor për medikamente, pajisje mjekësore dhe materiale mjekimi.
Në lidhje me këtë pikë të programit, shpenzimet për medikamente dhe pajisjemjekësore janë shtrirë gjatë gjithë vitit 2020 dhe muajit janar 2021, pasi SUSHN është spital Covid dhe nuk kryen diagnostikime të tjera.
SUSHN, funksionon si spital covid dhe të gjitha shpenzimet e kryera për medikamente, materiale dhe pajisje mjekësore, shtesa pagash, etj, janë kryer në funksion të kësaj veprimtarie dhe janë trajtuar në drejtimet përkatëse të auditimit si buxheti, pagat, shpenzime, investime, prokurime,etj.

IV. REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIME

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

GJETJET DHE REKOMANDIMET
B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për procedurën e prokurimit ñF.V makineri pajisje për sistemin e kondicionimit në ambientet e SU ñShefqet Ndroqiò, rezulton se janë vendosur kritere jo në përputhje me volumin e natyrën e kontratës sa i takon disponimit të licencave profesionale si më poshtë:
- Sipas pikës 2.3.2.a, ndër të tjera është kërkuar që OE duhet të jenë të pajisur me licencën me drejtime si më poshtë:
NP-11 (E) ñNdërtime për N/Stacione, kabina e transformatori linja e TN të mesëm dhe shpërndarje energjisë.
NS-12 (E) ñImpiante teknologjik termike dhe të kondicionimitò.
NS 14 (E) ñImpiante të brendshme elektrike telefoni radiotelefoniò.
Përcaktimi A, B, C, D, E, ka të bëjë me nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, sipas vlerës së kontratës. Duke marrë në konsideratë fondin limit me vlerë 177 milionë lekë, klasa D (101 milionë deri 200 milionë lekë) është e mjaftueshme për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, ndërsa klasa E, i përket kontratave me vlerë nga 201 milionë lekë deri 400 milionë lekë.
- Sipas pikës 2.3.2.e, ndër të tjera është kërkuar që OE duhet të kenë makineri si më poshtë:
Makineri linjë prodhimi tub fleksibël, komplet (në pronësi ose me qira).
Makineri linjë prodhimi tub alumini, komplet (në pronësi ose me qira).
Kërkesa për linja prodhimi, ndërkohë që materialet janë parashikuar furnizim dhe vendosje, është e pa argumentuar.
Nga auditimi i procedurës së prokurimit ñRikonstruksion i disa ambienteve të Spitalit ñShefqet Ndroqiò, konstatohet se janë hartuar kritere të pa argumentuara si më poshtë:
-Është vendosur si kriter disponimi ose marrja me qira e automjeteve ñKamion vetëshkarkues me kapacitet 1-3 ton, Kamionçinë vetëshkarkuese me kapacitet 3-5 ton dhe Kamion vetëshkarkues mbi 10 tonò, ndërkohë që volumi i përafërt për transport për të dy lotet është 100 m^3, si për furnizim me materiale, ashtu dhe për largim materiale të dala nga mbeturinat.
-Skelë metalike të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë dhe rrjetë mbrojtëse në sasinë 2000 m^2, ndërkohë që punimet që realizohen janë në ambiente të brendshme dhe procesi i vetëm për të cilin kërkohen skela është suvatimi në tavane i cili është parashikuar në sasinë 120 m^2.
-Është kërkuar të ketë të punësuar dy specialistë druri, ndërkohë që nuk ka punime të tilla.
Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar, Neni 46, pika 3, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 61.
Vendosja e kritereve, të cilat nuk janë në përputhje me volumin e punës së kontratës, ndikojnë në uljen e konkurrencës, pra pamundësinë e një pjese të operatorëve ekonomikë për të marrë pjesë në tender. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1.Rekomandimi:SUSHN të marrë masa për trajnimin e punonjësve që angazhohen në realizimin e procedurave të prokurimit, me synim realizimin e tyre me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet, si edhe mos diskriminimin e operatorëve ekonomikë duke vendosur kritere të fryra dhe të pa nevojshme. ***Në vijimësi***

2. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt ñMarrje me qira e 2 kaldaja ngrohje me pelletò, u konstatua se llogaritja e fondit limit, nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, është kryer bazuar në të dhënat e kontratës së mëparshme në qiranë ditore, në llogaritjen e fondit limit janë përcaktuar vlera totale e shërbimit të 2 kaldajave përfshin koston e kaldajave, shpenzimet për vendosjen e tyre, si edhe procese të tilla si, vendosja e silosit 10 ton, vendosja e 2 paneleve elektrike, vendosja e 2 shnekëve, përgatitja e bazamentit për vendosjen e silosit dhe vlerën e shpenzimeve për mirëmbajtjen e tyre në rast defektesh, pra qiradhënësi do të përgjigjet edhe për defektet që lindin gjatë punës në kaldaja dhe bën riparimin e tyre me shpenzimet e veta brenda afatit prej 2 orë nga momenti i marrjes së njoftimit. Për këta zëra, mungon llogaritja e çmimit dhe vlerës. Fondi limit është i paargumentuar, nuk ka asnjë projekt, preventiv apo analizë të hollësishme çmimesh në lidhje me këtë strukture. Grupi i punës nuk ka argumentuar llogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me neni 59 ñPërllogaritja e vlerës limit të kontratësò, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi:Përllogaritja e vlerës së kontratës nga njësia e prokurimit/komisionet e ngritura për këtë qëllim, të bëhet duke analizuar koston e mallrave që do të prokurohen, llogaritje të sakta të vlerës së kontratës që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve si edhe duke harmonizuar metodat dhe alternativat e përllogaritjes së vlerës limit të kontratës në raport me specifikimet teknike, me qëllim arritjen e rezultateve të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt ñMarrje me qira e 2 kaldaja ngrohje me pelletò, u konstatua se nuk janë hartuar drejt dhe nuk janë argumentuar kriteret e kualifikimit. Referuar procesverbalit të datës 20.12.2017, për miratimin e dokumenteve të tenderit konstatohet se nuk është kërkuar asnjë kriter vlerësues në pikën 2 ñKriteret e veçanta për kualifikimò pika 2.1 ñKapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikëò. Nuk janë kërkuar bilance, kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse neni 28/4.a VKM nr. 914. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Nuk janë të argumentuara kriteret e kualifikimit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 11 *"Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit", neni 22 "Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës"* pika 3 e nenit 27, Neni 59 ñPërllogaritja e vlerës limit të kontratësò, neni 61/2 ñHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Njësia e Prokurimit, për të ardhmen të marrë të gjitha masat, që kërkesat e veçanta kualifikuese, të hartohen në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit, të përcaktohen kritere kualifikimi të sakta dhe të kuptueshme, pa lënë shteg për interpretime si dhe të detajohen sipas rregullave të prokurimit publik. Gjithashtu të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim detyrimisht të argumentuara, për të arritur rezultatet e dëshiruara në efektivitetin e përdorimit të fondeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Komisioni i vlerësimit të ofertavenë tenderin e zhvilluar me objekt *"Furnizim vendosje kaldajë për ngrohje"* ka vlerësuar operatorin ekonomik**,** pa plotësuar

kriterin/kualifikim. Për kapacitetin teknik, pika 2.3.1 kërkohet që OE, të paraqesë kontrata për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të ulët e 40%, realizuar gjatë 3 viteve të fundit. OE ñLu.ò ka paraqitur si kontrata të ngjashme, 2 kontratat e realizuara me SUSHN për vitet 2017 dhe 2018, të cilat kanë objekt *"Marrje 2 kaldaja me qira për ngrohje me lëndë djegëse Pellet"* dhe jo ñfurnizim vendosje kaldajeò e ngjashme me objektin e prokurimit, në këto kushte është vlerësuar dhe shpallur fitues, në kundërshtim me dokumentet e tenderit kriteret e veçanta/kualifikim ñkapaciteti teknikò. neni 66/3 ñShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertaveò i VKM nr.914, datë 19.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të SUSHN, në të ardhmen të marrin masa për përcaktimin në komisionet e vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë, të punonjësve specialistë të fushës me qëllim arritjen e rezultateve të kërkuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Në komisionin e hartimit të specifikimeve teknike dhe llogaritjen e vlerës së kontratës me objekt ñShërbimi me ushqim në pavijonet e spitalitò është caktuar i njëjti punonjës edhe për zbatimin, ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të ushqimit dhe konfirmimin nëse janë plotësuar specifikimet e kërkuara, veprim në kundërshtim me neni 22/3.b ñVeprimtaritë e kontrollitò, i ligjit nr. 10296 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, ku citohet se: *"Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht: a) procedurat dhe autoritetin për delegimin, transferimin dhe regjistrimin e autorizimit standard dhe të rasteve të veçanta; b) ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin". (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të SUSHN, të marrin masa për ndarjen e detyrave dhe përcaktimin në grupet e punës për kryerjen e procedurave të prokurimit e deri në zbatimin e kontratës, të punonjësve të cilët nuk janë përgjegjës në faza të ndryshme të procesit që nga propozimi, miratimi, zbatimi e marrja në dorëzim i mallrave, punëve/shërbimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Referuar dokumentacionit të mbajtur për kontrollin periodik të ushqimit, konstatojmë se përmbajtja e të gjitha akteve të mbajtura nga komisioni i ngritur nga SUSHN, dhe përfaqësuesi i shoqërisë So.-al, është njësoj duke cituar vetëm 4 tregues si: ushqimi është sipas menysë dhe gramaturës, orari i ushqimit është sipas kontratës, ushqimi ka cilësi të mirë dhe ushqimi është i paketuar. Në këto aktkontrolle nuk është pasqyruar në asnjë rast ndonjë mangësi në zbatimin e kontratës si edhe nuk janë pasqyruar kërkesa të tjera të kontraktuesit sipas neneve 6, 9, 10, 12 dhe 13, të kontratës në lidhje me transportin, pajisjet e përdorura, higjienën, treguesit matës të cilësisë, servirjen e ushqimit, etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve në bashkëpunim me strukturat e caktuara në pavijonet e spitalit për monitorimin e kontratës së shërbimit ñgatimi dhe shpërndarja e ushqimit të sëmurëveò, të hartojnë dokumentacionin mbi të cilin do të kryhet monitorimi, duke pasqyruar të gjitha detyrimet e kontraktorit ndaj shërbimit, me qëllim arritjen e treguesve në parametra sasiorë dhe cilësorë të kontraktuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Për ambientet e vëna në dispozicion të operatorit ekonomik ñSo.-Alò, nuk janë përcaktuar në marrëdhëniet kontraktuale detyrimet mes palëve sa i takon qirasë së ambientit dhe shpenzimeve për ujë dhe drita. Në nenin 6.4 të kontratës përcaktohet se porositësi në çdo pavijon ka caktuar një dhomë të veçantë (minikuzhinë) që përdoret për mbajtjen e inventarit dhe për shpërndarjen e ushqimit, i cili i është dhënë në përdorim kontraktuesit për ta mirëmbajtur në funksion të kryerjes së shërbimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të SUSHN, të marrin masa për të përcaktuar në kontratën e shërbimit me operatorin ekonomik ñSo.-alò, detyrimet e qirasë që rrjedhin nga përdorimi i ambienteve të spitalit dhe shpenzimet për ujë e energji elektrike, referuar legjislacionit në fuqi, me qëllim rritjen e të ardhurave dytësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave për shërbimin ñGatim dhe shpërndarje ushqimiò për periudhën objekt auditimi, konstatohet se dokumentacioni është nënshkruar nga k/infermieri i çdo pavijoni dhe përmbledhësja nga përgjegjësi i kartotekës ku konfirmohet forca ushqimore e çdo pavijoni. Dokumenti(formulari) ku pasqyrohet forca ushqimore ka të përcaktuar në ekstremitete se duhet nënshkruar nga k/infermieri dhe shefi i pavijonit, por janë në numër të pakët rastet ku dokumenti është nënshkruar nga shefat e pavijoneve, rezulton të jetë nënshkruar vetëm nga k/infermieri, veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñMbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò Kreu III/2 ñDokumentimi i lëvizjes së aktiveveò pika 35/b, 36 dhe 54. Punonjëset e kartotekës dhe sektori statistikës, të cilat hartojnë përmbledhëset mujore mbi bazën e këtij dokumentacioni kanë pranuar dokumentin ñForca ushqimoreò të plotësuar dhe nënshkruar vetëm nga k/infermieri. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1.Rekomandimi: Sektori i Statistikës në bashkëpunim me strukturat e caktuara në pavijonet e spitalit për monitorimin e kontratës së shërbimit ñgatimi dhe shpërndarja e ushqimit të sëmurëveò, të plotësojnë dhe pranojnë dokumentacionin mbi të cilin do të kryhet pagesa ndaj operatorit ekonomik ñSo.-alò, duke pasqyruar saktë numrin e të shtruarve në çdo pavijon, lëvizjet ditore,etj, të nënshkruar nga personat përgjegjës për ti dhënë forcën e dokumentit vërtetues pagese.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Departamenti i financës, regjistrimet e veprimeve kontabël të aktivitetit financiar të institucionit, i ka kryer me regjistra ose në programin Excel dhe jo me programe profesionale informatike, që njihen si ñBartës informatikëò, të cilët janë programe të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Mungesa e programit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, si edhe në cilësinë, saktësinë e evidencave kontabile dhe të pasqyrave financiare.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, neni 3, pika 14 që përcakton mënyrën se si mbahet dokumenti kontabël dhe pikën 15 për ñBartësit kontabëlò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 32-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Drejtoria ekonomike të marrë masa dhe të gjej mënyrat për përmirësimin e mbajtjes së kontabilitetit, për të rritur cilësinë e regjistrimit, përpunimit dhe hartimit të pasqyrave financiare.

Brenda muajit dhjetor 2021

10. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të saktësisë së paraqitjes të zërave në pasqyrat financiare dhe formatet përkatëse, u konstatuan problematika dhe pasaktësi në vlerën e pasqyruar si amortizim të akumuluar, pasi nuk është llogaritur amortizimi vjetor për çdo aktiv. Referuar auditimit të plotësimit të pasqyrës së amortizimeve dhe informacionit të detajuar për të, ka rezultuar se nga hartuesit e pasqyrave financiare, amortizimi i aktiveve të trupëzuara për periudhat 2018-2020, nuk kanë zbatuar, normat e amortizimit të përcaktuara në pikën 36, të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò. Në amortizimin e llogaritur, mungojnë kategoria e pajisjeve informatike, kompjuterike dhe elektronike e cila e ka llogaritjen ndryshe nga zërat e tjerë të aktiveve në masën 25 %. Llogaritjet e shpenzimeve të amortizimit nuk janë kryer për çdo artikull në veçanti por si klasa aktivesh të përgjithësuara. Mos llogaritja e saktë në vlerat e llogaritura të amortizimit të zërave të aktiveve afatgjata, në pasqyrat financiare te viteve 2018, 2019 dhe në 2020, sjell mos paraqitje të saktë dhe të besueshme të rezultateve ushtrimore, kanë si efekt mos evidentimin e nevojave për investime kapitale dhe shtrembërim të kostove spitalore.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 32-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
10.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të marrin masa për llogaritjen e saktë të vlerës së aktiveve gjendje dhe amortizimit për secilin grup mjetesh, si dhe pajisjeve kompjuterike e informatike duke pasqyruar me vërtetësi vlerën e mbetur pas rivlerësimeve përkatëse, pjesë e rëndësishme për përcaktimin e kostove të paketave spitalore dhe efekteve që sjell në Buxhetin e Shtetit. ***Brenda muajit dhjetor 2021***

11. Gjetje nga auditimi: Institucioni nuk vërteton me dokumente, pronësinë e zërave kontabël që ka në llogarinë ñNdërtime dhe rikonstruksioneò, të cilat i ka në pronësi apo në administrim. Në shkresën e ZVRPP Tiranë, më datë 20.07.2018, në përgjigje të kërkesës së SUSHN, me nr. 69282 Prot., datë 16.07.2018, për informacion, rezulton se në pronësi të institucionit është vetëm pasuria truall 19,625 m2, në zonën kadastrale 8190, me numër pasurie 13/773. Institucioni nuk ka vazhduar procesin e regjistrimit të pronave në ZVRPP në zbatim të pikës 4 të metodologjisë së punës të vendosur bashkëlidhur Urdhrit 158, date 15.04.2016.
Në zërin toka, troje, terrene nuk ka asnjë regjistrim për vlerat sasiore dhe ekonomike, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018, ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, pikën 3.3, Rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare, paragrafi 62 dhe paragrafi 91. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 32-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
11.1. Rekomandimi:Të merren masa nga strukturat drejtuese për kryerjen e veprimeve përkatëse për regjistrimin në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës të ndërtesave dhe trojeve që SUSHN zotëron dhe pasqyrimin e zërave kontabël përkatës në pasqyrat financiare.

Brenda muajit dhjetor 2021

12. Gjetje nga auditimi: Nga SUSHN nuk janë kryer analiza teknike të mbështetura në manualet përkatëse të pajisjeve, ekspertizave të specialistëve të fushës, të detajuara për caktimin e jetëgjatësisë për pajisjet gjendje dhe planifikimin për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 28.11.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në institucionet publikeò. Duke mos e përcaktuar me fleksibilitet jetëgjatësinë e aktiveve, duke mos vlerësuar zhvillimin e teknologjisë, SUSHN

rrezikon të mos kryej me sukses planifikimin në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 32-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi:Të merren masa nga strukturat drejtuese për vlerësimin e jetëgjatësisë së aktiveve, duke përdorur fleksibilitet dhe relacione të mirë argumentuara nga specialistët përkatës, për klasa specifike të aktiveve dhe jo të përgjithshme, për planifikimin në kohë të zëvendësimit të aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nëpunësi Zbatues si dhe sektori i financës, në lidhje me ndjekjen e pagesave të detyrimeve kontraktore nuk kanë ndërtuar një sistem gjurmimi skadencash, për të kontrolluar në mënyrë sistematike pagesat e kryera që të respektonin parimin e FIFO-s, si dhe garantimi i gjurmës së auditimit. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 12, të Ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 87-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të marrin masa për hartimin e një sistemi monitorimi të afateve të skadencave të detyrimeve të pagueshme, për të garantuar pagesën e të gjithë kreditorëve në kohë, si dhe gjurmën e auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Në procesin e iniciuar për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve në periudhën 2018, me vlerë 13,995,516 lekë, u konstatua se vlerësimi i artikujve për tu nxjerrë jashtë përdorimi, është bërë jo në përputhje me udhëzimin përkatës. Në proces verbalin e mbajtur nga komisioni përkatës, nuk janë argumentuar arsyet e vlerësimit të artikujve nëse janë të nevojshëm ose jo për veprimtarinë e njësisë, vlerësimin e gjendjes fizike dhe mundësinë e përdorimit të mëtejshëm në njësi të tjera si edhe nëse do të nxirret përfundimisht jashtë përdorimi nëpërmjet shitjes si material, mbeturinë apo asgjësimit përfundimtar. Vlerësimi i aktiveve nuk është bërë sipas kritereve si plotësimi i kohës së shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit, afatit të skadencës, nëse ka, dhe nuk mund të riparohen, kur vlera e riparimit ose e përshtatjes për tã kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm. Kur ka kaluar afati i vlefshmërisë së tyre dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuara, kur kanë humbur cilësitë e tyre të caktuara në standardet shtetërore ose në kushtet teknike dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuara ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formë tjetër, megjithëse nuk ka kaluar afati i vlefshmërisë, etj. Relacioni i vlerësimit nuk përmban procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 32-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të marrin masa që procesi i vlerësimit të aktiveve për tu nxjerrë jashtë përdorimi të kryhet me përgjegjshmëri, duke kryer analizat dhe argumentimet e bazuara në kriteret përkatëse dhe me relacione shoqëruese.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: SUSHN, nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat që duhet të përmbajë ky regjistër, nuk ka një përshkrim të plotë të aktivit,

thuajse të gjitha përshkrimet janë të përcipta dhe me emërtime të thjeshta të pajisjeve, mungon data e daljes në përdorim duke e bërë të pamundur përllogaritjen e vlerës së mbetur. U konstatua se inventari i pajisjeve informatike është i përfshirë në inventarin e pajisjeve dhe aparaturave. Duhet theksuar se këto lloje të ndryshme aktivesh kanë norma të ndryshme amortizimi dhe duke qenë se ato janë të inventarizuara të gjitha së bashku e bënë të vështirë nxjerrjen e vlerës neto (të mbetur) të aktivit, duke sjellë edhe diferenca në llogaritjen e amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 30. Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të institucionit. Mosplotësimi i regjistrit të aktiveve sjell risk të lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së institucionit, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 32-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>15.1. Rekomandimi:</u>Nëpunësi zbatues duhet të marrë masa për plotësimin e regjistrit të aktiveve që zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.

Menjëherë dhe në vjimësi

16. Gjetje nga auditimi: Në kuadër të bashkëpunimit mes spitaleve për shfrytëzimin e barnave dhe materialeve mjekësore para datës së skadencës, nëpërmjet koordinimit me drejtorinë e politikave dhe strategjive të zhvillimit të shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, në MSHMS, është kryer shkëmbimi i tyre, me të drejtë kthimi ose dhurim. Ky bashkëpunim ka sjellë reduktimin e barnave të skaduar në SUSHN, por procesi i dhurimit nuk është kryer sipas Udhëzimit nr. 30, datë 28.11.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në institucionet publikeò. Në lëvizjet e barnave mungonte konfirmimi zyrtar i njësisë përfituese si dhe miratimi i nëpunësit autorizues për daljen e tyre. Gjithashtu vlerat e barnave të falura si dhe pjesët me të drejtë kthimi nuk janë pasqyruar në zërin e shpenzimeve të pasqyrave financiare të periudhave përkatëse. Në vitin 2018 janë dhuruar barna e materiale mjekësore në vlerën 935,698 lekë, në periudhën 2019 në vlerën 2,366,289 lekë dhe në periudhën 2020 në vlerën 5,149,016 lekë. Veprimet sa më sipër, janë kryer pa miratimin e Nëpunësit Autorizues, në kundërshtim me pikën 107, e 114 të Udhëzimit nr.30, datë 28.11.2011,ñPër menaxhimin e aktiveve në institucionet publikeò, ñDhënia në përdorim/tjetërsimi i aktiveve te panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve 107.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 87-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

<u>16.1.Rekomandimi:</u>Strukturat drejtuese të marrin masa që procesi i faljes/dhënies ose marrjes me të drejtë kthimi i medikamenteve, të jetë i shoqëruar me shkresat përkatëse të nëpunësit autorizues për daljen e tyre si dhe me konfirmimet zyrtare të njësive përfituese duke vërtetuar përfundimin e transaksionit. Vlerat e barnave dhe materialeve mjekësore të dhuruara të paraqiten me saktësi në hartimin e pasqyrave financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Gjatë procesit të verifikimit të aktiveve afatgjata të SUSHN, u konstatua se në kapitalizimin e disa aktiveve, mungonte dokumentacioni shoqërues përkatës. Në shtesat e zërit të pajisjeve mjekësore, ñmonitorëò në vlerën 31,303,800 lekë, në periudhën ushtrimore 2020, u konstatua se mungonte letra zyrtare e njësisë donatore, (kalimi kapital i pajisjeve). Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 57, të Udhëzimit nr. 30, datë 28.11.2011,ñPër menaxhimin e aktiveve në institucionet publikeò. Mungesa e dokumentacionit zyrtar shoqërues mund të sjellë

problematika lidhur me garancitë e materialeve të marra në dorëzim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 32-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të marrin masa që procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve të dhuruara, të jetë i shoqëruar me shkresat përkatëse të njësisë donatore, për të mundësuar kontabilizimin korrekt të aktiveve të dhuruara si dhe ushtrimin e të drejtave të garancisë ose shërbimeve të mirëmbajtjes të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Njësia e SUSHN, nuk ka hartuar plan strategjik për periudhat 2019-2020, i cili të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit. Në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 28, datë 15.12.2011 ñMbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publikeò, nuk është hartuar dhe dërguar në ministri deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm.

-Për periudhën 2018-2020, SUSHN nuk ka plotësuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK në kundërshtim me Ligjin e MFK dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kap V ñShtojcatò, Shtojca 2ï Pyetësori i vetë-vlerësimit për komponentët e MFK-së.

Në kundërshtim me ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, Kreu II, neni 8 ñPërgjegjshmëria menaxheriale e titullaritò, pika 8. b, dhe neni 27 SUSHN nuk ka bërë ndryshimet përkatëse në periudhën 2019-2020, në Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS).

Mos plotësimi i hallkave sa më sipër rrit riskun e mos vlerësimit e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 96-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të marrin masa për hartimin e sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi si pjesë e rëndësishme e realizimit të objektivave kryesore.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i urdhër shpenzimeve të kryera nga SUSHN, për pagesat e detyrimeve kontraktore për barna, pajisje mjekësore, shërbime të ndryshme, për periudhën 2018-2020, u konstatuan 20 procedura të likuiduara me vonesë nga 1 deri më 4 muaj. Operatorët ekonomikë që kanë kryer furnizimet, nuk e kanë ushtruar të drejtën e kërkimit të penaliteteve. Procesi i kryerjes me vonesë të pagesave, ekspozon dhe rrit riskun e penaliteteve ndaj institucionit. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me kushtet e vendosura për likuidimin e faturave, në kontratat përkatëse me OE. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 87-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të marrin të gjitha masat për të kryer likuidimet e detyrimeve kontraktore në afat, për të mos maturuar penalitete ndaj operatorëve ekonomikë.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e blerjes me vlerë të vogël, ñRimbushje fikse zjarri dhe kolaudimin e tyre në S.U. ñShefqet Ndroqiò, Tiranë, 2020, u konstatua se në kërkesat për tu

plotësuar nga OE, është kërkuar se duhet të jetë i pajisur me Licencë QKL, kodi 1.2 A, për shërbim ekspertize, pika dhënia e asistencës teknike, si dhe të ketë ekspert privat zjarrfikës të pajisur me leje të lëshuar nga drejtoria MZSH në fushën e mësipërme. -Në ofertën e kërkuar janë dhe 120 copë F.V. bateri për sinjalizuesit e zjarrit dhe F.V. llampa LED me bateri 10 copë. Për këto mallra nuk janë paraqitur të dhënat specifike si amperazhi, kapaciteti, fuqia në W. Kërkesat për licencën kodi 1.2 A, për shërbim ekspertize, pika dhënia e asistencës teknike si dhe ekspert privat zjarrfikës i pajisur me leje të lëshuar nga drejtoria e MZSH janë të paargumentuara dhe jo të justifikuara pasi objekti i punës së ekspertit është ñstudimi dhe përgatitja e projekteve mbi masat nga zjarri të ndërtesave të çdo llojiò., kur objekti i procedurës është rimbushja dhe kolaudimi i fikseve të zjarrit. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me pikat 5, 7 të Udhëzimit nr.3, datë 08.01.2018, i ndryshuar, ñ Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò.
-Në procedurën e blerjes me vlerë të vogël, ñEvadimi i mbetjeve urbane ne S.U. ñShefqet Ndroqiò, Tiranëò, 2019, u konstatua se në kërkesat e hartuara nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla, për pjesëmarrësit në procedurë, duhet që bashkë me ofertën ekonomike, të paraqisnin dhe opsioni/opsionet se ku shkojnë mbetjet, shoqëruar me kontrata, lejet, dokumentet përkatëse që vërtetojnë plotësimin e tyre. Transporti i mbetjeve jo të rrezikshme bëhet në bazë të kontratës midis palëve, në të cilën përcaktohet detyrimisht përgjegjësia për rastin e kthimit mbrapsht pjesërisht ose plotësisht të mbetjeve nga pritësi. Mos përcaktimi i saktë i pjesës se ku shkojnë mbetjet mund të krijojë penalitete për SUSHN. Këto veprime janë në kundërshtim me seksionin C, të aneksit 1, të VKM Nr. 229, datë 23. 04. 2014 ñPër miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshmeò.
-Në procedurën e blerjes me vlerë të vogël, ñSigurimi i godinës së Spitalit Universitar ñShefqet Ndroqiò, në tërësi (shërbim mbrojtje kundër zjarrit).ò, u konstatua se në përgatitjen e kërkesave të kërkuara nga OE, nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla, nuk është kërkuar që ofertuesi duhet të ketë kontratë risigurimi për periudhën kohore në të cilën ofertuesi merr përsipër sigurimin e dëmit që kërkohet në këtë procedurë prokurimi.
Hartimi i termave të referencës është bërë në mënyrë të përgjithshme, nuk janë përcaktuar detajet apo karakteristikat për objektet e ndërtimit dhe konstruksionet të shoqëruara me foto, skica apo planimetri, gjendjen teknike të tyre, gjithashtu nuk janë përcaktuar karakteristikat për artikuj të përfshirë në llogarinë 214, instalime teknike, makineri, pajisje, vegla puna dhe llogarinë 218, inventarin ekonomik. Mangësitë në hartimin e termave të referencës, e bëjnë të paargumentuar hartimin e fondit limit dhe për pasojë ofertimin e marrë nga operatorë të tregut. Mos përcaktimi i termave të referencës në mënyrë të detajuar, krijon vështirësi në procedurën e rimbursimit, në rast se do të ndodhnin ngjarjet për të cilat po kryhet sigurimi. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò e ndryshuar, neni 59- Përllogaritja e vlerës limit të kontratës, Neni 61-Hartimi i dokumenteve të tenderit, Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, ñPër prokurimin publikò i ndryshuarò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
20.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të marrin masa për trajnimin e punonjësve lidhur me procedurat e prokurimit, për rritjen aftësive profesionale të tyre dhe realizimin me përgjegjshmëri dhe koherencë.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, për planifikimin e nevojave vjetore për barna dhe materiale mjekësore nga Shërbimet mjekësore në SUSHN, gjatë hartimit të

projektbuxhetit dhe planit buxhetor (pas miratimit), nuk bëhet analizë mbi gjendjen e ilaçeve, sasinë e konsumit të tyre vjetore, në mënyrë që të justifikojnë dhe argumentojnë listën për nevojat e këtyre barnave. Rritja e sasive të barnave të porositura nuk është e shoqëruar me relacione shpjeguese dhe argumentuese për justifikimin e sasive shtesë. Mos kryerja e analizave dhe mos argumentimi i tyre, sjellin rritjen e barnave stok, si dhe rritjen e riskut për tu kaluar afati i skadencës. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.7, ñPër procedurat standarde të përgatitjes së PBAò datë 28.02.2018, pika 6. Metodologjia e përcaktimit të politikave ekzistuese dhe politikave të reja, dhe me ligjin nr. 10 296, datë 8.7.2010, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, Neni 4, pika 19 dhe neni 16, "Gjurma e auditimit". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 26-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese në vazhdimësi të marrin masa për ndjekjen e procedurave të hartimit të PBA, duke siguruar që planifikimet të kryhen mbështetur në analiza të dinamikës të vlerësimit të kostove të nevojshme për ruajtjen e sasisë dhe cilësisë të shërbimeve të ofruara, vlerësimin e të dhënave historike të shpenzimeve, kostove për njësi, parametrave e çmimeve vendosur nga MSHMS dhe efiçencës dhe argumentimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2018-2020, SUSHN nuk ka paraqitur raporte monitorimi në Ministrinë e Financave, në kundërshtim me ligjin për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe ligjin për MFK. Mos plotësimi i procesit të monitorimit të performancës financiare të objektivave të politikës së programeve dhe produkteve të parashikuara në buxhetet vjetore bën të pamundur ndjekjen e arritjes së qëllimit dhe objektivave të synuar, evidentimin e realizimit të produkteve në përputhje me planin, analizën krahasimore të të dhënave, mos sigurimin e informacionit për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, mos garantimin e transparencës institucionale pasi të dhënat lidhur me performancën financiare nuk rezultojnë të publikuara në faqen zyrtare të SUSHN. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 96-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1. Rekomandimi: Drejtori i institucionit, në cilësinë e nëpunësit autorizues, të marrë masa për hartimin e raporteve të monitorimit për proceset e realizimit të objektivave dhe treguesve buxhetorë sipas formateve të Ministrisë së Financës, raportimin dhe publikimin e tyre në faqen web, për efekt të transparencës me publikun.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave rezulton se:

- Në listë pagesat e Spitalit Universitar ñShefqet Ndroqiò nuk reflektohet në kohë reale përmbushja e vjetërsisë duke krijuar diferenca në nivelet e pagave të punonjësve.
- Nga auditimi i punonjësve me kontratë dhe niveleve te pagave për mjekët me tituj dhe grada shkencore është konstatuar se janë mbajtur dy standarde në mënyrën e trajtimit të punonjësve me gradë shkencore. Për listën e pedagogëve, nga paga bruto ndalet vetëm tatimi në burim duke u konsideruar marrëdhënia e punësimit si shërbim. Ndërkohë, për listën e punonjësve me kontratë, edhe pse janë mjekë me tituj shkencor konsiderohen si të punësuar të përhershëm dhe mbi pagën e tyre bruto llogariten dhe ndalen të gjitha kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat personale. Veprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 i ndryshuar, Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, Neni 8 Llogaritja e kontributeve për punëmarrësin

1. Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të punëdhënësit për punëmarrësin dhe kontributet e vetë punëmarrësit llogariten sipas nivelit të përcaktuar mbi pagën bruto të punëmarrësit dhe shtesat e tjera me karakter të përhershëm që lindin nga marrëdhëniet e punës, brenda një page bruto minimale dhe nivelit maksimal të pagës, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore, që përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.
2. Kontributet e detyrueshme të sigurimit shëndetësor të punëdhënësit për punëmarrësin dhe kontributet e vetë punëmarrësit llogariten sipas nivelit të përcaktuar mbi pagën bruto të punëmarrësit dhe shtesat e tjera me karakter të përhershëm që lindin nga marrëdhëniet e punës, e cila nuk mund të jetë më e vogël nga paga minimale e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 17-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
23.1.Rekomandimi: Departamenti i burimeve njerëzore të marrë masa për përditësimin dhe transmetimin e informacionit në kohë reale të vjetërsisë së punës për çdo punonjës në muajin përkatës. Të kryhet përditësimi i vazhdueshëm i dosjeve të punonjësve dhe reflektimi i arsimit përkatës në bazë të të cilave hartohen edhe komponentët e pagës.

Menjëherë

23.2. Rekomandimi: Strukturat drejtuese te marrin masa për trajtim të barabartë dhe uniform të të punësuarve në referencë të bazës ligjore si dhe në respektim të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë për marrëdhëniet e punës dhe eliminimin e dy standardeve për punonjësit e tyre.

Menjëherë

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vlerësimit të ofertave nga KVO u konstatua se: Në ofertën teknike të OE Le. Security , DST pika 2.1 Kapaciteti ligjor i OE pika 3, u konstatua se vetëm 32 punonjës janë me licenca aktive sipas ofertës së dorëzuar, nga 36 punonjës që kërkohen. Gjithashtu, nga auditimi në listëpagesa të këtyre punonjësve rezultoi se vetëm 35 prej tyre janë në listëpagesat e kompanisë dhe nga këto vetëm 16 punonjës rezultojnë me licenca aktive.
OE i kualifikuar nga kvo dhe shpallur fitues nga titullari i Ak, nuk plotëson kapacitetin ligjor ñpunonjës me licencaò, edhe pse me këtë devijim nga ana e KVO është kualfikuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
24.1. Rekomandimi:KVO të marrë masa që në të ardhmen të kryej vlerësim sa më objektiv duke ruajtur paanshmërinë në procedurat që vlerësohen qofshin ato me ofertë më të ulët apo më të lartë, duke pasur në vëmendje plotësimin e të gjithë kritereve për kualifikimin e ofertuesve.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Kontrata ñF.V makineri pajisje për sistemin e kondicionimit në ambientet e SU ñShefqet Ndroqiò,është nënshkruar me nr. 461/37 prot., datë 03.08.2018, me kontraktorin ñEd Kon.ò SHPK, me vlerë 175,416,638.4 lekë me TVSH.
Nga auditimi i dokumentacionit të pagesave dhe librezës së masave rezulton se ka mangësi si më poshtë:
-Sipas zërit A-3.1.ANM-64 ñF.V llamarinë e galvanizuar për prodhimin e kanaleve të ajrit me trashësi nga 0.6 mm deri 1.2 mm, e kompletuar me gjithë fllanxha dhe të gjitha rakorderitë e nevojshme për prodhimin dhe montimin e kanaleve të ajritò, është certifikuar sasia 40841 kg.
Në specifikimet teknike pika 2.10, përcaktohet: Të gjitha kanalet e ajrit përjashtuar rastet kur specifikohet ndryshe, duhet të ndërtohen me flete metalike te galvanizuar. Te gjithë fletët

metalike të galvanizuara duhet të jenë të veshura me zink 275 g/m². Kapëset dhe mbajtëset duhet të jenë të mbrojtura të galvanizuara. Trashësia e fletëve metalike të galvanizuara duhet të përgjigjet në funksion të brinjës më të madhe të kanalit të ajrit, madhësia e te cilës jepet për gjerësi deri 30 cm, me trashësi 0.6 mm, për gjerësi nga 35 cm deri 57 cm, me trashësi 0.8 mm, për gjerësi nga 80 mm deri 120 mm me trashësi 1 mm dhe për gjerësi nga 125 cm deri 200 cm, me trashësi 1.2 mm.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se jo në të gjitha rastet janë respektuar përcaktimet e mësipërme, pasi për dimensione të ndryshme janë përllogaritur llamarinë me trashësi më të madhe. Gjithashtu pesha e marrë si referencë ka diferenca me peshën e përcaktuar në manuale.
Sa më sipër rezulton se diferenca e peshës e llogaritur më tepër është 15151 kg. Kësaj peshe i zbritet veshja me zink në të dy anët e llamarinës me 275 g/m^2, në sasinë 2522 kg (sipërfaqe 4586 m^2 x dy anë x 0.275 g/m^2). Rezulton se është certifikuar më shumë vlera 7,577,400 lekë [(15151 kg ï 2522 kg) x 600 lekë/kg], veprim i cili bie në kundërshtim me specifikimet teknike. Sa i përket shmangies së specifikimeve teknike në lidhje me zgjedhjen e trashësisë së llamarinave sipas dimensioneve rakorduese, deri në këtë periudhë të auditimit nuk disponohet dokumentacion që vërteton ndonjë ndryshim gjatë zbatimit të kontratës, si ndonjë referencë e mundshme e gabuar në përcaktimin e trashësisë së tyre.
-Nga verifikimi i zërave A-1.03 deri në A-1.11 ñF.V Tubo çeliku i zi pa tegel (Mannesmann)ò, rezultoi se pesha e përllogaritur referuar gjatësisë së tyre nuk rakordon me peshën që duhet të përcaktohej sipas referencave të manualeve, për standardet e përcaktuara në projektin e zbatimit.
Në projekt zbatim janë përcaktuar karakteristikat e tubacioneveñ*Tub çeliku i zi, pa saldim, me karakteristika, përmasa dhe peshe sipas UNI 10255 (**seria e mesme** me diametër deri ne 2" te përfshire), ose ne përputhje me UNI 10216-1*ò. Llogaritja e peshës së tubave nuk është referuar në këtë standard, duke certifikuar më shumë 4882 kg tubacione **me vlerë 2,196,900 lekë**.
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Specifikimet teknike të kontratës pika 2.10, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar, neni 7. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1.Rekomandimi:SUSHN në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për verifikimin trashësisë së llamarinave dhe të tubacioneve të vendosura në objekt, verifikim i cili nuk është realizuar nga KLSH për arsye të protokolleve Covid 19, pasi SSHUN në periudhën e auditimit fuksiononte si spital Covid. Bazuar në rezultatet e verifikimit, duke marrë në konsideratë se në dokumentacionin e dosjes teknike specifikimet teknike rezultojnë të pa zbatuara, ***të bëhet zbritja e vlerës 9,954,300 lekë***, llogaritur si peshë llamarinash dhe tubacionesh të argumentuara, rezultat e cili duhet të reflektohet në situacionet progresive dhe situacionin përfundimtar.

Gjatë zbatimit të kontratës.

D. MASA PËR ELIMINIMI E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se SUSHN për të gjithë periudhën e pandemisë ka shërbyer si spital COVID dhe si i tillë ka funksionuar i gjithi jo i ndarë si institucionet e tjera spitalore. Nga shqyrtimi i dhënies së shpërblimeve COVID për punonjësit rezultoi se në këtë spital kanë përfituar shpërblim të gjithë punonjësit si rezultat dhe i pashmangshmërisë së kontaktit

me të infektuarit me Covid. Për periudhën që ky institucion u kthye në COVID punonjësit kanë përfituar si shpërblim për punën në kushte të tilla vlerën prej *19,980,409 lekë,* e cila përbën efekt negativ financiar. Veprimet janë kundërshtim me VKM nr. 207 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, datë 10.03.2020 ñPër dhënieshpërblimi për personelin mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerëòdatë si dhe shkresën nr. 1429/1, datë 12.03.2020 ñDhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerëò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 17-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Nga Drejtoria e Spitalit Universitar ñShefqet Ndroqiò në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masa që shpërblimi për COVID-19 tõ jepet vetëm punonjësve të cilët kanë kontakt të drejtpërdrejtë me pacientë të kontaminuar dhe që kontribuojnë në diagnostikimin e të sëmurëve.

Në vijimësi

1.2. Rekomandimi: Strukturat drejtuese dhe departamenti i financës të marrin masa dhe të ndërpritet dhënia e shpërblimit për çdo punonjës që nuk kontribuon drejtpërdrejt në diagnostikimin e të sëmurëve me COVID-19.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Procedurat e ankimimit për tenderin me objekt ñFurnizim vendosje pajisje për hapjen e sallës së kardio kirurgjisëò janë tejzgjatur duke kaluar afatet, sepse nga KPP procedura pa kthyer përgjigje me vendim, ka zgjatur prej datës 17.07.2020 - 21.12.2020, ose 5 muaj me vonesë, e cila ka sjellë vështirësi në lidhjen dhe zbatimin e kontratës, pasi në fund të vitit mbyllen fondet buxhetore të akorduara për vitin 2020. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka vlerësuar në vend të parë operatorin ekonomik Bashkimi i përkohshëm i shoqërive ñBi. Alb. dhe Mo.ò me ofertë ekonomike 58,597,000 lekë, pa TVSH, duke vlerësuar devijime të vogla mangësitë në dokumentet e kualifikimit, anëtarët e kvo, edhe në ballafaqimin e kryer nga grupi auditimit konfirmuan se pajisjet e sjella dhe vlera e bashkimit të operatorëve ñBi.& Mo.ò përmbushnin parametrat dhe ishin pajisje cilësore të kompanisë ñGe. Elek.ò. Specifikimet teknike të hartuara nga AK, kanë pësuar disa ndryshime si pasojë e ankesave të operatorëve ekonomikë. Referuar dokumenteve në dispozicion dhe ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, vendimet e marra nga KPP, kanë vlerësuar pjesërsisht ankesat e paraqitura nga Operatori ekonomik ñBiom. dhe Mo.ò për specifikimet teknike të ofruara, dhe vendimi i KPP ka gjeneruar fituesin me vlerë më të lartë prej *13,103,000 lekë*.

Komisioni i Prokurimit Publik, ka vendosur të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ñBio.&Mo.ò, pasi nuk sjell fakte të reja si edhe kjo çështje e pretenduar merr cilësinë e një çështjeje të shqyrtuar tashmë nga KPP, situatë kjo analoge me çështjet që janë gjykuar njëherë nga gjykata, për të cilat zbatohet parimi i gjësë së gjykuar njëherë nga gjykata, iso lege, pretendimet nuk mund të merren në shqyrtim. Operatori ekonomik nuk legjitimohet për paraqitjen e ankesës në KPP, e rrjedhimisht pretendimet nuk merren në shqyrtim nga KPP.

KPP, para shqyrtimit në themel të pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues, konstaton se ky i fundit nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë për skualifikimin e operatorit ekonomik ñFe.ò për shkak se nuk gëzon asnjë interes të ligjshëm në këtë procedurë prokurimi, etj. Akoma më tej KPP, gjykon se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorit për të cilin paraqet pretendime për kualifikim duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorët e renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor (SUSHN), për procedurat e prokurimit kryesisht me objekt ñpajisje mjekësoreò që do të kryej në të ardhmen, të marrë masa për përcaktimin e saktë të specifikimeve teknike nga specialistë të fushës në bashkëpunim me mjekë specialistë që do tí përdorin, me qëllim arritjen e prokurimit brenda afateve, me efektivitet dhe ekonomicitet.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në SUSHN, shërbimi me kaldajat e ngrohjes dhe avullit është ofruar nëpërmjet kontratave të qirasë prej vitit 2012-2017, me një vlerë të konsiderueshme prej 57,161,058 lekë. Për këtë, nga auditimet e kryera nga KLSH në vite, është theksuar blerja e kaldajave me qëllim uljen e shpenzimeve dhe vënien në përdorim të kaldajave të institucionit. Deri në vitin 2019, nuk është mundësuar nga Ministria e Shëndetësisë blerja e kaldajave, duke shtuar vlerën e shpenzuar vetëm për periudhën objekt auditimi me *12,096,439 lekë*, e cila përbën efekt negativ për SUSHN. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të SUSHN, njësia e prokurimit/komisionet e ngritura për kryerjen e prokurimeve/shërbimeve, të analizojnë koston e mallrave/shërbimeve që do të prokurohen, duke zgjedhur vlerën e kontratave në favor të institucionit, me qëllim arritjen e rezultateve të dëshirueshme për të siguruar ekonomicitet dhe efektivitet në përdorimin e fondeve publike**.**

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në procesin e monitorimit të kontratave të SUSHN me FSDKSH, për ñFinancimin e shërbimeve spitaloreò, u konstatua mos realizim i detyrimeve të spitalit në lidhje me kontratën konçesionare Sa.se. Spitali është përgjegjës për kontrollin e zbatimit të rregullave të përcaktuara në Kontratën Konçesionare Nr. 1440/40 prot., datë 24.12.2015, ñ*Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumentave kirurgjikale sterile, furnizimin me materiale mjekësore sterile një përdorimesh në sallat kirurgjikale*ò, të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Shoqërisë Konçesionare Sa.Se. Sh.p.k.

Gjatë auditimit të dokumentacionit të mbajtur nga spitali për periudhën 2019-2020, për setet kirurgjikale të sterilizuara nga koncesionari dhe të përdorura në 78 operacione, u konstatua se, dokumentacioni i kërkuar nga FSDKSH, është plotësuar jo në përputhje me aneksin nr. 4, të kontratës lidhur ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me koncesionarin Sa. Se. Në modulet administrative të shërbimit të plotësuara nga mjekët që kryejnë operacionet, lidhur me zgjedhjen e kompleksitetit të setit kirurgjikal, përdoren diagnozat mjekësore të terminologjisë profesionale dhe jo klasifikimet e përcaktuara në aneksin 4.

Vlera e sterilizimit të seteve kirurgjikale, varion nga kompleksiteti i ulët i seteve në vlerën 13,900 lekë, në vlerën 22,300 lekë, për kompleksitetin e mesëm dhe në vlerën 37,700 lekë në kompleksitetin e lartë.

Për periudhën 2019-2020 janë kryer 78 operacione kirurgjikale, nga të cilat 54 me kompleksitet të lartë dhe 24 me kompleksitet të ulët, me vlerë financiare *2,369,400 lekë*, në të cilët modulet për gjurmueshmërinë klinike dhe administrative të shërbimit, lidhur me përzgjedhjen e kompleksitetit të setit, nuk i referoheshin aneksit 4, të kontratës me koncesionarin.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 9, të kontratës Konçesionare Nr. 1440/40 prot., datë 24.12.2015. Mos përcaktimi i saktë i seteve që do të përdoren, rrit riskun e subjektivizmit në përzgjedhjen e kompleksitetit të tyre, gjë e cila shoqërohet me kosto financiare shtesë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 87-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të marrin masa, për përcaktimin e ndërhyrjeve kirurgjikale shtesë, që nuk janë të përfshira në aneksin 4, të kontratës koncesionare për sterelizimin dhe tëi kërkojë MSHMS për klasifikimin e kompleksitetit të seteve që përdoren në to, shoqëruar me amendimet përkatëse në kontratën me koncesionarin.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës, me objekt ñShërbim me roje private për SUSHNò, u konstatua se: referuar listë pagesave punonjësit e ofrimit të shërbimit të rojeve në SUSHN paguhen me 36,000 lekë/muaj pagë bazë pa përfshirë shtesat e përcaktuara për kë të pozicion pune, ku sipas ofertës dhe kontratës duhet të paguheshin me 48,793.95 lekë, pagë/muaj. Operatori ekonomik ñLe. Sec.ò ka përfituar padrejtësisht 5,811.44 lekë/roje/muaj (sipas Ofertës së Le. security) x 4.98 vend roje = 28,941 lek në muaj x 7 vend roje = 202,586.8 lekë, përfitim i pa drejtë nga paga e rojeve që mban OE Le. security.
Nga verifikimi i kryerjes së shërbimit dhe pagesës sipas ofertës dhe kontratës së nënshkruar u konstatua se: asnjë nga punonjësit e shërbimit të cilët kanë kryer shërbim me turne të 2 apo të 3 nuk është paguar sipas kushteve të kontratës, por është paguar si punonjës shërbimi me 1 turn duke përvetsuar padrejtësisht diferencën e shtesës mbi pagë të punonjësve që punojnë turne të dyta e të treta 5,811.44 lekë/roje/ muaj x 4.98 vend roje = 28,941 lekë/muaj x 7 vend roje = 202,586.8 lekë, përfitim i pa drejtë nga paga e rojeve që mban OE ñLe.ò. Gjithashtu, nga ky përvetësim i pagës është shmangur dhe pagesa e detyrimit për sigurime shoqërore e shëndetësore 16.7% ose 970.51 lekë/muaj/roje, ose 4,833.13 lekë për vendroje x 7 = 33,831 lekë/muaj shmangie nga detyrimi i pagimit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për punonjësit me 3 turne /muaj. Në total ky përvetësim pagë + sigurime shoqërore e shëndetësore, është 236,417 x 9muaj (kontratë) = *2,127,753 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
5.1.Rekomandimi: SUSHN, të dërgoj informacion në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, mbi konstatimet e KLSH si edhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për procedurën e prokurimit me objekt ñShërbim me roje private për SUSHNò, fituar nga operatori ekonomik ñLe. securityò(kontratë, specifikime teknike, etj) me qëllim verifikimin dhe vlerësimin e detyrimeve tatimore konform legjislacionit në fuqi dhe shmangien e parregullsive në llogaritjen, mbajtjen dhe derdhjen në buxhet të detyrimeve për punonjësit e shoqërisë.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit ñBlerje oksigjen për vitin 2020ò, konstatohet se kërkesa për blerje oksigjeni sipas procedurës së prokurimit ñBlerje oksigjen për vitin 2020ònë sasinë 2072820 litra, me vlerë 280,286,720.4 lekë, për periudhën nga data 07.08.2020 deri me datë 01.08.2021 është bërë me datë 27.07.2020. Çmimi i përllogaritur është 135.22 lekë për litër.
Kërkesa për blerjen e oksigjenit i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresë nr. 117/1 prot., datë 28.07.2020. Ministria i ka dhënë miratimin nëpërmjet komunikimit elektronik regjistruar me nr. 117/2 prot., datë 04.08.2020. Nga ana e SUSHN, krahas furnizimit të kontraktuar, është kërkuar furnizimi me 170,000 litra me oksigjen për arsye të rritjes së konsumit pasojë e Covid-19.
MSHMS me shkresë nr. 3601/1 prot., datë 03.08.2020, ka rekomanduar lidhjen e menjëhershme të kontratës së furnizimit më oksigjen, si dhe delegimin e të drejtës së zhvillimit të procedurës për furnizimin me afat 1 vjeçar. Bazuar në këtë shkresë përcaktohet që në kompetencat e deleguara

përfshihet edhe përllogaritjet e fondit limit në total, sasitë, specifikimet teknike, llojin e procedurës së prokurimit, lidhje dhe ndjekje e kontratës etj.
Bazuar në sa më sipër, është bërë ftesa për ofertë për BOE ñGTSdhe Mess. Al.ò ñBlerje barna ï B1ò, sipas kontratës së nënshkruar ndërmjet MSHMS dhe BOE ñGTS dhe Mess. Al.ò. Kontrata për sasinë 170000 litra oksigjen është nënshkruar me nr. 117/8 prot., datë 05.08.2020, me OE ñGtSò, me çmim njësi 135.4 lekë për litër. Afati i realizimit të kontratës është përcaktuar nga data 05.08.2020 deri me datë 21.08.2020.
Theksojmë se kontrata e nënshkruar nga vetë SUSHN me OE ñGTSò, për vitin 2019, ka rezultuar me çmimin për njësi 135.22 lekë për litër. Marrja për referencë e çmimit për njësi për kontrata të nënshkruara nga MSHMS dhe jo nga vetë institucioni, ka rezultuar me një rritje të çmimit të blerjes së oksigjenit të lëngshëm me 0.18 lekë për litër.
Bazuar në Informacionin nr. 117/17 prot., datë 17.08.2020, të sektorit teknik, është kërkuar furnizimi me sasinë 630000 litra oksigjen i lëngët, për një periudhë 70 ditore, për arsye të konsumit të lartë. Për këtë arsye, është lëshuar urdhri i prokurimit nr. 117/18 prot., datë 18.08.2020, për zhvillimin e procedurës së prokurimit ñNegocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratësò, me fond limit 85,302,000 lekë, për furnizimin e sasisë 630000 litra oksigjen të lëngët (çmim njësi 135.4 lekë/litër). Kontrata përkatëse është nënshkruar me nr. 117/26 prot., datë 24.08.2020, për afatin e zbatimit 70 ditor. Sasia e furnizuar sipas procedurave të mësipërme është 2078820 litra. Vlera 374,187 lekë (2078820 litra x 0.18 lekë/litër) konsiderohet efekt negativ financiar. Ky veprim bie në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6.1.Rekomandimi:SUSHN të marrë masa që në realizimin e procedurave të prokurimit të merren për referencë çmimet/njësi për kontrata të nënshkruara nga vetë institucioni kur ai është ekonomikisht me i favorshëm, për të siguruar ekonomicitetin, eficiencën dhe efektivitetin në përdorimin e fondeve publike. ***Në vijimësi***

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, deklarimet e punonjësve të kaldajës dhe verifikimi fizik i kaldajës, u konstatua se 2 kaldajat e avullit dhe e ngrohjes të kontraktuara me qira nga SUSHN, nuk janë lëvizur nga territori i spitalit, pasi kë to dy kaldaja janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën, kanë të përbashkët impiantin e marrjes së lëndës djegëse (silosin, shnekun etj) si rrjedhojë kaldaja e ngrohjes nuk është lëvizur nga vendi për periudhën mbas përfundimit të kontratës së qirasë.
Nuk është marrë asnjë masë nga drejtoria e spitalit për lirimin e hapsirës prej 45m² (50% e sipërfaqes totale të dhomës së kaldajave të zënë nga kaldaja e ngrohjes) aq më tepër nuk i është kërkuar operatorit fitues lirimi i ambienteve apo llogaritja e një qiraje mujore sipas përcaktimeve në VKM nr.54, datë 05.02.2014 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, i ndryshuar. Referuar paragrafit III të kësaj VKM, ndryshuar me VKM nr. 992, datë 09.12.2015 Tarifat dysheme të qirasë mujore për ndërtesat sipas qarqeve, në qytetin e Tiranës tarifa dysheme është përcaktuar 300 lekë/m², (45m² x 300 lekë/m²) = 13,500 lekë/muaj qira e pa llogaritur ndaj operatorit ekonomik për zënie hapësire përtej afatit kontraktor.
Për periudhën Mars -Tetor 2018, kohë në të cilën kjo kaldajë nuk duhet të ishte në këto ambiente operatori *ekonomik i detyrohet Spitalit Universitar "Shefqet Ndroqi" vlerën prej 13,500 lekë/muaj x 8 muaj = 108,000 lekë, vlerë e cila përbën të ardhur të munguar për institucionin, pasi operatori ekonomik ka shfrytëzuar asetet e spitalit pa asnjë detyrim.* Ligji nr. 10296, datë

08.07.2010, i ndryshuar, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, kreu IX, neni 77 ñEkzekutimi dhe mbikëqyrja e kontratësò dhe VKM nr.54, datë 05.02.2014 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të SUSHN, në të ardhmen të marrin masa për monitorimin e kontratave të shërbimit dhe përcaktimin e kushteve kontraktuale për qiradhënien për shfrytëzimin maksimal të hapsirës së spitalit sipas legjislacionit në fuqi, me qëllim rritjen e të ardhurave dytësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

E.MASA ADMINISTRATIVE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12 Kreu III, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, **i rekomandojmë**, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Tiranë, **të vlerësojë shkeljet e konstatuara**:

Shoqëria **"To." SHPK**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin ñF.V makineri pajisje për sistemin e kondicionimit në ambientet e SU óShefqet Ndroqiôòka certifikuar punime me vlerë 9,954,300 lekë, të cilat nuk janë në përputhje me specifikimet teknike, sa i përket përcaktimit të peshës së llamarinave për ndërtimin e tubove të ajrimit dhe tubacioneve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 42-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

F. MASA DISIPLINORE

F.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 ñKodi i Punësò, i ndryshuar, kontratës kolektive të punës nr. 1528/1 prot., datë 30.03.2021 neni 19 pika 1/a, pika 2/a,b,c, ñMasat disiplinoreò, kontratave individuale të punës neni 15, i kërkojmë Drejtorit të Spitalit, që në varësi të kompetencave ligjore të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

"Vërejtje me paralajmërim"
për:

1. S.Gj., me detyrë Zv/drejtor ekonomik, në cilësinë e nëpunësit zbatues, për arsye se:

-ka caktuar në komision për hartimin e specifikimeve teknike, llogaritjen e vlerës së kontratës, monitorimin dhe marrjen në dorëzim, për kontratën e shërbimit ñGatimi dhe shpërndarja e ushqimit të pacientëveò, në kundërshtim me neni 22/3.b ñVeprimtaritë e kontrollitò, i ligjit nr.10296 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò.

-në procedurën e prokurimit me objekt ñShërbimi i sigurimit të ruajtjes me roje privateò nuk kanë respektuar ligjin e prokurimit publik nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar me. Neni 46 pika 1 dhe neni 58 i Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, ne kualifikimin e operatorit ekonomik ñLe. Securityò.
-për periudhën 2018-2020, nuk ka paraqitur raporte monitorimi në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në kundërshtim me ligjin për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe ligjin për MFK.
-nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat që duhet të përmbajë ky regjistër, nuk ka një përshkrim të plotë të aktivit, thuajse të gjitha përshkrimet janë të përcipta dhe me emërtime të thjeshta të pajisjeve.
-inventarin e pajisjeve informatike e ka përfshirë në inventarin e pajisjeve dhe aparaturave, duke sjellë diferenca në llogaritjen e amortizimit.
-për periudhën 2019-2020, ka kryer likuidimet me vonesë nga 1 - 4 muaj, për 20 procedura.

2. E. K., me detyrë Përgjegjës i sektorit të financës, në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për llogaritjen e fondit limit, **për arsye se**:
-nuk ka llogaritur dhe argumentuar fondit limit në tenderin me objekt ñMarrje me qira kaldaje për ngrohje me pelletò me fond limit 11,696 mijë lekë.
-Ka vlerësuar fituesin në tenderin me objekt ñFurnizim-vendosje kaldajeò me fond limit 8,000 mijë lekë, në kundërshtim me dokumentet e tenderit kriteret e veçanta/kualifikim ñkapaciteti teknikò dhe neni 66/3 ñShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertaveò i VKM nr.914, datë 19.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.
-në cilësinë e përgjegjëses së sektorit ekonomik dhe hartuese e pasqyrave financiare
-nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat që duhet të përmbajë ky regjistër, nuk ka një përshkrim të plotë të aktivit, thuajse të gjitha përshkrimet janë të përcipta dhe me emërtime të thjeshta të pajisjeve, mungon data e daljes në përdorim duke e bërë të pamundur përllogaritjen e vlerës së mbetur.
-Në cilësinë e anëtares së komisionit të blerjeve me vlera të vogla, në procedurën e blerjes me vlerë të vogël, 2020 ñRimbushje e fikseve të zjarrit dhe kolaudimin e tyreò, kërkesat për tu plotësuar nga OE, janë të paargumentuara dhe jo të justifikuara.
-Në cilësinë e anëtares së komisionit të blerjeve me vlera të vogla, në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, 778,764 lekë pa tvsh, me objekt ñEvadimi i mbetjeve urbane ne S.U. ñShefqet Ndroqiò, Tiranëò, në kërkesat e OE pjesëmarrësit në procedurë, duhet që me ofertën ekonomike, të paraqisnin dhe opsioni/opsionet se ku shkojnë mbetjet, shoqëruar me kontrata, lejet, dokumentet përkatëse që vërtetojnë plotësimin e tyre.

3. Z. A.P., me detyrë Përgjegjës i sektorit teknik, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të përllogaritjes së fondit limit, **për arsye se:**
-Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit ñBlerje oksigjen për vitin 2020ò, nuk kanë argumentur dhe nuk kanë përdorur referencë të saktë në përcaktimin e vlerës së fondit limit, duke shkaktuar efekt negativ financiar me vlerë 374,187 lekë.
- në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për mangësitë e konstatuara në llogaritjen e fondit limit, në tenderat me objekt ñMarrje me qira kaldaje për ngrohje me pelletò me fond limit 11,696 mijë lekë dhe ñFurnizim-vendosje kaldajeò me fond limit 8,000 mijë lekë, në kundërshtim me neni 59 ñPërllogaritja e vlerës limit të kontratësò, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.

-në procedurën e blerjes me vlerë të vogël, me shkresën nr. 85 Prot., datë 11.05.2020 ñRimbushje e fikseve të zjarrit dhe kolaudimin e tyreò, kërkesat për tu plotësuar nga OE, si për licencën kodi 1.2 A, për shërbim ekspertize, pika dhënia e asistencës teknike si dhe ekspert privat zjarrfikës i pajisur me leje të lëshuar nga drejtoria e MZSH janë të paargumentuara dhe jo të justifikuara pasi objekti i punës së ekspertit është ñstudimi dhe përgatitja e projekteve mbi masat nga zjarri të ndërtesave të çdo llojiò., kur objekti i procedurës është rimbushja dhe kolaudimi i fikseve të zjarrit.
-në ofertën e kërkuar janë dhe 120 copë F.V. bateri për sinjalizuesit e zjarrit dhe F.V. llampa LED me bateri 10 copë. Për këto mallra nuk janë paraqitur të dhënat specifike si amperazhi, kapaciteti, fuqia në W.

***4.* Z. S.N.,me detyrë specialist i sektorit teknik,** në cilësisë e specialistit të fushës, për arsye se:
-Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit ñF.V makineri pajisje për sistemin e kondicionimit në ambientet e SU ñShefqet Ndroqiò, ka hartuar kritere të cilat nuk janë argumentuar dhe nuk janë në përputhje me volumin dhe natyrën e kontratës.

"Vërejtje me shkrim"
për:
5. Zj. M. B., me detyrë Përgjegjës i sektorit të kostos, në cilësinë e anëtare e komisionit të përllogaritjes së fondit limit, **për arsye se:**
-Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit ñBlerje oksigjen për vitin 2020ò, nuk kanë argumentuar dhe nuk kanë përdorur referencë të saktë në përcaktimin e vlerës së fondit limit, duke shkaktuar efekt negativ financiar me vlerë 374,187 lekë.
- në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për mangësitë e konstatuara në llogaritjen e fondit limit, në tenderat me objekt ñMarrje me qira kaldaje për ngrohje me pelletò me fond limit 11,696 mijë lekë dhe ñFurnizim-vendosje kaldajeò me fond limit 8,000 mijë lekë, në kundërshtim me neni 59 ñPërllogaritja e vlerës limit të kontratësò, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.

6.M. F., me detyrë Përgjegjës i sektorit shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të kvo, **për arsye se:**

-Ka vlerësuar operatorin ekonomik fitues në tenderin me objekt ñFurnizim-vendosje kaldajeò me fond limit 8,000 mijë lekë, në kundërshtim me dokumentet e tenderit kriteret e veçanta/kualifikim ñkapaciteti teknikò dhe neni 66/3 ñShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertaveò i VKM nr.914, datë 19.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.
-në procedurën e prokurimit me objekt ñShërbimi i sigurimit të ruajtjes me roje privateò nuk ka respektuar ligjin e prokurimit publik nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 46 pika 1 dhe neni 58 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, në kualifikimin e operatorit ekonomik ñLe. Securityò.
-në ndjekjen dhe zbatimin e kontratës ñPër gatimin dhe shpërndarjen e ushqimit të pacientëveò nuk ka pasqyruar realizimin e kontratës referuar të gjitha kërkesave të kontraktuesit sipas neneve 6, 9, 10, 12 dhe 13, të kontratës, ose mangësi në zbatimin e saj.

7. S. T., me detyrë Përgjegjës sektori i informacionit mjekësor dhe statistikës, në cilësinë e punonjësit të statistikës, **për arsye se:**

-ka pranuar dhe përpunuar të dhënat për dokumentin ñForca ushqimoreò të pa nënshkruar nga shefi i pavijonit, por vetëm nga k/infermieri, pa u respektuar kërkesat e udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 ñMbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò Kreu III/2 ñDokumentimi i lëvizjes së aktiveveò pika 35/b, 36 dhe 54.

8. A. I., me detyrë Përgjegjës i sektorit Biomedikal, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla, **për arsye se**:
-në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, 778,764 lekë pa tvsh, me objekt ñEvadimi i mbetjeve urbane ne S.U. ñShefqet Ndroqiò, Tiranëò, në kërkesat e OE pjesëmarrësit në procedurë, nuk ka kërkuar që me ofertën ekonomike, të paraqisnin dhe opsioni/opsionet se ku shkojnë mbetjet, shoqëruar me kontrata, lejet, dokumentet përkatëse që vërtetojnë plotësimin e tyre.
-në procedurën e blerjes me vlerë të vogël, 2020 ñRimbushje e fikseve të zjarrit dhe kolaudimin e tyreò, nuk ka argumentuar kërkesat për tu plotësuar nga OE, si dhe nuk kanë kërkuar të dhënat specifike për produktet e kërkuara.

9. Z. E. V., me detyrë farmacist, në cilësinë e anëtar i komisionit të përllogaritjes së fondit limit**, për arsye se:**
-Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit ñBlerje oksigjen për vitin 2020ò, nuk kanë argumentur dhe nuk kanë përdorur referencë të saktë në përcaktimin e vlerës së fondit limit, duke shkaktuar efekt negativ financiar me vlerë 374,187 lekë.

10. A.M., me detyrë Ekonomiste, në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për llogaritjen e fondit limit, **për arsye se**:
-nuk ka llogaritur dhe argumentuar fondit limit në tenderin me objekt ñFurnizim-vendosje kaldajeò me fond limit 8,000 mijë lekë, në kundërshtim me neni 59 ñPërllogaritja e vlerës limit të kontratësò, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.

11. H.D., me detyrë Infermiere, në cilësinëe anëtarit të kvo, **për arsye se**:
-Ka vlerësuar operatorin ekonomik fitues ñLu.ò në tenderin me objekt ñFurnizim-vendosje kaldajeò me fond limit 8,000 mijë lekë, në kundërshtim me dokumentet e tenderit kriteret e veçanta/kualifikim ñkapaciteti teknikò dhe neni 66/3 ñShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertaveò i VKM nr.914, datë 19.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.
-në procedurën e prokurimit me objekt ñShërbimi i sigurimit të ruajtjes me roje privateò nuk ka respektuar ligjin e prokurimit publik nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 46 pika 1 dhe neni 58 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, në kualifikimin e operatorit ekonomik ñLe. Securityò.

12.L. Y., me detyrë Juriste, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla, **për arsye se**:

-Në procedurën e blerjes me vlerë të vogël, 2020 ñRimbushje e fikseve të zjarrit dhe kolaudimin e tyreò, kërkesat për tu plotësuar nga OE, janë të paargumentuara dhe jo të justifikuara.
-Në, në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me vlerë 778,764 lekë pa tvsh, me objekt ñEvadimi i mbetjeve urbane ne S.U. ñShefqet Ndroqiò, Tiranëò, në kërkesat e OE pjesëmarrësit në

procedurë, duhet që me ofertën ekonomike, të paraqisnin dhe opsioni/opsionet se ku shkojnë mbetjet, shoqëruar me kontrata, lejet, dokumentet përkatëse që vërtetojnë plotësimin e tyre.

F.2 PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte ***"Vërejtje me shkrim"***

për:

1. E.B., ish shefe sektori prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla, **për arsye se:**

-Me shkresën nr. 21. Prot., datë 16.01.2019, AK ka iniciuar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, 778,764 lekë pa tvsh, me objekt ñEvadimi i mbetjeve urbane ne S.U. ñShefqet Ndroqiò, Tiranëò.

-Në kërkesat e OE pjesëmarrësit në procedurë, duhet që me ofertën ekonomike, të paraqisnin dhe opsioni/opsionet se ku shkojnë mbetjet, shoqëruar me kontrata, lejet, dokumentet përkatëse që vërtetojnë plotësimin e tyre.

2. Z. K. D., i kontraktuar për një periudhë 3-mujore**,** në cilësinë e specialistit të fushës si inxhinier ndërtimi, **për arsye se**:

-Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit ñRikonstruksion i disa ambijenteve të SUSHNò, ka hartuar kritere të cilat nuk janë argumentuar dhe nuk janë në përputhje me volumin dhe natyrën e kontratës.

GRUPI I AUDITIMIT
M.B.
A.T.
S.H.
B. SH.

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

R. XH.

V. ANEKSE

Aneksi nr.1 "Për Pagat dhe shpërblimet"

Tabela nr. 1

Nr	Emër	Mbiemër	Pozicioni	Page Grupi
1	S.	Gj.	N/drejtor Ekonomik	14,000
2	B.	T.	Sekr Shkenc	14,000
3	E.	K.	Shofer urgje parasp	33,400
4	M.	R.	Shofer urgje parasp	33,400
5	L.	B.	Sanitare	30,000
6	Q.	B.	Sanitare	30,000
7	L.	L.	Sanitare	30,000
8	I.	K.	Sanitare	30,000
9	O.	P.	Mjeke Pneumologe	14,000
10	R.	H.	Mjek lab-kli-biok	14,000
11	M.	T.	Infermir/e	14,000
12	E.	A.	Infermir/e	14,000
13	M.	B.	Infermir/e	14,000
14	I.	D.	Infermir/e	11,000
15	M.	T.	Infermir/e	11,000
16	F.	M.	Infermir/e	10,000
17	E.	V.(I.)	Infermir/e	14,000
18	M.	S.	Teknik Imazherie	11,000

Burimi: SUSHN

Tabela nr. 2

Nr	Emër	Mbiemër	Vjetërsia MAJ			Vjetërsia Spitali MAJ			Diferenca		
			2020	2019	2018	2020	2019	2018	2020	2019	2018
1	S.	Gj.	3,640	3,360	3,080	3,640	3,360	3,080	0	0	0
2	B.	T.	2,800	2,520	2,240	2,800	2,520	2,240	0	0	0
3	E.	K.	3,006	2,672	2,338	2,672	2,338	2004	334	334	334

4	M.	R.	7,348	7,014	6,680	7014	6680	6346	334	334	334
5	L.	B.	6,900	6,600	6,300	6600	6300	6000	300	300	300
6	Q.	B.	4,800	4,500	4,200	4500	4200	3900	300	300	300
7	L.	L.	2,400	2,100	1,800	2100	2100	1500	300	0	300
8	I.	K.	1,800	1,500	1,200	1800	1500	1200	0	0	0
9	O.	P.	5,880	5,600	5,320	5880	5600	5320	0	0	0
10	R.	H.	5,320	5,040	4,760	5040	4760	4480	280	280	280
11	M.	T.	4,480	4,200	3,920	4480	4200	3920	0	0	0
12	E.	A.	840	560	280	840	560	200	0	0	80
13	M.	B.	840	560	280	840	560	200	0	0	80
14	I.	D.	640	440	220	640	440	220	0	0	0
15	M.	T.	440	220	0	220	220	0	220	0	0
16	F.	M.	400	200	0	200	200	0	200	0	0
17	E.	V.(I.)	560	280	0	280	280	0	280	0	0
18	M.	S.	440	220	0	220	220	0	220	0	0

Burimi: SUSHN

Aneksi nr.2 "Për tenderin e shërbimit me roje"

licenca	data lëshimit	emer mbiemër	licenca	data lëshimit	emër mbiemër
6772	21.01.2015	J.SH.	6549	21.11.2014	G.H.
3727	12.10.2012	C.C.	6361	13.10.2014	T.Z.
854	06.12.2010	P.L.	7466	17.06.2016	SH.D.
91	07.10.2011	S.D.	8062	15.01.2017	I.C.
1726	10.11.2010	R.L.	7537	23.08.2016	G.R.
4453	08.05.2013	K.XH.	5146	14.01.2014	E.SH.
4269	18.12.2012	N.SH.	5780	30.06.2014	M.V.
856	06.12.2010	I.A.	7955	24.04.2017	V.P.
1736	18.05.2010	B.P.	5687	21.05.2014	S.H.
6467	21.11.2014	B.S.		2014	A.V.
2110	10.01.2011	SH.H.	5155	17.01.2014	F.M.
3820	03.12.2012	J.K.	8378	27.06.2018	A.H.
7926	31.03.2017	J.K.	7647	11.11.2016	Y.P.
4534	08.05.2013	S.B.	8105	03.08.2017	A.A.
5091	27.12.2013	M.M.	5574	22.04.2014	N.K.
6228	25.08.2014	S.M.	7891	06.03.2017	I.M.
6075	25.08.2014	G.U.	8058	15.06.2017	A.T.
7648	11.11.2016	A.K.	6179	25.08.2014	B.H.
7873	23.02.2017	F.Q.	6636	19.12.2014	S.S.

7071	14.04.2015	A.G.	8106	03.08.2017	A.SH.
7922	27.03.2017	A.S.	7527	27.07.2016	F.S.
8118	31.08.2017	U.H.	7498	17.06.2016	I.E.
7553	05.09.2016	E.D.	8100	05.09.2017	V.M.
8112	25.08.2017	V.K.	8137	27.09.2017	A.M.
7646	11.11.2016	A.E.	6637	19.12.2014	G.B.
7021	17.03.2015	A.T.	3840	06.08.2012	S.H.
6247	02.10.2014	B.C.	6101	05.08.2014	D.D.